

NDËRPRERJA E GARANCIVE KUSHTETUESE NË SHTETET E BASHKUARA TE AMERIKËS, VENDET E AMERIKËS LATINE DHE NË SHQIPËRI

ANA DHAMO

Dorëzuar
Universitetit European të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në
Drejtësi, me profil E Drejtë Publike, për marrjen e gradës shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof. Dr. Eduardo Roza Acuna/ Prof. Dr. Ermir Dobjani

Numri i fjalëve: 54. 599

Tiranë, Shkurt 2018

DEKLARATA E AUTORËSISË

Nën përgjegjësinë time personale, deklaroj se ky punim është origjinal dhe nuk përmban plagjaturë.

Punimi është shkruar prej meje, nuk është prezantuar asnjëherë para një institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar i tëri ose pjesërisht.

Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër, përveç rasteve të cituara dhe të referuara.

ABSTRAKTI

Në këtë punim kam dashur të trajtoj temën e ndërprerjes së garancive kushtetuese, duke krahasuar realitete të ndryshme kushtetuese: Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Shqipërinë dhe disa nga vendet e Amerikës Latine.

Nga studimi i kryer rezulton se pak janë pikat e ngjashme mes realiteteve të marra në shqyrtim.

Në kapitullin i parë do të trajtohet aspekti metodologjik i studimit, ndërsa në kapitullin e dytë do të trajtohet tema e garancive kushtetuese, e cila prek të gjithë historinë amerikane, nga Linkoln deri te Bushi, dhe ripropozon dilemën e vazhdueshme të marrëdhënies mes lirisë dhe sigurisë. Sipas meje, katër janë momentet më të rëndësishme të ndërprerjeve: a) Lufta Civile Amerikane, ku Linkoln ndërpreu garancinë e *habeas corpus*-it; b) Lufta e Parë Botërore, me lëvizjet persekutuese të Presidentit Uillson kundër ideologjive komuniste të importuara nga Europa; c) Lufta e Ftohtë; d) atentati kundër Kullave Binjake në Nju Jork dhe, mbi të gjitha, Patriot Act-i i Presidentit Bush. Lidhja mes të gjitha këtyre situatave historike është pikërisht dialektika mes lirisë dhe sigurisë, por edhe kërcënimi i jashtëm në rast konflikti sipas thënies romake "*salus rei publicae suprema lex*".

Në kapitullin e tretë kam trajtuar realitetin tepër të rëndësishëm të Amerikës Latine, akoma shumë pak i njohur në vendin tonë nga pikëpamja kushtetuese. Jam ndalur në studimin e kushtetutës së disa prej vendeve të kontinentit amerikano-jugor. Duke studiuar kushtetutat e këtyre vendeve, të cilat janë relativisht të reja, vihet re një pozitë avanguardiste e këtyre shteteve për sa i përket temës së garancive kushtetuese. Kushtetutat e pjesës më të madhe të vendeve latine përmbajnë nene të cilat ndalojnë shprehimisht ndërprerjen e garancive kushtetuese në rast lufte apo gjendjeje të jashtëzakonshme. Natyrisht, realiteti flet ndryshe në mjaft raste.

Më pas, në kapitullin e katërt, studimi vijon me konsideratat mbi Kushtetutën e re të Republikës së Shqipërisë, një vend që e dua thellësisht dhe me të cilin jam tepër e lidhur shpirtërisht. Nuk mund të mos jem e lumtur dhe krenare për përmirësimet e dukshme në aspektin legjislativ dhe kushtetues, përveç atij ekonomik. Shqipëria, si vend që del nga

një krizë e thellë e viteve '90, duket se më në fund po sheh një horizont të ri përpara. Me zgjedhjet e qershorit 2013, të cilat shpallën fitues koalicionin e majtë, Shqipëria po hedh hapat e saj drejt integritit në Bashkimin European, ëndërr e të gjithë shqiptarëve. Shpresa ime dhe e të gjithë bashkatdhetarëve të mi është ta shohim vendin tonë të bëjë hapa të mëdha përpara drejt Europës, sepse ne jemi europianë dhe ndihemi realisht qytetarë të Kontinentit të Vjetër. Kjo rrugë është akoma e gjatë dhe fillon pikërisht nga garancitë kushtetuese të individëve.

Fjale kyçe: Garanci Kushtetuese, Habeas Corpus, Ndërprerje, SHBA, Shqipëri.

ABSTRACT

In this study I wanted to address the subject of suspension of constitutional guarantees by comparing different constitutional realities: the United States, Albania and some Latin American countries.

This study confirms that there is no similar item related to the constitutional guarantees of those countries.

In the first chapter will be treated the methodological aspect of the study and in the second chapter will be treated the topic of constitutional guarantees, which affects the impending calamity American history, from Lincoln up to Bush and continuing with dilemma of the relationship between freedom and security. According to me, four are the most important moments of interruptions: a) the American Civil War, where Lincoln interrupted guarantee of habeas corpus's; b) the First World War, the persecution of the movement against President Wilson communist ideologies imported from Europe; c) the Cold War; d) assassination attempt against the Twin Towers in New York and, above all Patriot Act. The link between all these historical situation is exactly the dialectic of freedom and security, but also the external threat in case of conflict by Roman saying "salus rei publicae suprema lex."

In the third chapter I have treated more important reality of Latin America, still little known in our country from the constitutional point of view. I stopped in constitutional studies of some of the South American continent countries. Having studied the constitutions of these countries that are relatively new, there is an avanguard position of these States in terms of constitutional guarantees thesis. Part of the constitutions of most of the Latin countries contain provisions which explicitly prohibit the suspension of constitutional guarantees in the event of war or extraordinary situation. Of course, the reality speaks otherwise in many cases.

Then, in the forth chapter, the study follows the considerations made on the new constitution of the Republic of Albania, a country that I love deeply and to whom I am more spiritually connected. There may be happy and proud of the significant improvements on the legislative and constitutional aspect except the economic one.

Albania, a country which emerging from a deep crisis of the 90s, it seems that we are finally seeing a new horizon before her. By the end of June 2013 elections, which announced the winning the left coalition, Albania is carrying out its steps towards integration into the European Union, the dream of all Albanians. My hope and all my compatriots to is to see our country to make great strides Prepare to Europe, because we are European citizens and really feel part of the old continent. This road is still long, and starts exactly from the constitutional guarantees of individuals.

Key Words: Constitutional guarantees, Habeas Corpus, Suspension, USA, Albania

DEDIKIMI

Dedikuar Familjes time...!

FALENDERIME

Në përfundim të këtij punimi akademik dëshiroj të shpreh mirënjohjen time të veçantë dhe të falënderoj të gjithë ata që më mbështetën dhe bënë të mundur që të realizoja këtë studim, i cili po paraqitet sot para jush për mbrojtje në nivel doktorature. Pa ndihmën e tyre, ky punim nuk do të ishte kaq i plotë në përmbajtjen dhe paraqitjen e tij.

Shpreh mirënjohje të veçantë për Profesorin tim të nderuar dhe udhëheqësin e këtij punimi doktoral, Eduardo Rozo Acuna, për punën e tij të palodhur dhe për njohuritë e pasionin që më ka transmetuar në fushën e të Drejtës Publike të Krahastuar. Ndihma e tij ka qenë thelbësore për vijimin e punës sime.

Profesor Acuna më është gjendur gjithnjë pranë, në çdo vështirësi të hasur në këtë rrugëtim të gjatë, dhe nuk ka reshtur kurrë të më japë mbështetjen e tij miqësore dhe profesionale.

PËRMBAJTJA E LËNDËS

KAPITULLI I I: HYRJE DHE BAZIM TEORIK

1. Hyrje	fq. 11
2. Qëllimi dhe objektivat e punimit.....	fq. 12
3. Rëndësia e punimit	fq.13
4. Metodologjia e punimit dhe metodat e kërkimit shkencor.....	fq. 13
5. Pyetjet kërkimore dhe hipoteza e punimit.....	fq. 14
1.5.1 Pyetjet kërkimore.....	fq. 14
1.5.2 Hipotezat e punimit.	fq. 14
6. Kufizimet e studimit	fq. 15
7. Përmbajtja dhe strukturimi i punimit	fq. 15

KAPITULLI II: SHETETET E BASHKUARA TË AMERIKËS DHE GARANCITË KUSHTETUESE PËRGJATË HISTORISË

2.1 Hyrje.....	fq.18
2.2 Garancitë kushtetuese gjatë Luftës së Parë dhe të Dytë Botërore	fq. 24
2.3 Çështja <i>Toyosaburo Korematsu vs. United States</i>	fq. 27
2.4 Lufta e Ftohtë	fq. 43
2.5 Patriot Act	fq. 46

KAPITULLI III: GARANCITË KUSHTETUESE NË AMERIKËN LATINE

3.1 Konstitucionalizmi në vendet andine (Venezuelë, Kolumbi, Ekuador, Peru dhe Bolivi)	fq. 97
3.2 Zhvillimi politik dhe kushtetues i Kolumbisë	fq. 98
3.3 Të drejtat, garancitë dhe detyrimet në Kushtetutën Kolumbiane.....	fq. 109
3.4 Garancitë kushtetuese në Peru	fq. 113
3.5 Të drejtat e njeriut, detyrat dhe garancitë në Venezuelë	fq. 115
3.6 Garancia kushtetuese e Habeas Corpus-it në Amerikën Latine	fq. 119

3.7 Adoptimi aktual kushtetues në vendet e komunitetit andin	fq. 125
3.8 Habeas Data kushtetuese: Garancia e re juridiksionale	fq. 136

KAPITULLI IV: SHQIPËRIA MES TË DREJTAVE DHE GARANCIVE

4.1 Disa kufizime të lirive dhe të drejtave individuale në Kushtetutën e RSH.....	fq. 143
4.2 Rekursi individual në Gjykatën Kushtetuese Shqiptare	fq. 144

KAPITULLI V: KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME.....fq. 148

BIBLIOGRAFIA.....fq. 153

Kapitulli I: HYRJE DHE BAZIM TEORIK

1.1 Hyrje

Tema e garancive kushtetuese prek të gjithë historinë amerikane, nga Linkoln deri te Bushi, dhe ripropozon dilemën e vazhdueshme të marrëdhënies mes lirisë dhe sigurisë. Sipas meje, katër janë momentet më të rëndësishme të ndërprerjeve: a) Lufta Civile Amerikane, ku Linkoln ndërpreu garancinë e *habeas corpus*-it; b) Lufta e Parë Botërore, me lëvizjet persekutuese të Presidentit Uillson kundër ideologjive komuniste të importuara nga Europa; c) Lufta e Ftohtë; d) atentati kundër Kullave Binjake në Nju Jork dhe, mbi të gjitha, Patriot Act-i i Presidentit Bush. Lidhja mes të gjitha këtyre situatave historike është pikërisht dialektika mes lirisë dhe sigurisë, por edhe kërcënimi i jashtëm në rast konflikti, sipas thënies romake "salus rei publicae suprema lex".

Më pas, studimi vijon me konsideratat mbi kushtetutën e re të Republikës së Shqipërisë, një vend që e dua thellësisht dhe me të cilin jam tepër e lidhur shpirtërisht. Nuk mund të mos jem e lumtur dhe krenare për përmirësimet e dukshme në aspektin legjislativ dhe kushtetues, përveç atij ekonomik. Shqipëria, një vend që del nga një krizë e thellë e viteve '90, duket se më në fund po sheh një horizont të ri përpara. Me zgjedhjet e fundit të qershorit 2014, të cilat shpallën fitues koalicionin e majtë, me në krye Kryeministrin aktual Edi Rama, Shqipëria po kryen hapat e saj drejt integritimit në Bashkimin Europian, ëndërr e të gjithë shqiptarëve. Shpresa ime dhe e të gjithë bashkatdhetarëve të mi është që ta shohim vendin tonë të bëjë hapa të mëdha përpara drejt Europës, sepse ne jemi europianë dhe ndihemi realisht qytetarë të Kontinentit të Vjetër. Kjo rrugë është akoma e gjatë dhe fillon pikërisht nga garancitë kushtetuese të individëve.

Se fundmi, kam trajtuar realitetin tepër të rëndësishëm të Amerikës Latine, akoma shumë pak i njohur në vendin tonë nga pikëpamja kushtetuese. Jam ndalur në studimin kushtetues të disa prej vendeve të kontinentit amerikano-jugor. Duke studiuar kushtetutat e këtyre vendeve, të cilat janë relativisht të reja, vihet re një pozite avantgardiste e këtyre shteteve për sa i përket temës së garancive kushtetuese. Kushtetutat e pjesës më të madhe të vendeve latine përmbajnë nene të cilat ndalojnë

shprehimisht ndërprerjen e garancive kushtetuese në rast lufte apo gjendjeje të jashtëzakonshme. Natyrisht, realiteti flet ndryshe në shumë raste.

Problemi që do të parashtrohet në këtë temë ka të bëjë me garancitë që u ofrohen nga ana e kushtetutave të marra në konsideratë shtetasve të vendeve të krahasuara. Kam trajtuar nocionin e garancive kushtetuese dhe të drejtave të njeriut, të cilat pa garancitë kushtetuese mbeten vetëm dëshira politike që nuk respektohen dhe në rast shkeljeje nuk mbrohen me asnjë mjet kushtetues apo juridiksional.

Gjithashtu, studimi vijon me shembuj të kushtetutave të reja, të cilat garantojnë të gjitha të drejtat e njeriut të pranishme në kushtetutë, si dhe mjetet juridiksionale të përdorura për mbrojtjen e të drejtave.

1.2 Qëllimi dhe objektivat e punimit

Ky studim ka si qëllim të evidentojë nevojën për rishikim kushtetues në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet një *excursus*-i historik të realiteteve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe vendeve të Amerikës Latine. Krahasimi është i qëllimtë, sepse, nga njëra anë është marrë në konsideratë vendi *par excellence* më i zhvilluar nga të gjitha prizmat, SHBA, i cili nga pikëpamja kushtetuese lë për të dëshiruar dhe me siguri nuk është një shembull i mirë për t'u "kopjuar" nga vendi ynë, duke qenë se në neni 1 pika 9 e Kushtetutës parashikon ndërprerjen e të gjitha garancive kushtetuese në rast gjendjeje të jashtëzakonshme apo lufte ose fatkeqësie natyrore. Nga ana tjetër, realiteti latino-amerikan, i cili përpos të gjitha problematikave të njohura botërisht, ka arritur në rang kushtetues bekimin e të gjitha të drejtave të njeriut nëpërmjet mjeteve juridiksionale kushtetuese në mbrojtje të tyre.

Për sa u përket objektivave, ato me kryesore në punimin në fjalë kanë të bëjnë me:

- i) studimi i kushtetutave të SHBA-ve, disa prej vendeve të Amerikës Latine, Shqipërisë në lidhje me kapitullin që secila nga këto kushtetuta i rezervon dhe trajton garancitë kushtetuese.
- ii) krahasimi teknik që rezulton nga analizimi i realiteteve kushtetuese të sipërpërmendura;

- iii) ngjashmëritë dhe ndryshimet në trajtimin e kapitullit të garancive kushtetuese të vendeve të marra në studim;
- iv) nevoja për rishikim kushtetues në kapitullin e garancive kushtetuese në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

1.3 Rëndësia e punimit

Ky studim do të jetë i rëndësishëm pasi mund të konsiderohet një kontribut i vlefshëm për rishikimin kushtetues, që lidhet me garancitë kushtetuese në Shqipëri.

Mendoj se ky punim mund t'u shërbejë edhe akademikëve, kërkuesve shkencorë apo studentëve për të kuptuar ndryshimet e nevojshme që duhen bërë në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë në lidhje me garancitë kushtetuese.

1.4 Metodologjia e punimit dhe metodat e kërkimit shkencor

Hulumtimet e bëra në literaturë, njohuritë teorike, eksperiencia ime, kanë bërë të mundur të krijoj një tablo në lidhje me përzgjedhjen e metodologjisë së duhur.

Metodat shkencore të përdorura në këtë studim janë: metoda historike, cilësore, analitike, krahasuese, si dhe metoda e mbledhjes së të dhënave, të cilat janë gërshtuar në çështjet e trajtuara në këtë punim.

Metoda historike: Kjo metodë është përdorur për të pasqyruar zhvillimin evolutiv të respektimit dhe garancive kushtetuese për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në sisteme të ndryshme juridike, veçanërisht në atë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Vendeve të Amerikës Latine dhe Shqipërisë.

Metoda analitike: Përdorimi i kësaj metode bazohet kryesisht në analizën e thellë ligjore të dispozitave dhe akteve ndërkombëtare dhe kombëtare me karakter kushtetues. Lloji i informacioneve të përdorura kanë bërë të mundur analizimin e hipotezave dhe pyetjeve kërkimore të shtruara, për të evidentuar ndryshimet dhe ngjashmëritë e kushtetutave të marra në konsideratë.

Metoda cilësore: Përdorimi i kësaj metode bazohet në të dhëna të cilat do të përfitohen nga tekste të ndryshme dhe kushtetutat e vendeve të marra në studim, pra nga burime parësore dhe dytësore.

Metoda krahasuese: Nëpërmjet përdorimit të kësaj metode synohet të bëhet një interpretim i të dhënave që do të përfitohen me qëllim krahasimin midis kushtetutave të marra në konsideratë, duke nxjerrë në pah ngjashmëritë dhe ndryshimet midis tyre.

Metoda e mbledhjes së të dhënave: Për të arritur objektivat e punimit, grumbullimi i informacionit sekondar është bërë duke ndarë literaturën në teorike dhe empirike, literaturë që është përfituar nga Biblioteka e Universitetit të Urbinos, Kongresi Amerikan. Një rol të rëndësishëm kanë pasur edhe punimet akademike, si për shembull kërkimet shkencore, konferencat ndërkombëtare të zhvilluara jashtë vendit, të cilat kanë plotësuar kuadrin e burimeve sekondare.

1.5 Pyetjet kërkimore dhe hipoteza e punimit

1.5.1 Pyetjet kërkimore

Me anë të pyetjeve kërkimore drejtohet dhe strukturohet shkrimi i punimit. Arritja në pyetjet kërkimore kalon në rastin konkret nga literatura, nga hendeku mes asaj që thuhet në të drejtën e shkruar dhe asaj që ndodh në të vërtetë dhe, sigurisht, nga eksperiencia që kam përfituar nga konferencat ndërkombëtare dhe nga takimet me ekspertë të huaj të së Drejtës Kushtetuese.

Pyetjet kërkimore të këtij punimi janë:

1. A kanë kuptim të drejtat dhe liritë individuale pa garancitë kushtetuese?
2. A cënohen të drejtat dhe liritë individuale nëse ndërpriten garancitë kushtetuese?
3. A është i nevojshëm një rishikim kushtetues në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë në lidhje me tematikën e garancive kushtetuese?
4. Garantohen erga omnes të drejtat dhe liritë individuale nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë?
5. Kushtetuta e Shteteve të Bashkuara të Amerikës respekton dhe garanton të drejtat dhe liritë individuale të njohura ndërkombëtarisht?

1.5.2 Hipotezat e punimit

Hipoteza përbën një pohim të testueshëm në lidhje me marrëdhënien midis dy ose më shumë koncepteve të përfituara nga hulumtimi i literaturës së gjerë. Me anë të hipotezave arrihet të nxirren konkluzione në lidhje me fakte që nuk i dimë. Hipotezat, duke shprehur një marrëdhënie midis koncepteve të përfituara, në japin mundësinë të përzgjedhim në mënyrë sa më korrekte të dhënat e përfituara.

Për t'u dhënë përgjigje pyetjeve kërkimore të ngritura më sipër, në vijim gjejmë hipotezat e punimit.

i) Kushtetutat e Amerikës Latine, të marra në konsideratë në këtë punim, janë më të zhvilluara se ato të Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, referuar garancive kushtetuese.

ii) Kushtetutat e shkruara të Amerikës Latine nuk përkojnë me aplikimin në realitet.

iii) Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë nuk parashikon një ndalim absolut të ndërprerjes së garancive kushtetuese për liritë dhe të drejtat individuale dhe, si e tillë, duhet rishikuar.

iv) Kushtetuta e Shteteve të Bashkuara të Amerikës nuk respekton erga omnes të gjitha të drejtat dhe lirite individuale të njohura nderkombetarisht.

1.6 Kufizimet e punimit

Mundësitë për të trajtuar këtë temë janë të shumta, pasi ka tekste të ndryshme që trajtojnë garancitë kushtetuese, të drejtat dhe liritë. Por trajtimi i kësaj teme të rëndësishme dhe specifike paraqet edhe kufizime të shumta, duke qenë se është e vërtetë që ka shumë materiale lidhur me tematikën e garancive kushtetuese në Republikën e Shqipërisë, por mbi specifikën e garancive kushtetuese materialet kufizohen vetëm në një shtjellim të temës së garancive, duke mos u fokusuar në trajtimin kritik të kësaj teme dhe të efekteve negative që sjell ndërprerja e garancive në rast lufte apo gjëndje të jashtëzakoshme.

1.7 Përmbajtja dhe strukturimi i punimit

Ky studim është i organizuar në pesë kapituj.

Kapitulli i parë është kapitulli hyrës, i cili merr në analizë metodologjinë që është ndjekur për të arritur në konkluzionet e këtij studimi, si dhe paraqet një tablo të argumenteve kryesore, siç janë: objektivat e punimit, pyetjet kërkimore, hipotezat, metodologjia e punimit dhe metodat e kërkimit shkencor, kufizimet e punimit, rëndësia e studimit, duke qartësuar strukturimin e kapitujve vijues.

Kapitulli i dytë, që pason, ofron një analizë të kuadrit kushtetues dhe të garancive kushtetuese në Shtetet e Bashkuara të Amerikës përgjatë historisë, *Së pari*, trajton dhe analizon garancitë kushtetuese gjatë Luftës së Parë dhe të Dytë Botërore. *Së dyti*, trajton dhe analizon rastin *Toyosaburo Korematsu v. United States*. *Së treti*, kapitulli trajton dhe analizon Luftën e Ftohtë. *Së katërti*, kapitulli hedh një vështrim dhe analizon përmbajtjen e *Patriot Act*.

Kapitulli i tretë analizon dhe trajton tërësinë e garancive kushtetuese në Amerikën Latine, duke u ndalur në analizën e konstitucionalizmit në vendet andine (Venezuelë, Kolumbi, Ekuador, Peru dhe Bolivi), në zhvillimin politik dhe kushtetues të Kolumbisë, në studimin e të drejtave të njeriut, të garancive dhe detyrimeve në Kushtetutën Kolumbiane, në trajtimin e garancive kushtetuese në Peru, në studimin e të drejtave të njeriut, detyrave dhe garancive kushtetuese në Venezuelë, në trajtimin e garancive kushtetuese të *Habeas Corpus-it* në Amerikën Latine si dhe në trajtimin e çështjeve që kanë të bëjnë me adoptimin aktual kushtetues në vendet e komunitetit andin.

Kapitulli i katërt analizon nivelin e garancive dhe kufizimeve të të drejtave kushtetuese në Shqipëri. Bazuar në të dhënat e mbledhura, ky kapitull diskuton dy elemente. *Së pari*, kufizimet e lirive dhe të drejtave individuale në Kushtetutën e RSH. *Së dyti*, natyrën juridike dhe kushtetuese të rekursit individual në Gjykatën Kushtetuese Shqiptare, duke ofruar edhe disa argumente për natyrën dhe nivelin e garancive dhe të drejtave kushtetuese në vendin tonë.

Kapitulli i pestë është kapitulli përmbyllës i studimit, në të cilin parashtrohen konkluzionet kryesore. *Së pari*, nxjerr disa konkluzione përmblendhëse lidhur me

mekanizmat e mbrojtjes juridiksionale të brendshme dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut në sistemet juridike latino-amerikane dhe nevojën e perfeksionimit të këtyre sistemeve si përgjigje ndaj shkeljes së vazhdueshme dhe në rritje të të drejtave dhe lirive themelore në këto vende.

Së dyti, nxjerr disa konkluzione përmbledhëse lidhur me qasjen që kanë vendet e marra në studim për të garantuar të drejtat dhe liritë themelore kryesisht në kuadër të evoluimit dhe afirmimit të garancive kushtetuese të të drejtave themelore pas Luftës së Dytë Botërore.

Së treti, nxjerr disa konkluzione përmbledhëse lidhur me Sistemin "amerikan" - USA - të të drejtave të njeriut, i cili në mënyrë kurioze në nivel ndërkombëtar nuk ka fituar ende një kulturë respekti tek *international legal tradition*.

Së katërti dhe së fundi, nxjerr disa konkluzione për dinamikën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe garancive kushtetuese për vendin tonë, i cili pas shumë peripecive historike ndien të nevojshëm rishikimin kushtetues për përshtatjen e kësaj të fundit me standardet kontinentale dhe universale.

Kapitulli II: SHTETET E BASHKUARA TË AMERIKËS DHE GARANCITË KUSHTETUESE PËRGJATË HISTORISË

2.1 Hyrje

Gjatë historisë, në raste të ndryshme, ka pasur kufizime të të drejtave dhe lirive civile në emër të sigurisë së brendshme dhe problemit të marrëdhënies mes lirisë dhe sigurisë. Ky fakt është i pranishëm në historinë e Shteteve të Bashkuara që nga origjina e Federatës dhe përbën një nga argumentet më të diskutuara nga politikanët dhe studiuesit. Në vitin 1787, gjatë një diskutimi në lidhje me ratifikimin e Kushtetutës së re¹, Aleksandër Hamilton nuhati se kufizimi i lirive do të ishte gjithnjë rrjedhojë e luftës dhe frikes dhe deklaroi se në disa situata Kushtetuta e re do të injorohej. Në këtë mënyrë, Shtetet e Bashkuara do të kenë, sipas Hamiltonit, tendencën për të shkatërruar të drejtat e tyre civile dhe politike. Pra, për të qenë më të sigurt, do të ndeshen me rrezikun e të qenit më pak i lirë.² Ky parashikim u verifikua në disa rrethana dhe tani është përsëri argument diskutimi pas 11 Shtatorit dhe miratimit të Patriot Act-it. Përpara se të nis analizën e Patriot Act-it, duhet bërë një hap mbrapa dhe të drejtojmë vëmendjen në periudhat historike, në të cilat lufta dhe frika ndaj saj kanë çuar në reaksione të kësaj natyre. Analiza historike tregon se kufizimi i lirisë në periudha krizash ka qenë gjithnjë një ide e përbashket e të gjitha qeverive amerikane, si republikane ashtu edhe demokrate, madje edhe atyre qeverive që në appearance ishin më të impenjuara dhe të kujdesshme ndaj lirisë dhe të drejtave individuale³. Historikisht, populli amerikan ka mbështetur gjithnjë zgjedhjet qeveritare në këtë aspekt, duke kërkuar masa shtrënguese që në të njëjtën kohe të garantonin më tepër siguri: kjo edhe nga ana e atyre që kanë besuar gjithnjë te paprekshmëria e të drejtave të tyre individuale. Orientimi bazë, megjithatë, ishte se dispozitat duhet t'i drejtoheshin një numri të ngushtë individësh, të identifikuar nga

¹Bëhet fjalë për një seri shkrimesh të Aleksandër Hamiltonit bashkë me Xh. Medison dhe Xh. Xhei, të cilat u publikuan në "The Federalist" dhe kanë dhënë kontributin e tyre thelbësor për miratimin e tekstit kushtetues.

² Alexander Hamilton. The Federalist. Citati AA. VV. It's a free country. New York, 2003, faq. 20.

³ Shiko: AA. VV. It's a Free Country. New York, 2003.

raca, prejardhja apo idetë politike. Gjithashtu, këto masa duhet të merreshin vetëm gjatë periudhës së emergjencës, pra të ishin të përkohshme. Në kohë nevojë, disa nga mbrojtjet kushtetuese mund të lihen mënjanë dhe të sakrifikohen edhe të drejtat e disa individëve, edhe pse shtetas amerikanë. Ky fakt është konsideruar gjithnjë legjitim në të mirë të sigurisë së të gjithë shtetasve të tjerë amerikanë⁴. Një rol thelbësor ka luajtur sistematikisht edhe frika dhe mungesa e sigurisë së vendit. Në momente krize, çështja nuk është nëse frika është e bazuar apo jo në mënyrë abstrakte; disa herë mund të mos jetë, dhe shpeshherë mund të jetë e ekzagjeruar, por në pjesën më të madhe të rasteve është me siguri e motivuar. Ka qenë pas sulmit të Pearl Harbour-it, ka qenë gjatë periudhës së Luftës së Ftohtë dhe është padyshim edhe sot, pas sulmeve të 11 Shtatorit 2001.

Pyetja që i bëjmë vetes është nëse masat rregulluese të marra për t'iu përgjigjur kësaj frike janë apo jo të nevojshme⁵. Kriteri i parë për të vlerësuar dispozitat kufizuese të të drejtave civile duket të jetë efikasiteti i tyre, efikasitet në kuptimin e aftësisë për të kufizuar rreziqet për vendin dhe për të rritur sigurinë kombëtare. Vetëm pasi është kryer vlerësimi i efekteve të këtyre masave, shumica mendojnë se mund të konsiderohen pasojë negative ndaj lirisë së shtetasve. Nëse përpara një rreziku real për vendin, një ligj është në gjendje të mbrojë sigurinë kombëtare, ai vlerësohet pozitivisht edhe nëse si pasojë e tij kufizohet në mënyrë të përkohshme ushtrimi i të drejtave civile. Kjo nuk do të thotë se kushtetuta nuk aplikohet në kohë lufte, por nënkupton faktin se në momentin e aplikimit të një standardi kushtetues të aplikueshëm në çdo fushë të së drejtës, është e dobishme të mbahen në konsideratë kushtet e luftës për të vendosur nëse qeveria disponon apo jo justifikime të nevojshme për të kufizuar të drejtat kushtetuese⁶. Por jo gjithnjë në historinë amerikane ka qenë kështu. Në të shumtat e rasteve u është përgjigjur situatave kritike me masa të papërshtatshme dhe të sproporcionuara, herë të tjera kriza dhe frika janë shfrytëzuar nga Qeveria Amerikane për arritjen e qëllimeve

⁴ AA. VV. (2005). *At war with civil rights and civil liberties*. Baltimora, fq. 28.

⁵ Shiko: GLASSER, More Safe, less free. Ne AA. VV. (2003). *It's a Free Country*. Neë York.

⁶ Stone G. *Libertà Civile in tempo di guerra: la prospettiva americana*. Relazione all'Associazione Italiana Costituzionalisti. www.associazioneitalianadeicostituzionalisti.it.

politike që nuk kishin asnjë lidhje me sigurinë kombetare. Fillimi i këtij punimi me një analizë të shkurtër historike mund të jete i dobishëm për të vlerësuar masat e ndryshme që janë ndërmarrë në të shkuarën si kundërpërgjigje ndaj periudhave kritike, për të vlerësuar efektet konkrete dhe përgjigjen e opinionit publik dhe mediave dhe së fundmi për të analizuar rolin e rëndësishëm që ka pasur Supreme Court herë pas here në tejkalimin e politikave qeverisëse, ose në zgjidhjen e situatave emergjente.

Do të ishte e pamundur të kujtoja të gjithë shembujt e kufizimeve të lirive civile në historinë e Shteteve të Bashkuara; është e mundur, nga ana tjetër, një analizë e shkurtër e hallkave legjislative më të rëndësishme si dhe të ndalem në mënyrë analitike në tri momentet që duken më përfaqësuese. Alien dhe Sedition Acts, të miratuara në vitin 1798 (me pak se dhjetë vite nga miratimi i Kushtetutës) përfaqesojnë ligjet e para me anë të të cilave Kongresi adoptoi masa shtrënguese të lirisë së fjalës kundër individëve të dyshuar për pozicion antiqeveritar. Ligjet u rrëzuan në vitin 1802, kur partia republikane mori pushtetin. Pesëdhjetë vite me pas, pas shpërthimit të luftës civile, Presidenti Linkoln dhe Kongresi lejuan investigime, burgime dhe veprime të tjera ndaj shtetasve të dyshuar për veprime antiqeveritare. Gjatë luftës Linkoln ndërpreu Habeas Corpus-in⁷ në situata të ndryshme⁸ dhe krijoi gjykata ushtarake, edhe pse në kundërshtim me Supreme Court⁹. U arrestuan gjatë luftës një numër diku mes 10.000

⁷ Habeas Corpus është e drejta e të arrestuarit për t'u paraqitur përpara gjykatës ose gjyqtarit për të vendosur shkakun dhe legjitimitetin e arrestimit të tij. I njohur si "The great writ", habeas corpus-i është konsideruar esencial për lirinë personale dhe garantohet nga Kushtetuta ("The privilege of the writ of habeas corpus shall not be suspended, unless when in case of rebellion or invasion the public safety may require it". Neni I, sek. 9).

⁸ Presidenti Linkoln i justifikoi kufizimet në emër të sigurisë kombëtare. Në diskutimin e tij në seksionin e posaçëm të Kongresit në Ditën e Pavarësisë të vitit 1861 tha: "To state the question more directly, are all the laws but one to go unexecuted and the government itself go to pieces less than one be violated?" Linfield. (1990). *Freedom under fire*, Boston, fq. 26-28.

⁹ Supreme Court nuk aprovoi përdorimin e gjykatave ushtarake të Linkolnit për të burgosurit mbështetës e Konfederatës. Court-i deklaroi të paligjshëm arrestimin e një civili të kryer nga një gjykatë ushtarake, sepse nuk ishte i autorizuar nga Kushtetuta ose nga Kongresi; anuloi edhe argumentimin e qeverisë se për arsye të luftës ishte e nevojshme që gjykatat të kishin më shumë autoritet: cit. da Ex parte Milligan, 4 Wall. 2-142, 71U.S. 210, 281 (1866).

deri ne 30.000 shtetasish amerikanë pa një proces të rregullt ligjor dhe pa asnjë garanci kushtetuese¹⁰.

Në fillimet e Luftës Botërore, Kongresi filloi të merrte në konsideratë mundësinë e miratimit të një ligji, i cili të kufizonte lirinë e shprehjes gjate vitit 1916 dhe u miratuan tekste të ndryshme legislative, por asnjë nga ato nuk e arriti kurre mazhorancën në të dyja Dhomat¹¹. Vetëm në vitin pasardhës, më 15 qershor 1917, u miratua Espionage Act¹², në fuqi edhe sot e kësaj dite, i amenduar më tej nga Sedition Act¹³. Këto akte autorizonin përdorimin e forcës me qëllim ndalimin e transmetimit të informacioneve të rrezikshme për sigurinë kombëtare dhe lejonin edhe arrestimin e atyre që shprehnin komente ose opinione kundër luftës. U ndalua prononcimi i diskutimeve dhe i printimeve të fletëpalosjeve kundër Shteteve të Bashkuara, Qeverisë, Kushtetutës dhe Flamurit. Këto dy ligje sollën në periudhën e quajtur "Palmer Raids" ose "Red Scare". Në fillimet e 1920-s, edhe si rrjedhojë e shpërthimit të një bombe përpara shtëpisë së Prokurorit të Përgjithshëm A. Miçell Palmer¹⁴, u verifikuan një seri arrestimesh në dëm të terroristëve të dyshuar, mbi të gjitha të huaj. Ishin gati 2.000 individët e arrestuar për shkak të Espionage Act-it: gjysma e këtyre u dënuan, por asnjë me akuzën e spiunazhit¹⁵. Gjatë luftës, Supreme Court nuk u shpreh kurrë në lidhje me Espionage Act dhe Sedition Act-in; në vitet e ardhshme, në gjashtë raste të ndryshme, i gjykoi

¹⁰ Shiko: Krittie - Wedloch, (1986). *The tree of liberty: a documentary history of rebellion and political crime in America*. Baltimore.fq 22-28.

¹¹ Chafee.(1969). *Free speech in the United States*, Neë York, fq 37.

¹² Espionage Act. 40 Stat. 217 (1917).

¹³ Sedition Act. 40 Stat. 555 (1918).

¹⁴ Cate. (1978). *The great fear: the anti - communist purge under Truman and Eisenhower*. New York, fq 22 - 23.

¹⁵ Shiko: Murphy, (1969). *World War I and the origin of civil liberties in the United States*, New York; Biddle. (1951). *The fear of freedom*, New York; Summers. (1942). *Wartime censorship of press and radio*, New York. fq 24-46.

legjitime ligjet dhe konfirmoi dënimet e dhëna të po atë shtetasve amerikanë¹⁶. Vetëm në vitin 1920 Kongresi tërhoqi ligjet dhe iu dha liria atyre që ishin dënuar për shkak të Espionage Act dhe Sedition Act. Edhe Court-i u rikthye në hapat në tij dhe anuloi të gjitha vendimet e marra përpara, gjatë Luftës së Parë Botërore¹⁷.

Një nga pozicionet më të rëndësishme në historinë e Shteteve të Bashkuara në lidhje me ndërprerjen e garancive kushtetuese në rast emergjence, u shpreh nga Abraham Linkoln në një letër të shkruar në vitin 1863 në justifikim të vendimit të tij për ndërprerjen e *habeas corpus*-it dhe për të burgosur pa afat kundërshtarët e tij gjatë luftës civile. Linkoln, në këtë letër, trajton çështjen më kryesore, domethënë nëse kufizimet e këtyre garancive në kohë lufte, mund t'u shkaktojnë dëme permanente garancive kushtetuese. Linkoln shprehet se, në aplikimin e saj, Kushtetuta nuk mund të konsiderohet në të njëjtën mënyrë në të gjitha rastet. Është vetë Kushtetuta që formulon ndryshimin; pra, Qeveria mund të përdorë masa shtrënguese gjatë gjendjeve të jashtëzakonshme mbi bazë të faktit që këto masa të mos përdoren, duke qenë se janë të jashtëligjshme në kohe paqeje. Një tjetër pikë mbi të cilën duhet të reflektojmë është pyetja se çfarë sjellin këto zgjedhje në lidhje me efikasitetin e ligjit në momentin e përfundimit të emergjencës. Linkoln përsëriti se ndërprerja e lirive civile në kohë emergjence nuk e vë në rrezik mbulesën kushtetuese në kohe paqeje. Të shumtë ishin ata që e mbështetën faktin se ndërprerjet me natyrë të përkohshme kanë tendencën të bëhen të qëndrueshme dhe se fusha e aplikimit të tyre ka tendencën për t'u zgjeruar. Sipas Linkolnit, parashikimet e përmbajtura në Kushtetuten e Shteteve të Bashkuara janë më të vlefshme se ato të parashikuara nga ato më të reja europiane, të cilat përmbajnë një listë të gjatë hipotezash për vendosjen e normave të emergjences në kohë

¹⁶ Për tri rastet e para u vendos në unanimitet në vitin 1919. Në *Schenck vs. United States* Court e deklaroi legjitim arrestimin e Çarlz Shenekut për arsye të printimit të fletëpalosjeve kundërshtarë (*Schenck vs United* 294 U. S. 47, 1919). Është në këtë rast që gjyqtari Oliver Wendell Holmes fillimisht vendosi parimin "clear and present danger" për të vendosur kur mund të kufizohesh liria e fjalës dhe e shtypit.

¹⁷ Supreme Court deklaroi që secili nga individët e arrestuar ose të izoluar në atë periudhë për kundërshtimin e tyre dhe që ishin dënuar për deklaratat që duhet të ishin mbrojtur nga Amendamenti i Parë. *Dennis vs United States*, 341 U. S. 494 (1951); *Brandenburg vs. Ohio*, 395 U. S. 444 (1969).

lufte dhe luftë civile. Në vitin 1863 Linkoln mbrojt masat që kishte ndërmarrë, mes të cilave edhe ndërprerjen e *habeas corpus* -it, mbi faktin se këto masa, të ligjshme apo jo, janë ndërmarrë duke respektuar atë që ishte vullneti i popullit dhe nevoja publike. Nuk mund t'i ndalohet ekzekutivit të deklarojë emergjencën, por pas deklarimit të emergjencës parlamenti dhe gjykatat kanë të drejtën dhe detyrimin të hetojnë mbi ushtrimin e këtyre fuqive të emergjencës.

Siç e përmenda më sipër, Linkoln ndërpreu garancinë e *habeas corpus*-it në tetë situata të ndryshme. Ajo më ekstreme, e cila iu aplikua një shteti të tërë, deklaroi se "të gjithë personat..... të fajshëm për çdolloj veprimi të padrejtë..... do t'i nënshtrohen gjykatës marcialë". Nën këtë autoritet, agjentët e ushtrisë arrestuan dhe burgosën të paktën 38.000 civile pa asnjë procedim gjyqësor ose vendim. Sekretari i Shtetit, Uilliam Stjuard komentoi përpara ministrit britanik në Uashington: "*Unë mund t'i bie një zileje në të djathtën time dhe të urdhëroj arrestimin e një shtetasi në Ohaio. Mund t'i bie një zileje përsëri dhe të vendos burgosjen e një shtetasi në Nju Jork, dhe askush mbi tokë, përveç Presidentit, nuk mund t'i lirojë ata. Mbretëresha e Mbretërisë së Bashkuar mund të thotë të njëjtën gjë për shtetasit e saj?*". Këtu vërehet një sarkazmë e thjeshtë e Sekretarit Amerikan të Shtetit me Ministrin britanik.

Në fillimet e Luftës Civile, gjyqtari Roxher Tanei vendosi që ndërprerja e *habeas corpus* -it nga ana e Linkolnit përfaqesonte një shkelje dhe shpërdorim antikushtetues të autoritetit, sepse, sipas Kushtetutës, vetem Kongresi e kishte këtë pushtet. Linkoln thjesht e injoroi vendimin e gjyqtarit Tanei, duke mbrojtur veprimin e tij si të nevojshëm për të shpëtuar SHBA-të nga shkatërrimi.

Pjesa më e madhe e arrestimeve ushtarake u shkaktua nga vepra penale që kundërshtonte shërbimin ushtarak, sabotimi dhe marrëveshjet me armikun. Pak individë u arrestuan për manifestime politike apo manifestime idesh. Një shembull i këtyre arrestimeve për diskutime kundërshtuese përfaqesohet nga rasti i Klement Vallandingamit, një ish-deputet i Kongresit të Ohaios, i cili ishte një kundërshtar i jashtëzakonshëm i Linkolnit. Vallandingami u dënua nga ana e një gjykate ushtarake dhe më pas u azilua nga ana e Linkolnit pasi kishte mbajtur një diskutim në Ohaio, në të cilin përshkruante Luftën Civile nga ana e Shtëpisë së Bardhë.

Në vitin 1886, një vit pas përfundimit të Luftës Civile, Supreme Court vendosi që Linkoln kishte tejkaluar autoritetin e tij kushtetues, duke mbështetur faktin se sipas Kushtetutës, Presidenti nuk mund të ndërpriste të drejtën e *habeas corpus* -it as në kohë lufte, nëse juritë civile ishin të hapura dhe funksionale.

Court-i citoi: "*Kushtetuta është një ligj për qeverisësit dhe për popullin si në kohë lufte ashtu edhe në kohë paqeje, dhe mbron të gjitha klasat e popullatës, në çdo kohe dhe në çdo rrethanë. Asnjëherë nuk është konceptuar nga intelekti human një doktrinë me pasoja të tilla se ajo që implikon se çdo dispozitë e saj mund të ndërpritet në fushën e çdolloj nevojë të veçantë të qeverisë. Një doktrinë e tillë çon drejtpërdrejt në anarki dhe despotizëm*".

Këto pak rreshta na shpjegojnë se Linkoln, gjatë Luftës Civile, u tregua sikur të ishte një diktator, duke ndërprerë për të parën herë në historinë e Shteteve të Bashkuara garancinë kushtetuese të *habeas corpus* -it, një garanci thelbësore e të drejtës anglosaksone.

2.2 Garancitë kushtetuese gjatë Luftës së Parë dhe të Dytë Botërore

Historia e lirive civile gjatë Luftës së Parë Botërore është tepër e frikshme. Si në çdo konflikt, edhe gjatë Luftës së Madhe kemi asistuar në kufizime të përsëritura të lirive civile në Shtetet e Bashkuara. Kur Shtetet e Bashkuara të Amerikës hynë në luftë në prillin e vitit 1917, kishte një opozitë të fortë si kundër luftës ashtu dhe kundër shërbimit ushtarak.

Atëherë, Presidenti Uillson nuk i toleronte këto kundërshtime. Ai theksoi faktin se mungesa e besnikërisë "duhet të eliminohet" dhe se ajo "nuk përbënte argument mbi të cilin ka hapësirë për diskutim". Subjektet kundërshtuese, sipas Uillsonit, kishin sakrifikuar të drejtat e tyre për liritë civile. Pak kohë pas hyrjes në luftë të Shteteve të

Bashkuara, Kongresi kishte miratuar *Espionage Act*¹⁸, më 1917. Edhe pse masa nuk i drejtohej kundërshtimit të përgjithshëm, prokurorët federalë agresivë dhe gjyqtarët federalë e transformuan atë në një ndalim të përgjithshëm të shprehjeve të dyshimta. Qëllimi i administratës në këtë aspekt u bë evident në nëntorin e vitit 1917, atëherë kur Prokurori i Përgjithshëm, Çarlz Gregori, duke iu referuar kundërshtarëve të konfliktit deklaroi: "Zoti pastë mëshirë për ata, me qëllim që ata të mos presin nga një popull i cënuar, ose nga një qeveri hakmarrëse". Në fakt, qeveria punoi bindshëm për të krijuar "një popull të cënuar". Duke qenë se nuk kishte sulme të drejtpërdrejta kundër Shteteve të Bashkuara dhe asnjë kanosje kundrejt sigurisë së tyre, administrata Uillson duhej të prodhonte një sens nevojë për të ftuar amerikanet të ishin pjesë e ushtrisë, të kontribuonin me financat e tyre dhe të bënin sakrifica, të cilat lufta i kërkonte. Për këtë qëllim, Uillsoni krijoi Komitetin për Informimin Publik, i cili prodhoi një seri diskutimesh, editoriale dhe filmime, shpeshherë sajesa, të gjitha të drejtuara për të ngjallur tek amerikanët një ndjesi urrejtjeje kundër gjermanëve dhe kundër të gjithë atyre personave, drejtësia e të cileve të vihej në dyshim.

Gjatë Luftës së Parë Botërore, qeveria dënoi mbi 2.000 individë për shkak të kundërshtimit të tyre për të qenë pjesë e ushtrisë, ose për të marrë pjesë në luftë. Në këtë atmosferë frike, gjyqtarët morën vendime të rënda (nga 10 deri në 20 vite burg) për ata që u konsideruan fajtorë për tradhti. Të paktë ishin ata gjyqtarë që me kurajo i rezistuan kësaj rryme represive, ndërsa mazhoranca ndoqi rrymën e momentit. Rezultati ishte shtypja e çdo debati për këtë temë, moraliteti dhe zhvillimet e luftes.

Por gjithsesi, kjo nuk ishte e mjaftueshme. Vetëm një vit më pas, Kongresi miratoi *Sedition act-in*, në vitin 1918, i cili ndalonte shprehimisht çdo shprehje kundërshtuese dhe ofenduese kundër Shteteve të Bashkuara. As armëpushimi nuk e mbylli këtë faze. Prokurori i Përgjithshëm, A. Miçell Palmer, dërgoi një seri agentësh me qëllim infiltrimin e tyre në disa organizata radikale. Në harkun kohor prej dy muajsh, vetëm

¹⁸ Dhjetë vite pas *Espionage Act*-it, lëvizja antikomuniste solli më 1938 krijimin e House Un - American Committee (HUAC). Veprimtaria hetuese e komisionit u deklarua legjitime në raste të ndryshme nga ana e Supreme Court-it.

qeveria arrestoi mbi 5.000 mijë shtetas amerikanë, duke deportuar me procedime të ndryshme me tepër se një mijë të huaj të dyshuar se ishin pjesë e grupeve radikale.

Historia e Supreme Court-it në këtë periudhë është shumë e dhimbshme për t'u treguar. Në një seri vendimesh mes 1919 dhe 1920-s Court-i shpalli dënimin e shtetasve që i kishin rezistuar shërbimit ushtarak dhe luftës. Mes këtyre individëve mund të kujtojmë rastin e një emigranteje çifute ruse, Moli Steimer, 20 vjec, e cila kishte hedhur fletëpalosje në Yiddish kundër luftës nga çatia e një ndërtese në East Side të Nju Jorkut. Një rast tjetër është ai i Eugjen Debsijt, që kishte marrë pothuajse një milion vota më 1912 si kandidat i Partisë Socialiste për Presidencën e Shteteve të Bashkuara. Kanë qenë vendime që nuk kanë lënë dyshime mbi pozitën e Supreme Court-it: ndërkohë që kombi ishte në luftë, kritika e ashpër nuk ishte pjesë e mbrojtjes kushtetuese. Mund të pohojmë vetëm se vendimi i Court -it ishte i tmerrshëm.

Në dhjetorin e vitit 1920, pasi situata ishte qetësuar disi, Kongresi, pa asnjë lloj problemi, e tërhoqi *Sedition Act-in* në vitin 1918. Ndërmjet 1919 dhe 1923-it, qeveria liroi të gjithë ata individë të cilët ishin arrestuar si pasojë e *Sedition* dhe *Espionage Acts-it*. Dhjetë vite më pas, Presidenti Franklin Delano Rusvelt vendosi një amnisti për të gjithë këta individë, duke u rikthyer të drejtat politike dhe civile. Në gjysmën e shekullit të ardhshëm, Supreme Court anuloi të gjitha vendimet e marra gjatë Luftës së Parë Botërore, duke pohuar se secili nga individët e arrestuar ose të deportuar në atë periudhë për shkak të kundërshtimit të tyre, ishte dënuar për deklarata që duhej të mbroheshin nga Amendamenti i Parë.

Më 7 dhjetor 1941 Japonia sulmoi bazën e Pearl Harbour-it. Dy muaj më pas, më 17 shkurt 1942, Presidenti Rusvelt firmosi urdhrin ekzekutiv 9.066, i cili autorizonte ushtrinë të "gjente zona ushtarake nga të cilat çdo person me shtetësi amerikane duhet të përjashtohet". Edhe pse fjala "japonez" apo "japonez amerikan" nuk shfaqej kurrë në këtë urdhër, ishte i nënkuptuar fakti që u referohej në mënyrë ekskluzive personave me origjinë japoneze.

Në këtë masë, 120.000 shtetas me prejardhje japoneze u detyruan të linin banesat e tyre në Uashington, Nju Jork, Kaliforni, Oregon dhe Arizonë. Dy të tretat e këtyre individëve ishin shtetas amerikanë dhe përfaqësonin gati 90% të të gjithë japonezëve

amerikanë. Nuk u lëshuan akuza kundrejt këtyre shtetasve; ata nuk dinin arsyen për të cilën ishin larguar nga banesat e tyre. Nuk dinin ku po shkonin dhe për sa kohë do të qëndronin atje. Shumë familje humbën gjithçka kishin.

Me urdhër të policisë ushtarake u transportuan në një nga dhjetë kampet e izolimit të ndodhura në zona të izoluara. Burra, gra dhe fëmijë u vendosën në dhoma të mbipopulluara. U gjendën të rrethuar nga ushtarë dhe tela me gjemba dhe aty mbetën për tre vite të gjata.

2.3 Çështja “*Toyosaburo Korematsu VS. United States*”

Një nga rastet më të dukshme të deportimit të shtetasve japonezë, ishte ai i Toyosaburo Korematsut. Gjykata dha shpjegimin e mëposhtëm për këtë:

"Ne nuk i injorojmë vuajtjet e shkaktuara ndaj një grupi të gjerë shtetasish amerikanë. Por vuajtjet janë pjesë e luftës dhe lufta është një bashkësi vuajtjesh. Korematsu nuk u largua nga brigjet perëndimore për shkak të racës, por autoritetet ushtarake kanë vendosur që urgjenca e situatës së krijuar kërkonte që të gjithë shtetasit me origjinë japoneze të deportoheshin nga ajo zonë. Ne mund të pohojmë se këto iniciativa ishin të justifikuar."

Në vitin 1980, Kongresi krijoi Komisionin për Izolimin e Civilëve në Kohë Luftë, për të rishikuar internimin e japonezëve amerikanë. Në vitin 1983 Komisioni përmbylli në unanimitet se faktorët që provokuan izolimin "kishin paragjykitime raciale dhe falimentin e leadership-it politik", më tepër se nevoja ushtarake.

Pak kohë më vonë, një gjykatë federale me gradë më të ulët vendosi një parim të jashtëzakonshëm në rastin Korematzu, duke vërtetuar se agjentët e qeverisë ishin në dijeni në atë kohë për sa i përket largimit, se nuk ekzistonte asnjë nevojë ushtarake dhe se në vitin 1944 agjentët e qeverisë kishin gënjyer në mënyrë të qëllimshme Supreme Court-in mbi këtë çështje. Në anulimin e dënimit për Korematsu-n 40 vite më parë si pasojë e një padrejtësie të dukshme, gjyqtarja federale Merilin Hall Patel theksoi nevojën e një përgjegjësie të ekzekutivit.

Korematsu tregon një kujdes konstant me anë të të cilit në kohë lufte ose emergjence ushtarake institucionet duhet të vigjilojnë për të mbrojtur garancitë kushtetuese.

Ky rast tregon kujdesin me të cilin në kohë lufte institucionet ekzekutive, legjislative dhe gjyqësore duhet të jenë të përgatitura për të ushtruar autoritetin e tyre për të mbrojtur liritë kushtetuese të individëve.

- TOYOSABURO KOREMATSU VS. UNITED STATES.

No. 22.

Argued Oct. 11, 12, 1944.

Decided Dec. 18, 1944.

Paditësi, një qytetar amerikan me prejardhje japoneze, ishte dënuar në një gjykatë federale të distriktit për të qëndruar në San Leandro, Kaliforni, një 'Zonë Ushtarake', në kundërshtim me Përgjashtimin Civil, Urdhër Nr. 34 i Komandantit të Përgjithshëm [323 SHBA 214, 216] të Komandës Perëndimore, ushtrisë amerikane, i cili urdhëronte që pas 9 majit, 1942, të gjithë personat me prejardhje japoneze duhet të përjashtohen nga ajo zonë. Asnjë dyshim nuk u ngrit për besnikërinë e ankimesit ndaj Shteteve të Bashkuara. Gjykata e Apelit e konfirmoi dhe rëndësia kushtetuese e çështjes së përfshirë na nxiti drejt dhënies së certiorarit (një shkresë që kërkon shqyrtim gjyqësor).

Duhet të theksohet, si fillim, se të gjitha kufizimet ligjore që kufizojnë të drejtat civile vetëm të një grupi racor janë menjëherë të dyshimta. Kjo nuk do të thotë se të gjitha këto kufizime janë antikushtetuese. Kjo do të thotë se gjykatat duhet t'ia nënshtrojnë ato një shqyrtimi më të detajuar. Presioni i domosdoshmërisë publike nganjëherë mund ta justifikojë ekzistencën e kufizimeve të tilla, por antagonizmi racor nuk mundet kurrë.

Në këtë moment, ndjekja penale ndaj ankimesit filloi duke e akuzuar për shkelje të një akti të Kongresit, mars 21, 1942, 56 Stat. 173, 18 U.S.C.A. 97a, i cili parashikon se:

"... Kushdo që hyn, qëndron, largohet, ose kryen ndonjë veprim në ndonjë hapësirë ushtarakë apo zonë ushtarake të parashikuar nga ligji, nën autoritetin e një urdhri ekzekutiv të Presidentit, nga Sekretari i Luftës, apo nga ndonjë komandant ushtarak i caktuar nga Sekretari i Luftës, në kundërshtim me kufizimet e aplikueshme në çdo fushë

apo zonë të tillë, ose në kundërshtim me urdhrin e Sekretarit të Luftës apo ndonjë komandanti të tillë ushtarak, në qoftë se del se ai e dinte ose duhet të ketë ditur për ekzistencën dhe shtrirjen e kufizimeve apo urdhrave dhe që vepra e tij ishte në shkelje të tyre, do të jetë fajtor për kundravajtje dhe, pas njoftimit, fajtori i nënshtrohet një gjobe që nuk i kalon 5 \$, 000 ose me burgim për jo më shumë se një vit, ose të dyja, për secilën vepër ."

Urdhri i Përfundimit Nr. 34, që ankimesi me vetëdije dhe pa dyshim e ka shkelur, ishte nga një numër i urdhrave dhe deklaratave ushtarake, të cilat [323 SHBA 214, 217] janë bazuar kryesisht në Urdhrin Ekzekutiv nr. 9066, 7 Fed. Reg . 1407. Ky urdhër i lëshuar pasi ne ishim në luftë me Japoninë shpallte se "procedimi penal i suksesshëm i luftës kërkon çdo mbrojtje të mundshme kundër spiunazhit dhe kundër sabotimit të materialit kombëtar të mbrojtjes, godinat kombëtare të mbrojtjes dhe ndërmarrjet kombëtare të mbrojtjes.... "

Një prej serive të urdhrave dhe deklaratave, urdhrat e shtettrrethimit, të cilat ashtu si urdhrat e përfundimit janë shpallur në bazë të Urdhrit Ekzekutiv 9066, i nënshtrohen të gjithë personat me prejardhje japoneze në zonat e përcaktuara ushtarake të Bregut Perëndimor (West Coast) që të qëndrojnë në vendbanimet e tyre nga 8 e pasdites deri në 6 të mëngjesit. Siç është këturi rasti me urdhër i përfundimit, ai urdhër i mëparshëm i shtettrrethimit ishte projektuar si një "mbrojtje kundër spiunazhit dhe kundër sabotazhit." Në çështjen Kiyoshi Hirabayashi k. Shteteve të Bashkuara, 320 SHBA 81, 63 S.Ct. 1375, ne vendosem një dënim fituar për shkelje të urdhrit të shtettrrethimit. Dënimin i Hirabayashit, si edhe ky, mbështeten në të njëjtin akt të Kongresit të vitit 1942 dhe të njëjtat urdhra themelore ekzekutive dhe ushtarake, dhe të gjithë urdhrat kishin për qëllim rreziqet e dyfishta të spiunazhit dhe sabotimit.

Akti i vitit 1942 u kritikua në çështjen e Hirabayashit si një delegim antikushtetues i pushtetit; u pretendua se urdhri i shtettrrethimit dhe urdhrat e tjerë, mbi të cilat ai ndalej, ishin jashtë kompetencave të luftës së Kongresit, autoriteteve ushtarake dhe të Presidentit, si komandant i përgjithshëm i ushtrisë; dhe zbatimi i një urdhri të shtettrrethimit vetëm ndaj qytetarëve me prejardhje japoneze çoi në një diskriminim të

ndaluar me kushtetutë thjesht për shkak të racës. Këtyre çështjeve ne u dhamë një vlerësim serioze, çka e justifikoi vetë rëndësia e tyre. Ne e pranuan urdhrin e shtetrrëthimit si një ushtrim i kompetencave të qeverisë për të ndërmarrë hapat e nevojshëm për të parandaluar spiunazhin dhe sabotazhin në një zonë të kërcënuar nga sulmi japonez.

Nga pikëpamja e parimeve të shpallura në çështjen Hirabayashi, nuk jemi në gjendje të konstatojmë se ajo ishte përtej kompetencave të luftës së Kongresit dhe Ekzekutivit për të përjashtuar [323 SHBA 214, 218] ato me origjinë japoneze nga zona e luftës së Bregut Perëndimor në kohën që ata e kryen këtë veprim. Dhe vërtet, përjashtimi nga zona në të cilën ndodhet shtëpia e dikujt është një privim shumë më i madh sesa izolimi i vazhdueshëm në shtëpi nga ora 8 e pasdites deri në 6 të mëngjesit. Asgjë më pak se arrestimet e pashmangshme nga autoritetet përkatëse ushtarake të rrezikut të lartë për sigurinë publike nuk mund të justifikohet me kushtetutë. Por përjashtimi nga një zone e kërcënuar, jo më pak se shtetrrëthimi, ka një lidhje të caktuar dhe të afërt me parandalimin e spiunazhit dhe sabotimit. Autoritetet ushtarake, të ngarkuara me përgjegjësinë parësore për të mbrojtur brigjet tona, arritën në përfundimin se shtetrrëthimi ofron mbrojtje joadekuate dhe urdhëroi përjashtimin. Ata e bënë këtë, siç u vu në dukje sipas mendimit tonë në çështjen Hirabayashi, në përputhje me autoritetin e Kongresit të Ushtrisë për të thënë se kush duhet dhe kush nuk duhet të mbetet në zonat e kërcënuara.

Në këtë rast, ankimesi sfidon supozimet mbi të cilat shtrihen përfundimet tona në çështjen Hirabayashi. Ai gjithashtu bën thirrje se që nga maji i vitit 1942, kur Urdhri Nr. 34 ishte shpallur, i gjithë rreziku i pushtimit japonez të Bregut Perëndimor ishte zhdukur. Pas shqyrtimit të kujdesshëm të këtyre pretendimeve, ne jemi të detyruar që t'i hedhim poshtë.

Këtu, si në çështjen Hirabayashi më sipër, 320 SHBA në faqen 99, 63 S.Ct. në faqen 1385, "... ne nuk mund ta hedhim poshtë si të pabazuar gjykimin e autoriteteve ushtarake dhe të Kongresit se ka pasur anëtarë të pabesë të asaj popullsie, numri dhe forca e të cilëve nuk mund të jetë e përcaktuar saktë dhe shpejt. Ne nuk mund të themi

se degët e Qeverisë që bëjnë luftë nuk kanë pasur bazë për të besuar se në një moment kritik këta persona nuk mund të izoloohen dhe të trajtohen veçmas dhe se përbënin një kërcënim për mbrojtjen dhe sigurinë kombëtare, gjë e cila kërkoi që të merren masa të shpejta dhe adekuate për t'u mbrojtur kundër tij. "

Ashtu si shtetrrëthimi, përjashtimi i atyre me origjinë japoneze u konsiderua i nevojshëm për shkak të pranisë së një numri të dyshimtë të anëtarëve të pabesë të grupit, pjesa më e madhe [323 SHBA 214, 219] e të cilëve nuk kemi asnjë dyshim që ishin besnikë ndaj këtij vendi. Kjo ishte për shkak se ne nuk mund ta refuzojmë gjetjen e autoriteteve ushtarake se ishte e pamundur për të bërë një ndarje të menjëhershme të të pabesëve nga besnikët, prandaj kemi mbështetur vlefshmërinë e shtetrrëthimit që të aplikohet për të gjithë grupin. Në rastin konkret, përjashtimi i përkohshëm i të gjithë grupit u mbështet nga ushtria me të njëjtat kushte. Gjykimi se përjashtimi i të gjithë grupit ishte për të njëjtën arsye një domosdoshmëri ushtarake i përgjigjet pretendimit se përjashtimi ishte në natyrën e dënimit të grupit, të bazuar në antagonizëm të atyre me origjinë japoneze. Fakti se ka pasur anëtarë të grupit që i kanë qëndruar besnikë Japonisë është konfirmuar nga hetimet e bëra pas përjashtimit. Rreth pesë mijë qytetarë amerikanë me prejardhje japoneze nuk pranuan të betohen për besnikëri të pakualifikuar në Shtetet e Bashkuara dhe të heqin dorë për besnikëri ndaj perandorit japonez, dhe disa mijera nga të shperngulurit kërkuan riatdhesimin në Japoni.

Ne mbështesim urdhrin e përjashtimit në kohën që është bërë dhe kur ankimuesi e ka shkelur atë. Cf. Chastleton Corporation k. Sinclair, 264 SHBA 543, 547, 44 S.Ct. 405, 406; V bllok. Hirsh, 256 SHBA 135, 154, 155 S., 41 S.Ct. 458, 459, 16 A.L.R. 165. Duke vepruar kështu, ne nuk jemi të pakujdesshëm ndaj vështirësive të imponuara nga ai mbi një grup të madh të qytetarëve amerikanë. Cf. Ex parte Kumezo Kaeato, 317 SH.B.A.-69, 73, 63 S.Ct. 115, 117. Por vështirësitë janë pjesë e luftës, dhe lufta është një grumbull vështirësish. Të gjithë qytetarët njësoj, si brenda dhe jashtë uniformës, e ndiejnë ndikimin e luftës në masë të madhe ose të vogël. Shtetësia ka përgjegjësitë e veta, ashtu si dhe privilegjet e veta, dhe në kohë lufte barra është gjithmone e më e rëndë. [323 SHBA 214, 220] Përjashtimi i detyrueshem i grupeve të mëdha të

qytetarëve nga shtëpitë e tyre, përveç rrethanave të jashtëzakonshme dhe rrezikut, është në kundërshtim me institucionet tona themelore qeveritare. Por, kur në kushtet e luftës moderne, brigjet tona janë të kërcënuara nga forcat armiqësore, kompetenca për të mbrojtur duhet të jetë proporcionale me rrezikun e kërcënuar.

Është argumentuar se më 30 maj, 1942, data kur ankimuesi u akuzua për qëndrim në zonën e ndaluar, kishte disa urdhra konfliktuale të pazgjidhura, të cilat e ndalonin atë si të largohej ashtu dhe të qëndronte atje. Sigurisht që një person nuk mund të dënohet për faktin se kë bërë një gje e cila përbën një krim nëse nuk e bën. Por urdhrat në fjalë nuk përmbajnë komanda të tilla kontradiktore.

Kishte një urdhër të leshuar më 27 mars 1942, i cili ndalonte ankimuesit dhe të tjerët me prejardhje japoneze të largoheshin nga zona, por efekti i tij ishte në mënyrë të veçantë i kufizuar në kohë deri në masen që një njoftim apo urdhër i ardhshëm do ta lejojë apo udhëzojë këtë gjë. " 7 Fed.Reg. 2601. Ky "urdhër i ardhshëm", për shkeljen e të cilit është dënuar ankimuesi, është lëshuar më 3 maj, 1942, dhe ai solli përjashtimin e drejtpërdrejtë nga zona të të gjithë personave me origjinë japoneze para orës 12 në mesdite, 9 maj; për më tepër, ajo përmbante një paralajmërim që të gjithë personat që gjenden në zonën e ndaluar do t'i nënshtrohen dënimit në kuadër të Aktit të Kongresit të 21 marsit, 1942. Rrjedhimisht, urdhri i vetëm në fuqi, që lidhet me qëndrimin e ankimuesit në zonë më 30 maj, 1942, në datën e specifikuar në informacionin kundër tij, ishte urdhri i 3 majit, që ndalonte qëndrimin e tij atje, dhe ishte po i njëjti urdhër, të cilin ai e pranoi në gjyqin e tij se e ka shkelur, duke e ditur ekzistencën e tij. Prandaj nuk ka bazë për argumentin se më 30 maj, 1942, ai ishte objekt i dënimit, sipas urdhrave të 27 marsit dhe 3 majit, pavarësisht nëse ai qëndroi apo u largua nga zona.

Figuron se, megjithëse më 9 maj, data në fuqi e urdhrit të përjashtimit, autoritetet ushtarake tashmë kishin [323 SHBA 214, 221] vendosur që evakuimi duhet të bëhej duke grumbulluar se bashku dhe duke vendosur në ruajtje të gjithë ata me origjinë japoneze, në pika qendrore, të përcaktuara si "qendra të grumbullimit", në mënyrë që të sigurohej evakuimi i rregullt dhe zhvendosja e japoneze vullnetarisht, duke emigruar nga zona ushtarake nr. 1 për të kufizuar dhe rregulluar një migrim të tillë. " Njoftimi

publik Nr 4, 7 Fed.Reg. 2601. Edhe më 19 maj, 1942, 11 ditë para kohës që ankimesi u akuzua për qëndrimin në zonë në mënyrë të paligjshme, Urdhri Civil Kufizues Nr 1, 8 Fed.Reg. 982, parashikonte kushtet për ndalimin e atyre me prejardhje japoneze në qendrat e grumbullimit apo në qendrat e zhvendosjes. Është argumentuar tashmë se vlefshmëria e urdhrit të përjashtimit nuk mund të konsiderohet veçmas nga urdhrat që e kërkojnë atë, pas largimit nga zona, për të raportuar dhe për të qëndruar në një qendër grumbullimi ose zhvendosjeje. Pretendimi është se ne duhet t'i trajtojmë këto urdhra të veçanta si një e tërë dhe e pandashme; për këtë arsye, në qoftë se ndalimi në kuvend ose në qendren e zhvendosjes do ta kishte privuar në mënyrë të paligjshme ankimesin nga liria e tij, urdhri për përjashtim dhe dënimin e tij në bazë të saj nuk mund të qëndrojë.

Ne po na kërkohet të shqyrtojmë të gjithë programin e mëvonshëm të arrestit si në qendrat e grumbullimit ashtu dhe në ato të zhvendosjes, edhe pse të vetmet çështje të trajtuara në gjyq kanë lidhje me ankimesit që qëndrojnë në zonën e ndaluar në shkelje të urdhrit të debimit. Sikur ankimesi të largohej nga zona e ndaluar dhe të shkonte në një qendër grumbullimit, ne nuk mund ta marrim as si një çështje të vërtete ose ligjore, se prania e tij në atë qendër do të kishte rezultuar në arrestin e tij në një qendër zhvendosjeje. Disa që raportuan në qendrat e grumbullimit nuk u dërguan në qendrat e zhvendosjes, por u liruan me kusht që të mbeten jashtë zonës së ndaluar derisa urdhrat ushtarakë të modifikoheshin ose të hiqeshin. Kjo tregon se ato paraqesin probleme të ndryshme dhe mund të udhëhiqen nga parime të ndryshme. Ligjshmëria e njërit nuk vendos në mënyrë të domosdoshme mbi ligjshmërinë e të tjerëve. Kjo është e qartë [323 SHBA 214, 222] kur ne analizojmë kërkesat e dispozitave të veçanta dhe të urdhrave të veçantë. Këto kërkesa të veçanta kërkonin që ata me prejardhje japoneze (1) të largohen nga zona; (2) të raportohen dhe përkohesisht të qëndrojnë në një qendër grumbullimi; (3) t'i nënshtrohen kontrollit ushtarak në një qendër të zhvendosjes dhe të qëndrojnë atje për një periudhë të pacaktuar, derisa të lirohen me kusht ose pa kusht nga autoritetet ushtarake. Secila prej këtyre kërkesave do të vendosë detyra të ndryshme në lidhje me hapa të veçantë në një program të plote evakuimi. Sikur Kongresi të kishte përfshirë në një akt të vetëm keto urdhra të ndarë, dhe me kusht që të kishte sanksione për shkeljet e tyre, mosbindja e çdokujt do të përbënte një shkelje të veçantë. Cf. Blockburger k.

Shteteve të Bashkuara, 284 US 299, 304, 52 S.Ct. 180, 182. Nuk ka asnjë arsye pse shkelja e këtyre urdhrave, për aq sa ato janë shpallur në bazë të miratimit të kongresit, nuk duhet te trajtohet si vepër e veçantë.

Rasti Endo (Ex parte Mitsuye Endo) 323 SHBA 283, 65 S.Ct. 208, grafikisht ilustron dallimin në mes vlefshmërisë së një urdhri për përjashtimin dhe vlefshmërisë së një urdhri për arrest pasi përjashtimi është kryer.

Meqenëse ankimuesi nuk është dënuar për mosraportim apo qendrim në një qendër grumbullimi apo zhvendosjeje, në këtë rast nuk mund të përcaktojmë vlefshmërinë e atyre dispozitave të veçanta të urdhrit. Është e mjaftueshme kjo për ne që të shqyrtojmë urdhrin që ankimuesi ka shkelur. Nëse hetohet më shumë, nënkupton se kalojmë përtej çështjeve të ngritura për shqyrtim, dhe të vendosim për çështje të rëndësishme, që nuk përfshihen në kuadrin e parashtresave apo provave në këtë rast. Do të ketë kohë të mjaftueshme për të vendosur çështjet serioze kushtetuese që ankimuesi kërkon të ngrejë kur urdhri i qendrimit në qendrat e grumbullimit apo të zhvendosjes është aplikuar ose është e sigurt që do të aplikohet tek ai dhe ne i kemi këto kushte përpara nesh.

Disa nga anëtarët e Gjykatës janë të mendimit se evakuimi dhe ndalimi në një qendër grumbullimi janë të pandashëm. Pas 3 maj, 1942, data [323 SHBA 214, 223] e Urdhrit të përjashtimit Nr. 34, Korematsu ishte i detyruar të largohej nga zona jo sipas mënyres së tij, por nëpërmjet një qendre grumbullimi. Qendra e grumbullimit ishte konceptuar si një pjesë e pandashme e makinerisë për evakuim në grup. Kompetenca për të përjashtuar përfshin kompetencën për ta bërë atë me forcë, nëse është e nevojshme. Dhe çdo mase me force duhet domosdoshmerisht të kërkojë një shkallë të ndalimit ose kufizimit, pavarësisht nga metoda e heqjes që është zgjedhur. Por cilado pikëpamje të merret, rezulton se urdhri sipas të cilit ankimuesi është dënuar, ishte i vlefshëm.

Është thënë se ne kemi të bëjmë këtu me rastin e burgimit të një qytetari në një kamp përqendrimi vetëm për shkak të prejardhjes së tij, pa prova apo hetim në lidhje me besnikërinë e tij dhe prirje të mirë ndaj Shteteve të Bashkuara. Detyra jonë do të ishte e thjeshtë, puna jonë e qartë, nëse do të ishte ky një rast që përfshin burgosjen e një

qytetari besnik në një kamp përqendrimi për shkak të paragjykit racor. Pavarësisht nga natyra e vërtetë e grumbullimit dhe e qendrave të zhvendosjes, dhe ne e konsiderojmë të pajustificueshme t'i quajmë kampe përqendrimi me të gjitha konotacionet që termi nënkupton, nuk kemi të bëjmë në mënyrë specifike me asgjë tjetër veçse një urdhri përjashtimi. Futja në këtë rast në pershkrimet e paragjykit racial, pa iu referuar rreziqeve reale ushtarake, të cilat janë paraqitur, thjesht do ta ngatërronte më shumë çështjen. Korematsu nuk ishte përjashtuar nga Zona Ushtarake për shkak të armiqësisë ndaj tij apo racës së tij. Ai u përjashtua për shkak se jemi në luftë me Perandorinë Japoneze, sepse autoritetet në pajtim me ligjin ushtarak i frikësohen një pushtimi të Bregut tonë Perëndimor dhe u ndjenë të detyruar të marrin masat e duhura të sigurise, sepse ata vendosën që urgjenca ushtarake e situatës kërkonte që të gjithë qytetarët me prejardhje japoneze të izolohehen nga Bregu Perëndimor përkohësisht dhe, më në fund, për shkak se Kongresi, mbështetur në besimin e tij në kohë lufte tek udhëheqësit ushtarakë, në mënyrë të pashmangshme, përcaktonte se ata duhet të kenë kompetencën për të bërë pikërisht këtë. Ka pasur dëshmi për tradhti nga ana e disa, autoriteteve ushtarake dhe konsiderohet se nevoja për [323 SHBA 214, 224] veprim ishte e madhe, ndërsa koha ishte e shkurtër. Ne nuk mund të themi se në atë kohë këto veprime ishin të pajustificueshme.

E konfirmuar.

Z. Gjyqtar Frankfurter.

Sipas leximit tim të Urdhrit Civil të Përjashtimit nr. 34, ishte një shkelje për Korematsun që të gjendej në Zonën Ushtarake nr.1, në territorin ku ai jetonte më parë, me përjashtim brenda kufijve të Qendrës së Grumbullimit të kesaj zone. Edhe pse urdhrat e ndryshme të lëshuara nga gjenerali DeEitt mund të konsiderohen një kod gjithëpërfshirës udhëzimesh, përmbajtja e tyre është e qartë dhe jokontradiktore. Ata vënë mbi Korematsun detyrimin për të lënë Zonën Ushtarake nr. 1, por vetëm sipas mënyrës së përshkruar në udhëzim, d.m.th., duke raportuar në qendren e grumbullimit. Unë nuk jam në gjendje të kuptoj se si konsideratat ligjore që çuan në vendimin e Kiyoshi Hirabayashit k. Shteteve të Bashkuara, 320 US 81, 63 S.Ct. 1375, nuk

mbështesin këtë urdhër ushtarak. Dhe kështu unë bashkohen me mendimin e Gjykatës, por duhet të shtoj disa fjalë.

Dispozitat e Kushtetutës, të cilat akordojnë me ato të Kongresit dhe kompetencat e Presidentit për të mundësuar këtë vend për të bërë luftë, janë po aq pjesë e Kushtetutës, sa edhe dispozitat në kërkim të një kombi në paqe. Citojmë këtu deklaratën e ish-shefit të Drejtësisë, Hjuks, se kompetenca e qeverisë për luftë është "kompetenca për të zhvilluar me sukses luftën." Hirabayashi k. Shteteve të Bashkuara, 320 SHBA në faqen 93, 63 S.Ct. në faqen 1382 dhe shih faqen Bldg. & L. Ass'n k. Blaisdell, 290 SHBA 398, 426, 54 S.Ct. 231, 235, 88 A.L.R. 1481. Prandaj, vlefshmëria e veprimit në bazë të kompetencave të luftës duhet të gjykohet tërësisht në kontekstin e luftës. Ai veprim nuk është për t'u stigmatizuar si i paligjshëm, sepse veprime të tilla në kohë paqeje do të ishin të paligjshme. Për të folur për një urdhër ushtarak që shpreh një gjykim të lejueshem të nevojave të luftës "një [323 SHBA 214, 225] urdhër kushtetues", pikërisht nga ata që u besohen detyrat e kryerjes së luftës, do të thotë që t'i japësh një pjesë të Kushtetutës një muancë antikushtetutshmërie. Sferat përkatëse të veprimit të autoriteteve ushtarake dhe të gjyqtarëve janë sigurisht shumë të ndryshme. Por brenda sferës së tyre, autoritetet ushtarake nuk janë më shumë jashtë kufijve të bindjes ndaj Kushtetutës seç janë gjyqtarë brenda tyre. "Kompetenca dhe Lufta e Shteteve të Bashkuara, si kompetencat e tjera të saj... janë subjekt i kufizimeve të zbatueshme kushtetuese", Hamilton k. Kentucky Distilleries, Co, 251 US 146, 156, 40 S.Ct. 106, 108.

Z. Gjyqtar ROBERTS.

Unë jam disident, sepse mendoj që faktet e padiskutueshme shfaqin një shkelje të qartë të të drejtave kushtetuese.

Ky nuk është rasti i ndalimit të njerëzve në rrugë natën, siç ishte ai i Kiyoshi Hirabayashit k. Shteteve të Bashkuara, 320 US 81, 63 S.Ct. 1375, [323 SHBA 214, 226] as rast i përjashtimit të përkohshëm të një qytetari nga një zonë për sigurinë e tij apo atë të komunitetit, as një rast i cili ofron një mundësi për të shkuar përkohësisht nga një

zonë ku prania e tij mund të shkaktojë rrezik për veten ose për shokët e tij. Në të kundert, është rasti i dënimit të një qytetari si ndëshkim për mosparaqitjen në burg, në një kamp përqendrimi, bazuar në prejardhjen e tij, dhe vetëm për shkak të prejardhjes, pa prova apo hetim në lidhje me besnikërinë e tij dhe prirje të mirë ndaj Shteteve të Bashkuara. Nëse kjo është një deklaratë e saktë e fakteve të publikuara nga ky rast, dhe faktet nga të cilat kemi marrë njoftim gjyqësor, nuk kam nevojë të mundohem për të dalë në përfundimin se janë shkelur të drejtat kushtetuese.

Argumenti i Qeverisë dhe mendimi i gjykatës, sipas gjykimit tim, gabimisht ndajnë atë që është një e vetme dhe e pandashme dhe kështu të bëjnë rastin të duket sikur ankimuesi ka shkelur një urdhër ushtarak, sanksionuar nga Akti i Kongresit, i cili e ka dëbuar atë nga shtëpia e tij, duke refuzuar vullnetarisht të largohet dhe, kështu, me vetëdije dhe qëllimisht, ka sfiduar urdhrin dhe Aktin e Kongresit.

Ankimuesi, një banor i San Leandros, Alameda Kaunti, Kaliforni, është një vendas i Shteteve të Bashkuara me origjinë japoneze që, sipas dëshmive, është një shtetas besnik i kombit.

Një renditje kronologjike e ngjarjeve do ta bëjë të qarte se, në të vërtetë, veprimi i ankimuesit nuk konsiston në refuzimin e tij vullnetarisht që të largohet nga zona që përfshinte shtëpinë e tij duke iu bindur urdhrin për ta dëbuar prej saj. Vëmendje kritike duhet t'u jepet datave dhe rrjedhjes së ngjarjeve.

8 dhjetor 1941, Shtetet e Bashkuara i shpallin luftë Japonisë.

19 shkurt 1942, Presidenti lëshoi urdhrin ekzekutiv nr. 9066, i cili deklaroi arsyet për lëshimin e [323 US 214, 227] e urdhrin "për mbrojtje kundër spiunazhit dhe kundër sabotimit, të materialit nacionalist të mbrojtjes dhe shërbimet kombëtare të mbrojtjes", me kusht që komandantët e caktuar ushtarakë mund të "përshkruajnë zonat ushtarake" dhe të percaktojnë shtrirjen e tyre", nga e cila ndonjë apo të gjithë personat mund të përjashtohen dhe për të cilën e drejta e ndonjë personi për të hyrë, qëndruar, ose larguar do të jetë subjekt i kufizimeve të Komandantit Ushtarak.

Më 20 shkurt 1942, gjenerali DeEitt ishte caktuar ushtarak i Komandës së Mbrojtjes Perëndimore, duke përfshirë shtetet perëndimore e Unionit, rreth një e katërta e sipërfaqës së përgjithshme të kombit.

Më 2 mars 1942, gjenerali DeEitt paraqiti shpalljen publike nr. 1, 2, sipas të cilës i gjithë Bregu Paqësor "i nështrohet sulmit, të pushtimit... dhe, ne lidhje me këtë, është subjekt i spiunazhit dhe i akteve të sabotimit". Ajo thekson se për shkak të domosdoshmërisë ushtarake, "zona të caktuara ushtarake njihen si zona ushtarake nr. 1 dhe 2. Ajo shton se "këta persona ose grupe personash në situata të caktuara mund të kërkojnë me urdhër të mëvonshëm "të përjashtohen nga e gjithë Zona Ushtarake Nr. 1" dhe nga zona të caktuara Ushtarake të Zonës Nr. 2. Shpalljet e mëvonshme, së bashku me Shpalljen nr.1, përfshinin zonat të tilla si të gjithë Kaliforninë, Uashingtonin, Oregonin, Aidahon, Montanën, Nevadën dhe Utahën, si edhe pjesën jugore të Arizonës. Këta urdhra përcaktonin se, në rast se një person me prejardhje japoneze, gjermane ose italiane banon në Zonën nr. 1 dhe i kërkohet të ndryshojë vendbanimin e zakonshëm, ai duhet t'u nënshkruajë dhe dorëzojë autoriteteve një ndryshim të Njoftimit të Rezidences.

San Leandro, qyteti i banimit të ankimesit, ndodhet në Zonën Ushtarake nr.1 [323 SHBA 214, 228]. Më 2 mars 1942, paditësi kishte vënë re se, me urdhër ekzekutiv, Presidenti, për të parandaluar spiunazhin dhe sabotimin, kishte autorizuar ushtrinë për ta dëbuar atë nga zona të caktuara si edhe për të parandaluar hyrjen e tij në disa zona të caktuara pa leje. Ai ishte njoftuar që qyteti i tij ishte i përfshirë në Urdhrin Ushtarak, në Zonën nr. 1 dhe ai ishte njoftuar më tej se, në të ardhmen, Komandanti Ushtarak do të japë një urdhër për përjashtimin e personave të caktuar nga zona të ndryshme, duke përfshirë edhe atë në të cilën ai jetonte.

Më 21 mars 1942, Kongresi vendosi se kushdo që me vetëdije "do të hyje, mbetet, lërë, ose kryejë ndonjë veprim në çdo zonë ushtarake të parashikuar... nga çdo komandant ushtarak ... në kundërshtim me kufizimet e zbatueshme për ndonjë zonë ose zona të tilla, apo në kundërshtim me urdhrin e... çdo komandanti i tillë ushtarak "do të jetë fajtor për kundërvajtje. Ky është akti në bazë të të cilit është akuzuar ankimesi.

Më 24 mars 1942, gjenerali DeEitt vendosi me urdhër shtetrrëthimin për zona të caktuara brenda komandës së tij, vlefshmëria e të cilit është mbështetur nga çështja Hirabayashi k. Shteteve të Bashkuara.

Më 24 mars 1942, gjenerali DeEitt nxori një seri urdhrash përjashtimi në lidhje me zona të specifikuar.

Më 27 mars 1942, me Shpalljen nr. 4, Gjenerali citoi se "është e nevojshme, me qëllim sigurimin e mirëqenies dhe të evakuimit të rregullt dhe të zhvendosjes së japonezëve vullnetarisht në Zonën Ushtarake nr. 1, që të kufizohet dhe të rregullohet diçka e tillë"; dhe urdhëroi që, qysh nga 29 marsi 1942, "të gjithë personat e huaj japonezë dhe me prejardhje japoneze që janë brenda kufijve të Zonës Ushtarake nr.1, ndalohen të lënë atë zonë për ndonjë qëllim në një shpallje apo urdhër tjetër.

Asnjë urdhër nuk e përjashtonte kërkuesin nga zona në të cilën ai jetonte. Me Shpalljen nr.4, pas 29 marsit 1942, ai u kufizua në kufijtë e Zonës Nr 1. Nëse Urdhri Ekzekutiv nr. 9066 dhe Akti i Kongresit do të pretendonin atë që shprehnin, për largimin nga ajo zonë, në emër të Shpalljes nr. 4, do të përbënte një kundërvajtje.

Më 3 maj 1942, gjenerali DeEitt lëshoi Urdhrin Civil të dëbimit Nr. 346 me kusht që, pas orës 12, 8 maj 1942, të gjithë personat me prejardhje japoneze, si të huaj dhe jo të huaj, ishin të përjashtuar nga një pjesë e Zonës Ushtarak Nr. 1, e cila përfshinte qarkun e Alamedës, Kaliforni. Urdhri kërkonte që një anetar i çdo familjeje duhet të raportonte në kohë të caktuar, në një stacion të kontrollit civil për udhëzime në lidhje me largimin në një qendër grumbullimi, duke shtuar se çdo person i cili nuk është në përputhje me dispozitat e urdhrin dhe gjendet në zonën e përshkruar pas datës së caktuar do t'i nënshtrohet ndjekjes penale sipas Aktit të 21 marsit 1942. Është e rëndësishme të theksohet se urdhri nuk ka si qëllim personat brenda kufijve "të një qendre grumbullimi në bazë të udhëzimeve nga ky shtab" Qëllimi i qartë i urdhrave ishte dëbonin të gjithë qytetarët me prejardhje japoneze në qendrat e grumbullimit në zonat e banimit të tyre, nën presionin e ndjekjes penale [323 SHBA 214, 230]. Gjendja në të cilën ankimesi në fjale u gjet, ishte si më poshtë: Ai ishte ndaluar, me urdhrin ushtarak, të

largohej nga zona në të cilën jetonte; ai u ndalua, me urdhër ushtarak, pas një date të caktuar, të qëndronte brenda asaj zone, nëse nuk ndodhej në një qendër grumbullimit të vendosur në atë zonë. Raporti i përgjithshëm i DeEitt ndaj Sekretarit të Luftës në lidhje me programin e evakuimit dhe zhvendosjen e japonezeve e bën plotësisht të qartë që, po të ishte e nevojshme t'i referohemi atij dokumenti, - dhe unë mendoj se nuk është e nevojshme, - një qendër grumbullimi ishte një eufemizëm për termin burg”. Asnjë person brenda një qendre të tillë nuk lejohej të largohej përveçse me urdhër ushtarak.

Në dilemen midis faktit se ai nuk guxon të qëndrojë në shtëpinë e tij, apo të largohet vullnetarisht nga zona, pa pësuar dënime penale, dhe faktit se e vetmja mënyrë që ai mund të shmangte dënimin ishte të shkonte në një qendër grumbullimi dhe të dorëzohej në një burg ushtarak, ankimuesi nuk bëri asnjë prej këtyre veprimeve .

Më 12 qershor 1942, një informacion është paraqitur në Gjykatën e Qarkut për pjesen veriore të Kalifornisë, me akuzën për shkelje të Aktit të 21 marsit 1942, në lidhje me faktin se ankimuesi kishte mbetur me vetëdije brenda zonës së përfshirë në urdhrin e përjashtimit nr. 34. Ankimuesi është gjykuar me pretendimin e tij si jofajtor dhe me pas është dënuar. Dënimi u pezullua dhe ai u vu në provë për pesë vjet. Megjithatë, ne e dimë, nga sa më lart, se ai u mor menjëherë në paraburgim ushtarak dhe u paraqit në një qendër grumbullimi. Ne e dimë më tej se, më 18 mars 1942, Presidenti shpalli Urdhrin Ekzekutiv të Zhvendosjes nr. 91027 bazuar në Autoritetin e Luftës, sipas të cilit të ashtuquajturat Qendra të Zhvendosjes, një eufemizëm për kampet e përqendrimit, u ndërtuan në bazë të bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve ushtarake të Komandës Perëndimore të Mbrojtjes dhe Autoritetit të Zhvendosjes dhe se ankimuesi [323 SHBA 214, 231] ose ishte i mbyllur në një qendër grumbullimi brenda zonës, në të cilën ai kishte jetuar ose është larguar në një qendër të zhvendosjes, ku faktet treguan që Mitsuye Endo, 323 SHBA 283, 65 S.Ct. 208, është mbajtur në mënyrë të paligjshme në paraburgim.

Qeveria e ka argumentuar këtë rast duke thënë se ky ishte i vetmi urdhër në kohën kur ankimuesi u arrestua dhe informacioni ishte në kundërshtim me Urdhrin e Përjashtimit nr. 34, i cili i kërkonte atij të largohej nga zona në të cilën banonte, e cila ishte baza e

informacionit kundër tij. Ky argument ka qenë dukshëm në fuqi. Ky opinion i referohet rastit Hirabayashi dhe tregon se kjo gjykatë ka mbështetur vlefshmërinë e urdhrit të orës policore (shtettrrethimi) në raste emergjence. Bazuar në këtë argument, përjashtimi nga një zonë e caktuar e rrezikut përbën një zgjidhje të përkohshme, e cila është e nevojshme në një emergjencë të papritur. 8 Liria e çdo qytetari amerikan për të lëvizur lirisht duhet të kufizohet përkohësisht, ose të pezullohet përballë rrezikut të papritur. Autoritetet civile duhet t'i përjashtojnë shpesh qytetarët përkohësisht nga një zonë e caktuar. Vizatimi i vijave të zjarrit në rastin e një zjarri, largimi i personave nga zona ku një murtajë ka shpërthyer, janë shembuj të njohur. Nëse Urdhri i Përjashtimit nr. 34 do të ishte i kësaj natyre, rasti Hirabayashi do të përbënte një bazë për të mbështetur atë. [323 SHBA 214, 232] Por siç tregojnë faktet e mësipërme si dhe ato të përcaktuara në rastin e *Metsuye Endos*, përjashtimi ka qenë vetëm pjesë e një plani të përgjithshëm për arrestim të detyruar. Ky rast nuk mund, pra, të përcaktohet në një bazë të tillë të njëjtë me vlefshmërinë e mundshme të një urdhri të përkohshëm të dëbimit, sipas të cilit banorëve të një zone u është dhënë një mundësi për t'u larguar dhe të shkojnë diku tjetër në tokën e tyre amtare, jashtë kufijve të një zone ushtarake. Një supozim i tillë do të thotë të hapësh sytë para realitetit.

Siç e kam thënë më lart, ankimuesi, para arrestimit të tij, u përball me dy urdhra diametralisht kundërtë mbi sanksion të Aktit të Kongresit të 21 marsit 1942. Urdhri i parë e bën ankimuesin kriminel nëse ai largohet nga zona në të cilën ai banon; i dyti e bën një kriminel nëse ai nuk largohet.

Unë mendoj se, në qoftë se një qytetar është i kufizuar nga dy ligje, ose dy urdhra që kanë fuqinë e ligjit dhe bindja ndaj njërit do të shkelte tjetrin, ndëshkimi i tij për këtë shkelje do të ishte në kundërshtim me një proces të rregullt ligjor. Në këto rrethana, unë mendoj se një dënim për shkeljen e një prej urdhrave nuk mund të qëndrojë.

Ne nuk mund të mbyllim sytë për faktin se nëse ankimuesi u përpoq të shkelë Shpalljen nr. 4 dhe u largua nga zona ushtarake në të cilën jetoi, ai do të ishte arrestuar, gjykuar dhe dënuar për shkeljen e Shpalljes nr. 4. Dy urdhrat kontradiktorë, njëri që e urdhëron të qëndrojë dhe tjetri që e urdhëron të largohet, ishin veçse një kurth i ngritur për të

përmbushur qëllimin e vërtetë të autoritetit ushtarak, i cili kërkon ta bllokojë atë në një kamp përqendrimi. Mënyra e vetme me të cilin ankimesi mund të shmangë arrestimin ishte që të shkonte në një kamp në bazë të udhëzimeve të dhëna kur ai njoftoi në qendrën e kontrollit civil. [323 SHBA 214, 233]. Këto realitete përballen me sugjerimin se është e ligjshme të detyrosh një qytetar amerikan t'i bindet arrestimit të paligjshëm me supozimin se do t'i jepet mundësia të aplikojë për lirim, duke paditur një dokument të Habeas Corpus (Urdhër për sjelljen para trupit gjykues), pasi ai të shkojë në qendrën e grumbullimit, siç u bë edhe në rastin e Endos më lart. Përgjigja sigurisht pohon se kur ishte subjekt i dy ligjeve kontradiktore, ai nuk ishte i detyruar të dorëzonte lirinë e tij për një periudhë të caktuar në mënyrë të tillë që t'i shpëtonte dhunimit të njerit prej këtyre ligjeve apo tjetrit. Nga ana tjetër, nuk mund të themi se arrestimi ishte pjesë e rëndësishme e procesit të evakuimit. Pra, në këtë rast, kemi të bëjmë me vlefshmërinë e këtij të fundit.

Përsëri është një doktrinë e re e doktrinës kushtetuese fakti se dikush i akuzuar për mosbinndje ndaj një ligji jokushtetues, nuk mund të mbrohet bazuar në pavlefshmërinë e ligjit, por duhet t'i bindet atij, edhe pse ai e di shumë mirë që nuk është ligj dhe, pasi të ketë vuajtur dënimin dhe të ketë humbur lirinë me vendim gjykate, t'i jepet mundësia brenda mureve të burgut që të provojë vlefshmërinë e ligjit.

2.4 Lufta e Ftohtë

Disa vite më vonë, Presidenti Ronald Reagan nënshkroi *Civil Liberties Restoration Act*, në vitin 1988, i cili trajtonte të gjitha akuzat e presidencës dhe akordonte një dëmshpërblim për të gjithë japonezet amerikanë të izoluar për shkak të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara. Kur Lufta e Dytë Botërore po i drejtohej fundit, Shtetet e Bashkuara hynë në Luftën e Ftohtë. Atëherë kur Lidhja me Bashkimin Sovietik filloi të rregullohej, Presidenti Harri Truman mburrej për faktin se i kishte shtuar shërbimit civil amerikan një program ekstrem besnikërie. Kishte shumë kufizime ndaj antikomunizmit të Trumanit. Në vitin 1950, ai vendosi veton mbi *Internal Security Act* të McCarren, i cili parashikonte regjistrimin e të gjithë komunistëve. Kongresi e miratoi ligjin duke

tejkualuar veton e Trumanit. Katër vite më vonë, po vetë Kongresi miratoi *Communist Control Act* të vitit 1954, i cili i hoqi Partisë Komuniste të gjitha privilegjet dhe të drejtat. Kjo kanosje antikomuniste goditi të gjithë kombin dhe prodhoi një seri kufizimesh federale dhe lokale të lirisë së shprehjes dhe të mbledhjes. U regjistruan edhe dënime penale për titullarët e Partisë Komuniste të Shteteve të Bashkuara.

Për këto fakte u shpreh edhe Supreme Court-i. Vendimi kryesor ishte *Dennis VS. United States*¹⁹, i cili përfshiu dënimin e drejtpërdrejtë të krerëve të Partisë Komuniste Amerikane. Me një vendim të marrë me pëlqimin e gjashtë gjyqtarëve kunder dy të tjerëve, në vitin 1951, Court-i vendosi që kërkuesit mund të dënoheshin për opinionet e shprehura prej tyre në lidhje me një *danger test*²⁰ të qartë dhe të menjëhershëm, edhe pse Court-i lejoi veprime investiguese në dëm të organizatave dhe personave "subversivë" dhe përjashtimin e anëtarëve të Partise Komuniste nga profesionet ligjore, nga detyrat elektive dhe nga administrata publike. Duke vepruar në këtë mënyrë, Court-i dha në mënyrë eksplicite konsensusin mbi një seri vendimesh që sot mund t'i quajmë shembuj të Makartizmit.²¹

Ashtu si në rastin Korematsu, gjyqtarët nuk përjashtohen nga frika dhe nga bindjet e atyre kohëve. Pra, ata ishin sigurisht të influencuar nga klima antikomuniste që rëndonte në ato vite dhe mbi ta, që t'u rezistonin presioneve ideologjike dhe emotive të antikomunizmit, çka kërkonte një kurajo dhe një pjekuri të jashtëzakonshme, cilësi që u mungonin gjyqtarëve të asaj kohe. Shpeshherë, ata ndiheshin gati të detyruar të kërkonin rezultate që nuk mbështeteshin në fakte.

¹⁹ 341 U. S. 494 (1951)

²⁰ Danger Test përbën një institut juridik, mbi bazën e të cilit një sjellje mund të sanksionohet si shkak i provokimit të alarmit edhe në mungesë të një rreziku efektiv.

²¹ Shih psh. *Adler VS Board of education* 342 U. S. 485 (1952); *Garner VS Public Works*, 341 U. S. 716 (1951); *Barenblatt VS United States*, 360 U. S. 109 (1959)

Në vitet '50 Supreme Court-i ndryshoi rrugë. Me një seri ndryshimesh brenda vetë Court-it dhe me ndryshimin e klimës botërore dhe kombëtare, Court-i pati një rol thelbësor në përfundimin e kësaj periudhe.²²

Në Luftën e Vietnamit, ashtu si në Luftën Civile dhe në Luftën e Parë Botërore, pati një kundërshtim si për luftën ashtu dhe për shërbimin ushtarak. Nga të gjitha këto periudha historike mund të arrijmë në konkluzione të rëndësishme. Mund të pohojmë se Kushtetuta aplikohet në kohë lufte, por nevojat e veçanta të saj mund të kushtëzojnë edhe aplikimin e Kartës Thelbësore. Siç e pamë, Qeveria në gjendje emergjence disponon justifikime për kufizimin e të drejtave dhe garancive të personit, gjë që nuk do të thotë se gjykatat nuk i kryejnë detyrat e tyre përballë thirrjes së sigurisë kombëtare, ose të nevojave ushtarake.

Shtetet e Bashkuara kanë një histori të gjatë dhe të hidhur reaksionesh të shproporcionuara të rreziqeve në kohë lufte. I kanë lejuar frikës të bëjë, si të thuash, më të mirën. Lufta prodhon një psikologji të fortë dhe në masë të tillë, që çënon thellësisht liritë civile. Frika ushqen frikën. Patriotizmi mbretëron. Amerikanët janë një popull i bashkuar. Pra, të drejta apo të gabuara, vendimet e Qeverisë mbështeten gjithnjë në interes të vendit. Disa herë duket e lehtë t'i kërkojë disa individëve në kohë lufte të sakrifikohen dhe disa të tjerëve të heqin dorë nga të drejtat e tyre të gëzuara në kohë paqe. Siç e mbështeti edhe Supreme Court-i në rastin Korematsu: "*Vuajtjet janë pjesë e luftës dhe lufta është një bashkësi vuajtjesh*". Për të zhvilluar një luftë është e nevojshme që ushtarët të vënë në rrezik jetën e tyre, lirinë e tyre, gjë që nuk është e nevojshme për të tjerët.

Shpeshherë thuhet se në kohë lufte presidentët nuk mbështeten në Kushtetutë. Ministri i drejtësisë, Frensis Bidëll, një herë u shpreh se "nuk ka asnjë logjikë të mendohet se presidentët e ardhshëm në kohë lufte të veprojnë ndryshe nga Linkoln, Uillsoni dhe Rusvelti."

²² Shih psh *Yates VS United States*, 354 U. S. 298 (1957); *Gibson VS Florida Legislative Investigatin Committee*, 372 U. S. 539 (1963); *Elfbrand VS Russell*, 384 U. S. 11 (1966).

Gjyqtari Rehnkuist afirmoi se "një vendim në favor të lirive civile do të përbëjë një precedent për të disiplinuar iniciativat e ardhshme të Kongresit dhe të Ekzekutivit në luftat e ardhshme"²³.

2.5 Patriot Act

Ngjarjet katastrofike të shtatorit 2001 e kanë ndryshuar në mënyrë radikale politikën amerikane. Në fakt, dëgjohen shpesh kritika mbi mendimin "para shtatorit", si ajo ditë e tmerrshme të ishte një moment mendimi dhe reflektimi. Ka qenë një ditë me emocione dhe vendosmëri. Dhe, në këtë mënyrë qasemi në mendimin "pas shtatorit". Përfaqësia politike e këtij "mendimi të ri" edhe USA PATRIOT ACT, i transformuar në ligj më datë 26 tetor 2001. Siç vërehet në dokumentet, debatet në Kongres mbi Patriot Act-in janë karakterizuar nga një vendim i thjeshtë, por në një atmosferë solidariteti bipartizan, Kongresi kodifikoi prioritetet e reja kombëtare nga siguria kombëtare e deri te lufta ndaj krimit të organizuar dhe terrorizmit. Kombi miratoi ligje të reja për të luftuar terrorizmin, duke kalibruar sërish ekuilibrin mes të drejtave individuale dhe sigurisë publike, në mënyrë që të bënte diskutimin publik dhe pronësinë private shënjestër private të ligjshme në luftën kundër terrorit. 342 faqet e Patriot Act-it janë miratuar me një mazhorancë absolute nga ana e kongresit. Vetëm një senator votoi kundër. Kishte një mbështetje bipartizane për autoritetet e vigjilencës, si një shpirt patriotizmi i orientuar nga Capitol Hill. Por, në disa pika, udhëheqësit politikë amerikanë e dinë se kanë vepruar me shpejtësi, të rrembyer nga dëshira e momentit. Drama dhe kuptimi i shtatorit kanë prekur ndryshimin e kulturës politike amerikane. Duke filluar nga sulmet në World Trade Center dhe në Pentagon, do të ilustroj, nëpërmjet dokumenteve, urgjencën e adoptimit të këtyre masave për të mbrojtur Shtetet e Bashkuara nga rreziku i terrorizmit. Këto dokumentë përfshijnë statute federale, seanca kongresi, debate në senat, konferenca shtypi në Shtëpinë e Bardhë, intervista me politikanë. Patriot Act-i mund të konsiderohet ligji më i gjatë, i gjerë dhe më prekës i gjithë historisë së Shteteve të Bashkuara.

²³ Eilliam R. Rhenquist (1998). *"All the laws but one: civil liberties in wartime 222*. (Random House).

Në vitin 2003, Uashington Post u paraqiti këtë sondazh amerikanëve: "Në hetimet kundër terrorizmit mendoni se agjencitë federale si FBI po çenojnë të drejtën e privacy-s të amerikanëve?". Në atë periudhë, 33% e amerikanëve u përgjigjen në mënyrë negative, për ata qeveria nuk ndërhynte në jetën private. Ndërsa 58% kishin perceptuar një ndërhyrje të madhe të qeverisë amerikane në jetën e tyre private. Duke marrë në konsideratë 58% që e perceptonte ndërhyrjen e qeverisë, vetëm 29% vlerësonin se kjo ndërhyrje ishte e pajustificuar, ndërsa 63% e vlerësonin legjitime dhe të justifikuar. Vetëm tre vite më vonë, në dhjetorin e vitit 2006, i njëjti sondazh iu paraqit nga Uashington Post amerikanëve. Por, këtë herë, vetëm 30% ishte e mendimit se qeveria nuk po luftonte akte cënuesë të lirise personale, 66% tjetër ishte e mendimit të kundërt. Nga këto, 66% më tepër se gjysma mendonin se këto ndërhyrje në sferën personale të individëve ishin të justifikueshme. Kjo përqindje mbështeste fushatën e Presidentit Bush kundër terrorizmit, që në mënyrë kaq të egër kishte goditur Shtetet e Bashkuara.

Mw 11 Shtator 2001, Presidenti Bush gjendej në Florida, në një shkollë fillore. Pak minuta pas ardhjes së tij mori lajmin e rrëzimit të avioneve mbi Pentagon dhe Kullat Binjake. Të nesërmen, pas sulmeve, Bushi vendosi të kthehej në Uashington për të mbështetur kombin në një moment kaq kritik. Në ditarin e tij Bushi shkruan: *"The Pearl Harbour of the 21st century took place today.....we think it's Osama Bin Laden"- "Pearl Harbour -i i shekullit të 21 ndodhi sot....ne mendojmë se ka qenë Osama Bin Laden".*

"Në ditën pas 9/11, presioni mbi Kongresin për të bërë diçka dramatike për të mbrojtur vendin nga sulmet terroriste ishte i shfrenuar. Administrata e Presidentit Bush dëshironte të rishkruante të gjithë trupin e ligjit për të përcaktuar dhe kufizuar mbikëqyrjen e qeverisë, dhe udhëheqësit e Kongresit e dinin se opozita do ta vlerësonte si dobësi nga ana e elektoratit amerikan. Patriot Act i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, i hartuar nga Departamenti i Drejtësisë, duket të jetë mjeti i duhur për të kryer sa më sipër. I përshtatur për të mbrojtur Shtetet e Bashkuara kundër kërcënimeve të papara dhe taktikat e terroristëve, ai do të zgjerojë kompetencat e zbatimit të ligjit dhe agjencitë e inteligjencës në mënyrë të përshtatshme për botën post 11-Shtatorit 2001."

Patriot Act-i u kritikua rëndë nga organizatat në mbrojtje të të drejtave të shtetasve sepse këto organizata shprehen se ky ligj "vret" lirinë. Sipas organizatave, ky ligj shkakton:

- Pakësimin e të drejtave të qytetarëve
- Cënimin e privacy-së
- Pakësimin e lirisë së shprehjes

Ligji lejonte CIA-n dhe FBI-në dhe autoritetet e tjera të sigurojnë publike të kërkonin përgjime telefonike dhe telematike pa asnjë mandat të autoriteteve gjyqësore dhe pa lajmëruar të interesuarit e drejtpërdrejtë.

Senatori Ras Feinold shprehu opinionin e tij: *"Nuk ka dyshim nëse kemi jetuar në një shtet policor, do të jetë më e lehtë për të kapur terroristët. Nëse kemi jetuar në një vend ku lejohet të kërkosh shtëpinë tonë në çdo kohë, për çdo arsye; nëse kemi jetuar në një vend ku qeveria është e legjitimuar për të hapur komunikimin tuaj e-mail; nëse kemi jetuar në një vend ku njerëzit mund të mbahen në burg për një afat të pacaktuar, bazuar në atë çka ato shkruajnë ose mendojnë, ose në bazë të një dyshimi të thjeshtë, qeveria ndoshta do të zbulojë dhe arrestojë më shumë terroristë, ose që mund të jenë terroristë. Por nuk do të ishte një vend në të cilin do të donim të jetonim, dhe nuk do të ishte një vend për të cilin ne, me ndërgjegje të pastër, mund të kërkonim që të rinjtë tanë të luftonin për të vdekur. Me pak fjalë, ky vend nuk do të ishte Amerika Kjo është arsyeja pse e konsiderojmë propozimin e këtij ligji për të minimizuar shkeljet e lirive civile të rëndësishëm dhe të nevojshëm."*

Lideri Dashëll e ndërpreu me shpejtësi Feingoldin, duke shpjeguar: *"Vështirësia ime nuk është thelbësore, por më tepër procedurale..... E kam studiuar këtë projekt-ligj dhe nuk ka shumë gjëra mbi të cilat mund të përmirësoja diçka..... Ajo që ne bëmë ishte për të thënë: Le ta marrim këtë produkt dhe të punojmë me te; le ta shqyrtojmë; nëse duhet të bënim disa ndryshime, le t'i konsiderojmë ato; por le të pranojmë se, në qoftë se do ta marrim këtë projekt-ligj nga fillimi në fund, nuk do t'u jepej fund amendamenteve..... argumenti im nuk është substancial. Ai është procedural. Ne kemi një punë për të bërë. Ora po troket. Punët duhen çuar deri në fund. Ne duhet të japim gjykimin tonë në të mirë të asaj që është e mundur, se vetëm në këtë mënyrë do të kemi progres. Le ta*

përfundojmë këtë ligj..... Le të lejojmë kontrollin e ligjit të bëjë punën e tij dhe le të përdorim fuqinë tonë të mbikëqyrjes për të siguruar mbrojtjen e lirive civile."

Kryetari i Komitetit Republikan, Spektër, ishte i shqetësuar dukshëm nga gatishmëria e Dashëllit për asgjësimin e amendamenteve edhe pa marrë parasysh përmbajtjen. Ai vuri në dukje sa vijon: *"Kur udhëheqësi i shumicës thotë se është i shqetësuar në lidhje me procedurën dhe jo me substancën, ne po vendosim një rekord, ku nuk kemi treguar vetëm procesin e diskutimit për respektimin e kushtetutshmërisë, por kemi vendosur një mospërfillje të kushtetutshmërisë në substancë, e cila nuk është mënyra për të bërë ligje në një zonë kushtetuese, ku Supreme Court-i i Shteteve të Bashkuara balancon nevojat e zbatimit të ligjit me ndërhyrjet mbi privatësinë"*.

Por senatori demokrat Patrik Leahy, ndoshta një nga mbrojtësit më të mëdhenj të të drejtave civile në Senat, mbështeti teorinë e Dashëllit, duke shpjeguar: *"Unë mund t'ju them tani se, në qoftë se fillojmë të kundërshtojmë këtë projekt-ligj, në do të humbasin të gjitha pjesët që kemi fituar dhe kjo do të kthehet në një propozim që ishte qartësisht antikushtetues në shumë pjesë. Kështu që unë i bashkohem, pa asnjë hezitim, lëvizjes së liderit."*

Feingoldi tentoi të shpjegonte rreziqet që mund të shkaktonte censura e të tilla diskutimeve me rëndësi të veçante: *"Në këtë projekt-ligj nuk kishte asnjë moment të vetëm mendimi ose vote në Komisionin Gjyqësor. Unë e pranova për shkak të kësaj krize që po përballej vendi yne. Ky është amendamenti i parë thelbësor në Senat për këtë çështje, një nga liritë civile më të rëndësishme të kohës tonë, prandaj kryetari i shumicës u ka kërkuar senatorëve që të mos votojnë për themelin e çështjes. Unë e kuptoj detyrën e vështirë që ai kishte dhe duhet të kundërshtoj idenë se asnjë ndryshim i vetëm për këtë çështje nuk do të votohet në Senat."*

Kalimi tek Patriot Act-i ishte një përgjigje ndaj ngjarjeve të 11 Shtatorit të vitit 2001, por bashkimi politik ndodhi me shpejtësi. Presidenti Bush dhe anëtarët republikanë shkojnë me bindjen se realizimi i Patriot Act-it ishte një përgjigje e shkëlqyer ndaj luftës kundër terrorizmit.

Li Hamilton, anëtar demokrat i Kongresit, tha: *"Nuk mund të prisni atë bashkim politik të parë fill pas sulmeve të 11 Shtatorit të vitit 2001. Presidenti duhet të konsultohet me Kongresin më tepër se ka bërë në të shkuarën"*.

Agjencitë e inteligjencës fituan më shumë pushtet. Më 26 tetor 2001, Presidenti Bush firmosi Patriot Act-in, dhe zyrat e FBI-se dhe Këshilli i Përgjithshëm u dërguan një promemorie të gjitha njësive të tyre, duke përshkruar në mënyrë entuziaste pushtetet e tyre ligjore të reja. Promemoria citon: *"Pas sulmeve terroriste të 11 Shtatorit 2001, Administrata i bëri Kongresit një seri propozimesh për të rritur eficiencën dhe efektivitetin e veprimtarisë së FCI/IT"*.

Promemoria kishte qëllimin të vinte në dijeni agjentët me dispozitat e reja dhe t'i përdornin nëse do të rezultonte e nevojshme. Promemoria i dha edhe një interpretim elegant Patriot Act-it në lidhje me të drejtat kushtetuese dhe detyrimin që asnjë hetim kundërspiunazhi nuk duhet t'i drejtohet një shtetasi amerikan *"vetëm mbi bazën e veprimtarive të mbrojtura nga Amendamenti i Parë"*. Kongresi vendosi të shprehte këtë fjali për të treguar që teknikat e spiunazhit nuk mund të përdorshin kundër shtetasve të Shteteve të Bashkuara, pra personave që mund të ushtronin të drejtat e tyre kushtetuese të mbrojtura dhe të garantuara. Me fjalë të tjera, të gjitha investigimet mbi shtetasit amerikanë mund të quheshin veprimtari të paligjshme.... të cilat nuk gëzojnë mbrojtjen e Amendamentit të Parë.

Sipas kritikëve, administrimi i Bushit kishte harruar luftërat për liritë civile. Komuniteti i shkrimtarëve u tregua shumë agresiv në shprehjen dhe ekspozimin e kritikës. Në këtë mënyrë, shkrimtarja Karen Shnaider dha mendimin e saj mbi legjislacionin e ri: *"Patriot Act SHBA është komplot i pastër dhe i thjeshtë, dhe ju duhet të dini se si dhe pse, sepse ai paraqet çështje veçanërisht të dëmshme për përdoruesit, të cilët mbështeten në shërbimet tuaja të internetit. Patriot Act nuk është legjislacioni kundër terrorizmit; është legjislacioni kundër të folurit, dhe nuk është më një përgjigje e drejtpërdrejtë për sulmet e 11 Shtatorit dhe Children's Internet Protection Act është një rezultat i drejtpërdrejtë i shqetësimit të sinqertë nga ana e anëtareve të Kongresit në lidhje me sigurinë e të miturve. Realiteti i ftohtë dhe cinik është se Patriot Act është një lloj kazani që lëviz në korridoret e Kongresit jo vetëm para 11 Shtatorit, por në pjesën më të madhe*

para administratës së Bushit. U bë realitet pas 9/11 me shpejtësi, fshehurazi dhe në mënyrë antidemokratike, në kundërshtim me Bill of Rights të SHBA -ve."

Benxhamin Frenklin ka pohuar në një citim të famshëm: *"Ata që heqin dorë nga liria për hir të një sigurie të përkohshme, nuk përfitojnë as lirinë, as sigurinë.* Pra, ata të cilët mund të heqin dorë nga liria për pak më shumë siguri të përkohshme nuk meritojnë as liri dhe as siguri. Më tej, ai përsëriti nevojën e një aksesit të lirë dhe të pakontrolluar të informacioneve, kundërshtimin ndaj censurës së qeverisë, mbrojtjen e jetës private dhe konfidencialitetit, tolerancën për kundërshtimet.

Section 203 i USA PATRIOT ACT modifikoi pjesën e disiplinës mbi përhapjen dhe përdorimin e përgjimeve telefonike. Nën Patriot Act-in, përgjimet telefonike që lidhen me shërbimet e inteligjencës së huaj dhe spiunazhin, mund të ndahen gjerësisht me të njëjtën mënyrë të parashikuar për "Grand Jury". Duke iu bashkuar Section 203, Section 218, 403, 504 dhe 905, ato rrisnin pushtetin e inteligjencës për të ndarë informacionet investiguese.

Mbështetësit e Patriot Act-it këmbëngulnin mbi faktin se të shpërndash disa informacione ishte esenciale për suksesin e inteligjencës kundër terrorizmit ndërkombëtar dhe, për më tepër, shënuan në Section 203 lejimin e përhapjes të vetëm "foreign intelligence information". Kritikët thonë se kjo dispozitë nuk është e mjaftueshme për të kufizuar përhapjen e hetimeve mbi veprimtaritë terroriste, duke i nënshtruar në këtë mënyrë gjerësisht shtetasit amerikanë ndaj investigimeve të inteligjencës edhe kur bëhet fjalë për raste që i përkasin drejtësisë penale.

Pas miratimit të Patriot Act-it, disa kongresmenë ngritën interesin e Departamentit të Drejtësisë për të bërë një ndarje të dukshme mes rasteve të inteligjencës për sa u përket hetimeve mbi shtetasit e huaj dhe ato që i përkisnin drejtësisë penale, duke lejuar shpërndarjen e të dhënave mes agjencive federale të ruajtjes. Gjatë diskutimit në Kongres, Senatori Orrin Haç tha: *"Unë besoj se shumica e qytetarëve tanë tronditen kur mësojnë se, edhe në qoftë se agjentët e disa qeveritare kishin njohuri paraprake për sulmet e 11 Shtatorit, në shumë rrethana ata do ta kishin ndaluar me ligj ndarjen e këtij informacioni me inteligjencën e duhur apo autoritetet e sigurisë kombëtare. Ky legjislacion jep sigurinë që, në të ardhmen, ky informacion rrjedh lirshëm brenda*

Qeverisë Federale, në mënyrë që të pranohet nga ata që janë përgjegjës për mbrojtjen kundër sulmeve terroriste..... Në këtë luftë të re, terroristët janë një hibrid mes kriminelëve dhe agjentëve të inteligjencës vendase. Ne duhet të ulim barrierat që shkurajojnë zbatimin e planeve të tyre dhe agjencitë tona të inteligjencës të punojnë së bashku për të ndaluar këta terroristë".

Senatori Patrik Leahy, i cili ishte dakord me objektivin e një shpërndarjeje më të madhe ndërdepartimentale të informacioneve investiguese, pohon se Patriot Act e drejton objektivin në një drejtim qesharak dhe të rrezikshëm: "Për ata që kanë qenë të shqetësuar në lidhje me rrjedhjet nga FBI që mund t'u ketë dëmtuar në mënyrë të pariparueshme reputacionin njerëzve të pafajshëm nën hetim, duke njoftuar të dyshuarit të largohen, ose duke shkatërruar provat materiale, insistimi i administratës në autoritetin e gjerë për të shpërndarë informacion të tillë, pa asnjë kontroll gjyqësor, është shqetësues... Nëse ka ligje specifike që administrata beson se penguan ndarjen e nevojshme të informacionit mbi terrorizmin dhe inteligjencën e jashtme në kuader të degës së ekzekutivit, ne duhet të adresojmë ato probleme nëpërmjet legjislacionit që është në shënjestër të ngushtë të këtyre statuteve. Është një dispozitë të cilën ne nuk e kuptojmë plotësisht, e cila mund të çojë në pasoja që nuk mund t'i parashikojmë. Më tej, unë jam i shqetësuar se një legjislacion i tillë, gjerësisht autorizon shkëmbimin e fshehtë të inteligjencës në të gjitha deget e ekzekutivit dhe që do të nxisë frikën e pajustificuar dhe teoritë e konspiracionit të errët të amerikanëve, të cilët nuk i besojnë qeverisë së tyre" .

Section 215 e Patriot Act lejon agjentët e FBI-së të pajisen me mandat kontrolli fizik për çdolloj gjëje të arsyeshme pa vërtetuar më parë një "çështje të mundshme" për akte të paligjshme. Agjentët kanë nevojë vetëm të pohojnë se materiali i dëshiruar mund të lidhet me çdolloj hetimi të kryer, të lidhur me terrorizmin dhe me veprimtarinë e inteligjencës. Në tetor të vitit 2001 Senati diskutoi mbi Patriot Act-in. Senatori Ras Feingold pohoi: "Sipas nenit 215 të këtij ligji, të gjitha të dhënat e biznesit mund të detyrohet që të prodhohen, duke përfshirë edhe ato që përmbajnë informacione të ndjeshme personale të tilla si për shembull të dhenat mjekësore nga spitali ose mjekët, ose të dhenat e arsimit, ose të dhënat që dikush ka marrë nga biblioteka. Ky është një

zgjerim i madh i autoritetit, kombinuar me eliminimin e kërkesës që të dhënat të kenë të bëjnë me një agjent të një fuqie të huaj. Sipas kësaj dispozite, qeveria me sa duket, mund të shkojë në ekspeditë peshkimi dhe të mbledhë informacion mbi çdo njeri - ndoshta dikush që ka punuar me të, apo ka jetuar në vendin fqinj me të, ose është parë në shoqërinë e dikujt, ose shkoi në një shkollë me të, ose numri i telefonit i të cilëve u thirr me objektivin e një hetimi... E gjithë ajo që mund të bëjë FBI është të pretendojë... që informacioni të kërkohej për një hetim për terrorizëm ndërkombëtar apo mbledhjen e fshehtë të informacioneve të zbulimit... Ky është me të vërtetë një zgjerim që të lë pa frymë për sa i perket pushtetit që i është dhënë policisë, e që unë nuk mendoj se është urdhër".

Edhe pse Section 215 i Patriot Act-it nuk i adresohet drejtpërdrejt çështjes së mbrojtjes shtetërore, vendimet e tjera e bëjnë të qartë primatin e Patriot Act-it. Në fakt, frika e humbjes së mbrojtjes shtetërore është shprehur gjatë tetorit 2001 në Senat, ku Senatori Ras Feingold u përpoq të propozonte një amendament, i cili mund të mbronte ligjet e shtetit: " Unë mendoj se është një rezultat që shumica e qytetarëve tanë dhe përfaqësuesve të tyre shtetërore nuk do të pranojnë... .Ndërkohë që amendamenti përmban zgjerimin e autoritetit FISA për të gjitha të dhënat e biznesit, ai gjithashtu i kërkon FBI-së në përputhje me ligjet shtetërore dhe federale që përmbajnë një standard më të lartë për zbulimin e informatave të caktuara private. Amendimi e bën të qartë se mbrojtjet ekzistuese federale dhe shtetërore statutores për intimitetin e informatave të caktuara nuk janë zvogëluar ose zëvendësuar nga neni 215."

Section 412 dhe parashikimet e tjera mbi emigracionin nga ana e Patriot Act-it, shkojnë përtej perjashtimeve dhe dëbimit të të huajve. Gjatë diskutimit në Senat mbi Patriot Act-it, Senatori Jon Corzien deklaroi: "Jam veçanërisht i shqetësuar në lidhje me dispozitat e këtij ligji, që kërkojnë arrestimin e emigrantëve të cilët nuk janë terroristë, të cilët nuk janë kriminelë, por janë të dyshuar vetëm për keqbërje në të ardhmen. Në fakt, këto parashikime shkojnë më tej se kaq. Rezidentë të ligjshëm të përhershëm, të cilët janë të ngarkuar të dëbohen për shkak të terrorizmit mund të mbahen pafundësisht edhe nëse një gjyqtar imigracioni përcakton se akuzat e terrorizmit janë të rreme. Unë e kuptoj se ne kemi nevojë për t'i dhënë qeverisë autoritet të mjaftueshëm për të mbrojtur

amerikanët nga ata që përbëjnë kërcënim real për sigurinë publike. Por kjo dispozitë shkon shumë larg."

Anita Ramasatri, profesoreshë e së Drejtës në Universitetin e Uashingtonit, shkroi eksperiencën e saj personale e cila lidhej me të shoqin, një emigrant irlandez që posedonte "green card", i cili mund të dënohej për një kohë të pacaktuar, ose të deportohej mbi bazën e ligjit të ri. Ramasatri theksoi se Patriot Act-i autorizonte deportimin e emigrantëve për të ndihmuar në fonde dhe materiale për të mbështetur një organizatë terroriste, ose për të ndihmuar çdolloj organizimi nëse i huaji di apo logjikisht duhet të dijë se kontributet do të konsideroheshin veprimtari terroristike. Nën Patriot Act-in, nëse Ministri i Drejtësisë (Attorney General) vërteton se i huaji mund të lehtësojë aktet terroriste, ky i fundit do të dënohet fillimisht shtatë ditë. Gjatë kësaj periudhe, Ministri i Drejtësisë duhet të nisë një proces për përjashtimin e tij dhe mund ta mbajë të dënuar të huajin. Në fakt, edhe pse gjyqtari i emigracionit arrin në konkluzionin se të huajit mund t'i rikthehet liria, Ministri i Drejtësisë ka pushtetin të vazhdojë ta mbajë të dënuar. Duket qartë fakti se ky dënim është i pabazuar. Pra, individit mund të mbahet i dënuar me afat të pacaktuar deri në momentin e një urdhri të ri të institutit të Drejtësisë. Vetëm ministri ka pushtetin të mbajë të dënuar për një afat të pacaktuar cilindo që mendon se mund të përbëjë rrezik për sigurinë e Shteteve të Bashkuara. David Koul, Profesor në Georgetown University Law Center, vërteton se Patriot Act-i ka sakrifikuar të drejtat e emigrantëve - mbi të gjitha të emigrantëve arabë dhe myslimanë - për sigurinë e shtetasve amerikanë. Ai theksoi: *"Kongresi ka bërë që emigrantët të dëbohen për shkak të pjesëmarrjes në shoqatat e tyre politike dhe të përjashtohen për fjalën e pastër, madje i nënshtrohen ndalimit të pacaktuar në bazë të certifikimit të një zyrtari ekzekutiv... Para ardhjes në fuqi të Patriot Act-it, emigrantët mund të dëboheshin për angazhimin ose mbështetjen e tyre në veprimtarinë terroriste. Patriot Act-i i bën ata të dëbohen për pjesëmarrje virtuale dhe asociative me një organizatë terroriste, pavarësisht nëse mbështetja e të huajit ka ndonjë lidhje me një akt dhune, shumë më pak terrorist."* ²⁴

²⁴ Cole D. (2002). "Terrorising immigrants in the name of fighting terrorism". fq 65.

Section 802 i Patriot Act-it jep një përkufizim të gjerë dhe të ri të terrorizmit të brendshëm dhe Section 803 deri në Section 818 përmbajnë detajet. Projekti origjinal për këtë seksion të Departamentit të Drejtësisë përfshinte një listë me më shumë se dyzet vepra penale të shkaktuara nga përdorimi i armëve të shkatërrimit në masë. Veprat penale të përmbajtura në listë nuk kishin asnjë afat parashkrimi. Dënimet mund të përfshinin burgun, dhe personat e liruar më parë do të ishin objekt i lirisë me kusht.

Disa pasazhe të Patriot Act-it detyrojnë mospërhapjen e informacioneve në lidhje me personat nën ruajtje, kërkim apo sekuestro. Teksti i Section 215 citon: "*Asnje person nuk duhet të japë informacione shpjeguese për çdo person tjetër (përveç atyre personave që nevojiten për të prodhuar të dhëna të ndjeshme sipas këtij neni), që Byroja Federale e Hetimeve ka kërkuar të marrë informacione të ndjeshme sipas këtij neni.*"

Autori i Amendamentit të Parë, Avokati Nat Hentof shprehet: "*Për shkak të efektit trishtues të këtij seksioni të Patriot Act-it të SHBA, është e paqartë se si shitësit e librave dhe bibliotekarët mund të thërrasin një avokat. Dhe për atë që e bëjnë, është e vështirë të parashikohet se sa e suksesshme do të jetë në të tashmen kjo sfidë afatgjatë, ku atmosfera e frikës së terroristëve do të jetë si hije midis nesh*".²⁵

Lind natyrshëm pyetja nëse Patriot Act-i është një organ vigilance i panevojshëm. Disa anëtarë të Kongresit reflektonin mbi faktin se si administrata Bush e konsideronte Patriot Act-in si esencial në luftën kundër terrorizmit në një kohë kur shumica e dispozitave nuk përdorehin. Von Hollen në vitin 2005 shkroi: "*The President's newly claimed authority renders significant portions of the Patriot Act debate meaningless. What is the point of Congress drawing legal standards and developing procedures to protect our security and secure our civil liberties if the President secretly decides he has the authority to ignore much of what we do?*"²⁶

Më 5 qershor 2003, Gjenerali Xhon Ashcroft pohoi përpara House of Judiciary Committee: "*Pavarësisht kërcënimeve terroriste në Amerikë, ka disa, si ne Kongres dhe në të gjithë vendin, të cilët sugjerojnë se ne nuk do të kemi një USA Patriot Act. Të tjerë mbështetës që vepruan 20 muaj me parë shprehin dyshime për sa i përket nevojshmërisë*

²⁵Hentoff N. (2005). "*The FBI among the bookshelves*". fq 54.

²⁶ Van Hollen Ch, *Letters to the editor*, Washington Post, December 21, 2005, faqe A19.

së disa komponentëve të këtij akti. Më lejoni të shpreh pikëpamjen time sa më të qartë që të jetë e mundur. Aftësia jonë për të parandaluar një tjetër sulm katastrofik në tokën amerikane do të jetë më e vështirë, për të mos thënë e pamundur, pa Patriot Act-in. Ajo ka qenë arma kryesore e përdorur në të gjithë Amerikën në operacionin e suksesshëm kundër terrorizmit për të mbrojtur amerikanët e pafajshëm nga planet vdekjeprurëse të terroristëve".²⁷

Gjatë një seance të Kongresit në tetorin e vitit 2001, atëherë kur Senatori Ras Feingold lajmëroi të gjithë kolegët e tij për rrezikun me abuzimin e dispozitave mbi emigracionin të përmbajtura në Patriot Act, mbështetësit e Patriot Act-it iu përgjigjën: "*Mos u bëni merak, FBI nuk do të bëjë kurrë këtë gjë.*" Por po të njëjtën ditë në të cilën u transformua në ligj, prestigjozi Lawyers Committee for Human Rights publikoi një parashikim të zyrtarë: "*Në atë që ka të ngjarë të jetë një numër i konsiderueshëm rastesh, ligji i ri do të veprojë duke vendosur burgim afatgjatë të shtetasve që nuk kanë shtetësi amerikane, të cilët kurrë nuk kanë qenë të akuzuar për një krim, por që kanë shkelur statusin e tyre të emigracionit në njëfarë mënyre... Ky do të jetë rezultati me shumë gjasa nëse një person është certifikuar nga Prokurori i Përgjithshëm si një kërcënim për sigurinë kombëtare të SHBA".²⁸*

Pjesa më e madhe e diskutimeve publike dhe e kritikave ndaj Patriot Act-it u adresoheshin parashikimeve mbi sigurinë, që sipas kritikëve komprometonin lirinë dhe privacy-në e shtetasve amerikanë. David Koul ritheksoi se parashikimet më të errëta të Patriot Act-it janë ato mbi emigracionin, që tërheqin më tepër opinionin e kritikës. Kouli u shpreh në këtë mënyrë duke iu referuar një standardei të dyfishtë, që lejon shtetasin amerikan të deklarojë se ata nuk janë të gatshëm të pranojnë çfarëdo sakrifice mbi lirinë për të vazhduar luftën kundër terrorizmit ndërkombëtar, me kusht që sakrifica të bjerë mbi shtetasit joamerikanë. Janë miratuar të gjitha dispozitat mbi emigracionin dhe janë pranuar pa asnjë diskutim. Një tjetër shembull i këtij standardi të dyfishtë mund të vërehet edhe në përkufizimin që Patriot Act-i i bën terrorizmit. Shtetasit e Shteteve të

²⁷ Hearings before the Committee on the Judiciary, House of Representatives, 108th Congress, 1st session, June 5, 2003, faqe 8.

²⁸ "LCHR on counterterrorism bill" October 26, 2001, faqe 2.

Bashkuara mund të konsiderohen terroristë "vetëm nëse kryejnë akte të rrezikshme për jeten e njeriut, që janë shkelje e ligjit penal... dhe që mund të influencojnë në politikën e Qeverisë." Ndërsa për të huajt "veprimtaria terroriste" është përkufizuar më gjerë, sa të përfshijë çdolloj veprimtarie të dhunshme dhe të jashtëligjshme, çdolloj dhune në grup dhe çdo përdorim apo kërcënim për përdorimin e armëve apo të mirave me një qëllim të ndryshem nga ai i mbrojtjes vetjake.

Në këtë mënyrë, për shtetasit amerikanë, terrorizmi ka një përkufizim të ngushtë, i cili korrespondon me qasjen publike të terminologjisë: terrorizmi përfshin kriminalitetin në përgjithësi. As Departamenti i Drejtësisë dhe as Kongresi nuk kanë shprehur në mënyrë të qartë përse një tipologji e veçantë akti konsiderohet "terroriste" për shtetasit e huaj, ndërsa për amerikanët nuk konsiderohet e njëjtë. Ky standard i dyfishtë shihet gjerë në brendësi të Patriot Act-it, i cili e aplikon në mënyrë të egër dhe mizore kundër shtetasve të huaj.

Section 411 shprehet se shtetasit e huaj largohen nga Shtetet e Bashkuara nëse përfaqesojnë:

1. Një organizatë terroriste të huaj, siç përshkruhet nga Sekretari i Shtetit, ose
2. Një grup politik, social ose të ngjashëm sipas përcaktimeve të Sekretarit të Shtetit, i cili minon përpjekjet e Shteteve të Bashkuara për të reduktuar apo eliminuar aktivitetet terroriste.

Section 411 përdor fjalinë "akte të veprimtarisë terroriste" për të përkufizuar fjalinë "të impenjuar në veprimtari terroriste" dhe përfshin disa akte si:

1. Dhënien e informacioneve për sa u përket kategorive që mund të lidhen me aktivitetin e organizatave terroriste;
2. Gjetjen e fondeve ose vlerave të tjera për veprimtari terroriste apo organizata terroriste;
3. Nxitjen e çdo individi për të qenë pjesë e organizatave terroriste; ose
4. Kryerjen e një akti që aktoret njohin, ose që logjikisht mund të njohin, me suportin e materialeve për kryerjen e një veprimtarie terroriste, ose një organizate terroriste.

Përkufizimet dhe dënimet e parashikuara në Section 411 janë të gjitha me fuqi prapavepruese dhe ushtrojnë efektet e tyre mbi miratimin e Patriot Act-it dhe i aplikohen:

1. Veprime të kryera nga të huajt përpara, gjatë ose pas asaj date; ose
2. Të gjithë të huajt, pa qenë e rëndësishme data e hyrjes ose e pritjes për të hyrë në Shtetet e Bashkuara.²⁹

Përpara miratimit të Patriot Act-it, të huajt dëboheshin në rast bashkëpunimi ose mbështetjeje të veprimtarive terroriste. Me Patriot Act-in, ata dëboheshin për shkak të pjesëmarrjeve virtuale në veprimtaritë terroriste, edhe nëse të huajt injorojnë aktet e dhunshme dhe për më tepër aktet terroriste.

Patriot Act-ti autorizon edhe përjashtimin ideologjik, duke mohuar hyrjen e të huajve të cilët "mbështesin ideologjitë terroriste" ose që "gënjejnë të tjerë për të mbështetur veprimtarinë terroriste ose organizatat terroriste". Gjithashtu, përjashtohen edhe shtetasit e huaj që janë pjesë e grupeve të cilat "miratojnë aktet e veprimtarise terroriste që mund të komprometojnë sforcimet e Shteteve të Bashkuara për luftën kundër terrorizmit".

Tani do të trajtoj rastin Maher Arar, i cili është një shembull i mirë i dispozitave konfuzionale të Patriot Act-it mbi emigracionin. Një apo më shumë dispozita të Patriot Act-it u përdorën për dëbimin e Ararit, por në këto raste elementet e provës mbahen sekret ndaj të dyshuarve, avokatëve, shtypit, madje edhe kongresit. Për këto arsye, asnjë nuk mund të ketë dijeni dhe as më tepër të konsultojë bazën ligjore të dëbimit të Ararit.

"Maher Arar ka lindur në Siri, por erdhi në Kanada në vitin 1987. Pasi mori diplomën në bachelor dhe master në inxhinieri kompjuterike, ai ka punuar në Otava si një inxhinier i telekomunikacionit. Në shtator të vitit 2002, pasi Arari po kthehej në Kanada nga disa pushime familjare në Tunizi, ai u kap nga zyrtarët e emigracionit të SHBA-ve kur avioni i tij bëri një ndalesë në Nju Jork. Arari u mor në pyetje në aeroport për tetë orë dhe të nesërmen ishte prangosur dhe dërguar në qendrën e paraburgimit në

²⁹ Statement of the U. S. Senator Russ Feingold on the anti - terrorism bill from the Senate floor, October 25, 2001.

Brooklyn, New York, ku ai ishte mbyllur në izolim. Zyrtarët i thanë se ai ishte parë me një të dyshuar terrorist në Kanada".³⁰

Although he was a Canadian citizen carrying a Canadian passport, Arar was deported to Syria after U.S. officials claimed he had links to Al Qaeda. He recalls, "When I saw FBI officials coming to me, my first reaction was to make a phone call to my family, ... but they ignored my request. And then I asked for a lawyer and they said: You are not an American citizen, you don't have a right to a lawyer".³¹ (Edhe pse ai ishte një qytetar kanadez dhe mbante një pasaportë kanadeze, Arari e dëbuan në Siri, pasi zyrtarët U.S. pohuan se kishte lidhje me Al Kaedën. Ai kujton: "Kur pashë zyrtarët e FBI-së teksa vinin tek unë, reagimi im i parë ishte të bëja një telefonatë me familjen time, ... por ata e injoruan kërkesën time. Dhe pastaj kërkova një avokat dhe ata thanë: Ju nuk jeni qytetar amerikan, ju nuk keni të drejtë për një avokat).

"Në Siri, Arari u mbajt në një qeli me madhësinë e një arkivoli dhe u torturua në mënyrë të përsëritur. Më vonë u zbulua se vendimi i SHBA-ve për deportimin e Ararit ishte bazuar pjesërisht në një këshillë të pasaktë nga inteligjenca kanadeze, por përgjigjja amerikane në atë këshillë nuk është diskutuar me Kanadanë. Në të vërtetë, pasi zyrtarët kanadezë mësuan se Arari ishte duke u mbajtur në një burg sirian, qeveria lëshoi një manual këshillues udhëtimi për të gjithë kanadezët e lindur në Iran, Irak, Libi, Sudan, apo Siri, duke paralajmëruar ata kundër hyrjes në Shtetet e Bashkuara.

³⁰"Maher Arar was born in Syria but came to Canada in 1987. After earning bachelor's and master's degrees in computer engineering, he worked in Ottawa as a telecommunications engineer. In September 2002, as Arar was returning to Canada from a family vacation in Tunisia, he was seized by U.S. immigration officials when his plane made a stopover in New York. Arar was questioned at the airport for eight hours, and the next day was shackled and sent to a detention center in Brooklyn, New York, where he was locked in solitary confinement. Officials told him he had been seen with terrorist suspect in Canada".

³¹ "The price of security": Ted Loppel on Discovery. Discovery Channel Documentary, September 10, 2006.

*Më në fund, më 5 tetor 2003, Siria liroi Ararin pas asaj që Departamenti i Punëve të Jashtme kanadeze e quajti "diplomacia e qetë kanadeze", dhe Arari u kthye në Kanada 375 dite pasi zyrtaret U.S. e kishin arrestuar."*³²

*"Pas kthimit të tij në Kanada, Arari përshkroi torturat fizike dhe psikologjike që ai vuajti gjatë vitit që kaloi në Siri, dhe qeveria kanadeze filloi një hetim për këtë rrëmbim. Departamenti i Shtetit të SHBA-ve ka deklaruar se nuk do të japë ndonjë dokument ose të bashkëpunojë në ndonjë mënyrë me hetimin e Ararit, dhe gjykatesi federal i SHBA-ve David Trager tërhoqi padinë e Ararit kundër zyrtarëve amerikanë, duke thënë se ai nuk mund të ndërhyjë në një rast që përfshin sigurinë kombëtare"*³³.

"Më 27 tetor të vitit 2005, hetimi i Ararit lëshoi një raport me përfundimin se ai ishte torturuar në Siri. Më 28 shtator të vitit 2006, Komisioneri i Policisë së Kalorësisë Mbretërore të Kanadasë kërkoi falje publikisht për rolin e Kanadasë në padrejtësinë e tmerrshme që iu bë Ararit, duke përfunduar se: "Z. Arar, dua të përfitoj nga ky rast për të shprehur publikisht për ju, gruan dhe fëmijët tuaj se sa keq më vjen me të vërtetë". Shtëpia kanadeze e Dhomës së Përfaqësuesve votoi njëzëri se "Ararit duhet t'i paraqitet kërkesa për falje.- (Doug Struck," Zyrtare Canadian të policisë 31 kërkuan falje për gabimet, "Uashington Post, shtator 29, 2006, f. A16). Ndërkohë, zyrtarët e SHBA-vë vazhduan të qëndrojnë me deklaratën origjinale nga Prokurori i Përgjithshëm Xhon

³²In Syria, Arar was held in a cell the size of a coffin and tortured repeatedly. It was later revealed that the U.S. decision to deport Arar was based partly on an inaccurate tip from Canadian intelligence, but the American response to that tip was never discussed with Canada. Indeed, after Canadian officials determined that Arar was being held in a Syrian prison, the government issued a travel advisory to all Canadians born in Iran, Iraq, Libya, Sudan, or Syria, warning them against entering the United States. Finally, on October 5, 2003, Syria freed Arar after what the Canadian Foreign Affairs Department called 'quiet Canadian diplomacy', and Arar returned to Canada 375 days after U.S. officials had arrested him.

³³Upon his return in Canada, Arar described the physical and psychological torture he endured during his year in Syria, and the Canadian government began an investigation into the abduction. The U.S. State Department declared that it would not provide any documents or cooperate in any way with the Arar inquiry, and U.S. federal judge David Trager dismissed Arar's law suit against American officials, saying he could not interfere in a case involving national security.

*Ashcroft se dëbimi i Ararit ishte "plotësisht brenda ligjit dhe në përputhje me traktatet dhe konventat në fuqi që drejtojnë aktivitetet e Shteteve të Bashkuara."*³⁴

Më datë 10 shtator 2006, në një dokumentar televiziv u kujtonin sulmet e 11 Shtatorit. Leni Dejvis, mbështetës i Presidentit Bush u shpreh në një konferencë: *"Ne jemi të gjithë liberal, ne jemi të gjithë konservatorë sonte, kur themi: "Na vjen keq", siç populli amerikan i thotë Z Arar. Nuk arrij ta shpjegoj përse Presidenti i Shteteve të Bashkuara nuk i ka thënë: "Më vjen keq" çdo personi të pafajshëm të trajtuar në mënyrën që ai njeri është trajtuar"*³⁵.

Fill pas sulmeve të 11 Shtatorit, agjentët e Qeverisë në të gjithë territorin e Shteteve të Bashkuara filluan një kontroll të shtetasve të huaj si "terroristë të dyshuar", një kontroll që vazhdon edhe sot e kësaj dite, pas më tepër se 14 vite nga sulmet e 11 Shtatorit 2001. Ministri i Drejtësisë Xhon Ashcroft shfaqej shpesh në televizion për të bërë të njohur "terroristët e dyshuar" të arrestuar nga shërbimet sekrete amerikane. në nëntor të vitit 2001, Ashcroft dëftoi një numër prej 1.152 terroristësh të dyshuar, të cilët ishin arrestuar. Por kur personat fillonin të kërkonin se sa prej tyre ishin realisht të implikuar me terrorizmin, Departamenti i Drejtësisë nuk prononcohej kurrë qartësisht. Megjithatë, relacionet zyrtare dhe dëshmitë në Kongres kane treguar se Qeveria ka bllokuar më shumë se 5.000 shtetas të huaj të arrestuar.

Shumë nga këto të arrestuarit janë mbajtur pa asnjë arsye, janë gjetur nëpër rrugë. Nëse bashkëshortja e njërit prej të dënuarve lajmëronte policinë lokale ose FBI-në dhe kërkonte lajme për të shoqin, agjentët përgjigjeshin se nuk kishin informacione, edhe

*On October 27, 2005, the Arar inquiry released a report concluding that Arar had been tortured in Syria. On September 28, 2006, Canada's Commissioner of the Royal Mounted Police publicly apologized for Canada's role in the 'terrible injustices' done to Arar, concluding: 'Mr. Arar, I wish to take this opportunity to express publicly to you and your wife and to your children how truly sorry I am'. the Canadian House of Commons unanimously voted that 'apologized should be presented to Arar.'*³⁴ (Doug Struck, "Canadian police official apologizes for mistakes," *Washington post*, September 29, 2006, p. A16).

³⁵*"We are all liberals, we are all conservatives tonight when we say, "I am sorry", as the American people to Mr. Arar: why the President of the United States hasn't said "I am sorry" to anyone innocent treated the way than man was treated is beyond me".*

pse i shoqi gjendej i ulur në dhomën pranë, sepse të arrestuarit duhej të mbaheshin sekret, edhe sot.

Një agjent special i FBI-së, Kuli Rouli, ishte në dijeni të rreziqeve të kësaj politike dhe shprehu shqetësimin e tij me anë të një letre drejtuar Drejtorit të FBI-së, Robert Myler *"Pjesa më e madhe e mbi një mijë personave "të ndaluar" në prag të 9-11 nuk rezultuan të jenë terroristë. Ata ishin kryesisht të huaj të paligjshëm... Pas 9-11, selitë qendrore inkurajuan gjithnjë e më shumë arrestimet për atë që me sa duket janë qëllimet e PR. Zyrtarë në terren u kërkohet të raportojnë çdo ditë numrin e ndalimeve me qëllim që t'u sigurohen deklaratat mbi progresin tonë në luftën kundër terrorizmit ..."*³⁶. *"Nga ajo që kam vënë re, vigjilenca e veçantë mund të kërkohet në mënyrë të tillë që të evitohet presionin e panevojshëm (duke përfshirë inkurajim delikat) për të kapur apo të "mbledhur" të dyshuarit, në veçanti ata me origjinë arabe"*³⁷.

Si janë identifikuar fillimisht këta të dënuar si terroristë potencialë? Inspektori i Përgjithshëm i Departamentit të Drejtësisë u shpreh se ata ishin piketuar në bazë të spiunimeve anonime, që referonin se kishte shtetas të Lindjes së Mesme që punonin për një lidhje lokale me terrorizmin. Në këtë mënyrë, shtetasit e piketuar i arrestonin. Shumë prej të piketuarve, për shkak të arrestimeve, janë detyruar të qëndrojnë në Shtetet e Bashkuara edhe pas skadencës së vizës së hyrjes, duke shkelur kështu rregullat e qëndrimit në territorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Nëse ky fakt verifikohet atëherë ata i dëbonin. Por këtu, meqenëse çështja e vizave të emigrantëve ishte vetëm një strategji për të mbledhur terroristët e dyshuar, objektivi nuk ishte ai i dëbimit të këtyre personave nga vendi, por të arrestonin në mënyrë që këta të fundit të mos përbënin më një rrezik për Shtetet e Bashkuara.

³⁶: "The vast majority of the one thousand plus persons 'detained' in the wake of 9-11 did not turn out to be terrorists. They were mostly illegal aliens....After 9-11, Headquarters encouraged more and more detentions for what seem to be PR purposes. Field offices were required to report daily the number of detentions in order to supply grist for statements on our progress in fighting terrorism....

From what I observed, particular vigilance may be required to head off undue pressure (including subtle encouragement) to detain or 'round up' suspects particularly those of Arab origin"³⁷.

Me Patriot Act-in, shumë arrestime nuk kanë një natyrë të përcaktuar qartë. Patriot Act-i autorizon Ministrin e Drejtësisë të mbajë të arrestuar individët e dyshuar për terrorizëm. Ky ligj i ka dhënë Ministrit të Drejtësisë një pushtet të pakufizuar dhe unilateral për të mbajtur të huajt për mundësinë për këta të fundit që t'u përgjigjen akuzave. David Koul u shpreh se Patriot Act-i i përkufizon në mënyrë abstrakte "terroristët e dyshuar" dhe përfshin në mënyrë virtuale çdo emigrant, pjesë e ndonjë sherri apo një episodi shtëpiak. Lëshohen mandate për masa sigurie për personat që nuk përbëjnë rrezik për sigurinë kombëtare dhe pa asnjë seancë, duke u lejuar forcave të policisë të mbajnë këta të huaj me afat të pacaktuar, edhe kur mbizotërojnë të drejtat e këtyre të fundit. Koul u shpreh: *"Kjo është e ngjashme me ndalimin e një të burgosuri, edhe pasi ai është falur"*.³⁸

Al Gore, kandidati për President që fitoi 2000 vota, por humbi zgjedhjet, foli kundër arrestimeve arbitrare dhe dënimit të shtetasve të huaj, në veçanti të arabëve dhe myslimanëve. Në diskutimin e datës 9 nëntor 2003, Gore denoncoi shkeljen e lirive civile nga 11 Shtatori 2001, duke treguar: *"Unë besoj se Akti Patrioti rezultoi të ishte një gabim i tmerrshëm, dhe se ai u bë një lloj i Rezolutës së Gjirit Tonkin, duke dhënë bekimin e Kongresit për këtë sulm të Presidentit për liritë civile"*.³⁹

Gore përshkroi trajtimin e emigrantëve në periudhën pas 11 Shtatorit si shembullin më negativ të shkeljes së lirive civile, duke thënë: *"Më shumë se 90 për qind e shumicës me prejardhje arabe supozohet se kishin kaluar limitin e vizave të qëndrimit të tyre, ose kishin kryer ndonjë vepër tjetër të vogël ... Por këto janë përdorur si shtesa në perpjekjet e qeverisë për të dhënë përshtypjen se është kapur një numër i madh djemsh të keqinj dhe shumë prej tyre janë trajtuar në mënyrë të tmerrshme dhe abuzive"*.⁴⁰

³⁸"This is akin to detaining a prisoner even after he has been pardoned".

³⁹"I believe the Patriot Act has turned out to be, on balance, a terrible mistake, and that it became a kind of Tonkin Gulf Resolution conferring Congress' blessing for this President's assault on civil liberties".

⁴⁰ "More than 90 percent of the mostly Arab-background men who were rounded up had merely overstayed their visas or committed some other minor offence....But they were used as extras in the Administration's effort to give the impression that they caught a large number of bad guys. And many of them were treated horribly and abusively".

Pikëpamjet kritike të Gorit tërhoqën pak vëmendje në Shtetet e Bashkuara, deri në momentin kur ai i përsëriti në Arabinë Saudite në shkurtin e vitit 2006. Gore kujtohet si personi që shprehu se arabët në Shtetet e Bashkuara janë "kapur pa diskriminim dhe mbajtur në kushte të pafalshme". Gore e përmbylli diskutimin e tij: *"Për fat të keq, ato kanë qenë abuzime të tmerrshme, dhe kjo nuk është e drejtë. Unë dua që ju të dini se ajo nuk përfaqëson dëshirat apo ndjenjat e shumicës së qytetarëve të vendit tim"*⁴¹.

Koncepti i gjerë dhe i përkufizuar dobët i "mbështetjes materiale" ndaj terrorizmit është bërë pjesë e diskutimeve për shkak të Section 805 të Patriot Act-it, në mënyrë që çdo grup terrorist të dënohet me ligjin e emigracionit.

David Koul ka shkruar shumë mbi Amerikën e pas-11 Shtatorit 2001, duke iu referuar faktit të sakrifikimit të të drejtave të shtetasve të huaj me qëllim garantimin e sigurisë së shtetasve amerikanë. Por Kouli bën pyetjen: *"Cilat janë rezultatet e këtyre sakrificave? Cilat janë përfitimet që kemi marrë?... Çfarë rezultatesh konkrete do të shohim nga ky përdorim i forcës shtrënguese të ligjit në emër të një paradigme parandaluese, me këndvështrim nga e ardhmja? Ka disa masa objektive që ne mund t'i shikojmë. Nga këto, 5.000 shtetas të huaj të mbyllur në paraburgimin parandalues për anti-terrorizëm që nga 9/11, sa prej tyre kanë qenë të dënuar për ndonjë krim terrorist? Zero. As edhe një. Zero për 5.000. Nga 8.000 që u thirrën për intervistim nga FBI për shkak se ata ishin nga vendet muslimane apo arabe dhe për këtë arsye kishin me sa duket më shumë gjasa që të ishin terroristë, sa kanë qenë të akuzuar për një krim terrorist? Zero. Zero për 8.000. dhe për 80.000 të cilët u thirrur për regjistrim të veçantë, gjurmët e gishtrinjve, fotografi dhe intervista, përsëri për shkak se ata ishin nga vendet arabe dhe*

⁴¹"Unfortunately, they have been terrible abuses, and it's wrong. I do want you know that it does not represent the desires or wishes or feeling of the majority of the citizens of my country ".

muslimane, asnjë nuk është akuzuar apo dënuar për një krim terrorist. Këto janë shifra mjaft të zymta"⁴².

Kouli nënvizon faktin se edhe statistikën mbi faqen web DOJ, tregojnë se mbi 500 deportime si rrjedhojë e hetimeve antiterroriste janë një konfirmim i falimentit. Pra, kjo do të thotë se Shtetet e Bashkuara nuk mund të dëbonin një shtetas të huaj të mbajtur në burg deri në momentin që nuk ishte e sigurt se ai nuk kishte asnjë lidhje me terrorizmin. "So this are misses, not hits, in term of finding any actual terrorists,"- e përfundoi diskutimin e tij Kouli.⁴³

Pavarësisht kritikave, administrata Bush ofroi prova që vërtetnin suksesin e Patriot Act-it dhe të ligjeve të tjera të miratuara për të mbrojtur Shtetet e Bashkuara. Nuk janë vërtetuar sulme të reja të Al Qaeda-s në Shtetet e Bashkuara të Amerikës nga miratimi i Patriot Act-it. Kjo analizë pozitive ka nevojë për dy hipoteza:

1. Kërcënimi i terrorizmit në Shtetet e Bashkuara mbetet i lartë.
2. Masat tepër agresive të Qeverisë, si për shembull Patriot Act-i, shërbejnë për kapjen e terroristëve përpara se ata të veprojnë kundër Shteteve të Bashkuara.

Një studim i ri i DOJ mbi rastet e terrorizmit ndërkombëtar pas 11 Shtatorit harton një kuadër që duket se kundërshton të dyja hipotezat. Studimi i Transactional Records Access Clearinghouse (TRAC) në vitin 2006, tregoi se rastet e akuzave për terrorizëm pas 11 Shtatorit janë në rritje, por kanë rënë më tej në mënyrë dramatike. Studimi tregon edhe faktin se nëntë nga dhjetë hetime kundër terrorizmit nuk kanë qenë subjekt i ndonjë aksioni penal. Kanë qenë raste që u vërtetuan se nuk kishin asnjë lidhje me

⁴² "What are the results from this set of sacrifices? What are the gains we've made?...What concrete results do we see from this use of the coercive force of law in the name of a preventive paradigm, future – directed? There are some objective measures that we can look to. Of those 5.000 foreign nationals locked up in anti-terrorism preventive detention since 9/11, how many have been convicted of a terrorist crime? Zero. Not one. Zero for 5.000. of the 8.000 called for FBI interviews because they were from Muslim or Arab countries and therefore were presumably more likely to be terrorists, how many have been charged with a terrorist crime? Zero. Zero for 8.000. and for the 80.000 who were called in for special registration, fingerprinting, photographing and interviews, again because they were from Arab and Muslim countries, none have been charged or convicted of a terrorist crime. Those are pretty stark figures".

⁴³ Cole D, *Speech on Constitution Day at Maryland Institute Art*, Baltimore, MD, September 16, 2005.

terrorizmin ndërkombetar dhe vetëm një e treta e personave të ndjekur përfunduan në burg.

Relacioni përfundimtar i TRAC përmbillet: *"Duke marrë parasysh deklaratat e shumta paralajmëruese nga Presidenti dhe zyrtarët e tjerë federalë në lidhje me natyrën e vazhdueshme të kërcënimit të terrorizmit ... Rënia graduale në këto raste që nga pika e lartë FY2002 dhe shkalla e lartë e dorëzimit nga ana e prokurorëve për të ndjekur penalisht rastet e terrorizmit përbëjnë çështje të diskutueshme"*⁴⁴.

Pyetja më e rëndësishme mbi këto statistikë është me siguri nëse masat e arrestimit, pyetjet dhe dëbimet e shtetasve të huaj kanë qenë efikase. DOJ vendosi vëmendjen mbi disa raste duke analizuar aftësitë e Patriot Act-it për të identifikuar dhe ndjekur terroristët. Një shembull është rasti i Sami Al-Arianit, i cili përmendet nga Ministri i Drejtësisë Xhon Ashcroft si një triumf i Patriot Act-it.

*"Më 20 shkurt 2003, profesor Florida Sami al-Arian u arrestua dhe u burgos me akuzën për terrorizëm pas dhjetë vitesh mbikëqyrje intensive, që përfshinte 20.000 telefonata dhe fakse të përgjuara. Përgjimet e ndryshme dhe urdhrat e mbikëqyrjes të përdorura kundër al-Arianit janë autorizuar gjatë viteve FISA, para miratimit të Aktit Patriot. Megjithatë, Departamenti i Drejtësisë bëri bujë me aktakuzën e al-Arianit si një "triumf të Aktit Patriot". Asnjë nga krimet e listuara në aktakuzë nuk është i përfshirë në përkufizimin e ri të Aktit Patriot për "terrorizmin e brendshëm" dhe asnjë nga mbikëqyrësit masivë që prodhuan provat kundër al-Arianit nuk ishte i autorizuar nga Patriot Act-i."*⁴⁵.

"Përgjigjja gjendet në atë që shumica mendojnë se është koleksion i Aktit Patriot, autoriteti i ri për të ndarë informacione hetimore midis zbatimit të ligjit dhe agjencive të

⁴⁴"Considering the numerous warning statements from the President and the other federal officials about the continuing nature of the terrorism threat....the gradual decline in these cases since the FY2002 high point and the high rate of which prosecutors are declining to prosecute terrorism cases raises questions".

⁴⁵"On February 20, 2003, Florida professor Sami al-Arian was arrested and imprisoned on terrorism charges after ten years of intensive surveillance that included 20.000 intercepted phone calls and faxes. The various wiretaps and surveillance orders used against al-Arian were authorized under the FISA years before the passage of the Patriot Act. -

*inteligjencës, dhe ndoshta më e rëndësishme, për të ndjekur penalisht rastet penale, duke përdorur provat e mbledhura përmes hetimeve të zbulimit të huaj. Ky i fundit është autoritet i ri i fuqishëm, për shkak se standardet ligjore të cilat duhet të plotësohen para se të kryejnë mbikëqyrjen e inteligjencës së jashtme, janë më pak kufizuese se ato që kërkohen për hetimet penale"*⁴⁶.

*"Kështu, në bazë të Aktit Patriot, informacioni i fituar me anë të metodave që nuk do të ishin të autorizuar në një hetim penal, mund të përdoret në një ndjekje penale. I tillë është mjedisi i ri dhe i ndërlikuar ligjor, në të cilin Sami al-Arian e gjeti veten të akuzuar"*⁴⁷.

*"Dr. al-Arian, profesor i shkencave kompjuterike në Universitetin e Southern Florida-s, u detyrua të marrë lejen dhe u ndalua të futet në kampusin universitar gjatë periudhës së marrjes në pyetje të muslimaneve post 9/11, kryesisht mbi bazën e një serie nxitëse të komentarëve televizivë në Fox News. Ai u arrestua më 20 shkurt 2003, u mbajt kryesisht në izolim për më shumë se dy vjet, derisa gjyqi i tij filloi në qershor të vitit 2005. Akuza kundër tij ishte ajo që ai kishte mbështetur Xhihadin Islamik Palestinez, një grup i njohur si një organizatë terroriste nga ana e Departamentit të Shtetit"*⁴⁸.

⁴⁶The answer is found in what many feel is the centerpiece of the Patriot Act, the new authority to share investigative information between law enforcement and intelligence agencies, and perhaps more important, to prosecute criminal cases using evidence collected through foreign intelligence investigations. The latter is powerful new authority, because the legal standards that must be satisfied before conducting foreign intelligence surveillance are less restrictive than those required for criminal investigations.

⁴⁷Thus, under the Patriot Act, information acquired through methods that would never be authorized in a criminal investigation can nonetheless be used in a criminal prosecution. Such is the convoluted new legal environment in which Sami al-Arian found himself indicted.

⁴⁸Dr. al-Arian, a professor of computer science at the University of Southern Florida, had been placed on forced leave and banned from the university campus during the post-9/11 roundups and interrogations of Muslims, largely on the basis of a series of incendiary television commentaries on Fox News. He was arrested on February 20, 2003, held mostly in solitary confinement for more than two years until his trial began in June 2005. The charge against him was what he had supported the Palestinian Islamic Jihad, a group designated as a terrorist organization by the State Department.

"Në padinë e tij, provat e paraqitura kundër tij përbëheshin kryesisht nga bisedat telefonike dhe revista të sekuestruara nga zyra e tij, të cilat demonstruan mbështetjen për çështjen palestineze, por që nuk kanë lidhje me aktet terroriste. Gjatë gjyqit të tij, dëshmitarët e prokurorisë ishin qytetarë, kryesisht izraelitë, të sjellë për të dëshmuar në lidhje me sulmet terroriste dhe kanë thënë se janë kryer nga Xhihadi Islamik Palestinez në Izrael. Asnjë nga dëshmitarët nuk sugjeroi se al-Ariani ishte i lidhur me sulme të tilla, ose që mbase kishte dijeni për ato"⁴⁹.

"Më në fund, më 6 dhjetor 2005, al-Ariani u lirua nga të gjitha akuzat. Juria e shpalli të pafajshëm për tetë nga shtatëmbëdhjetë akuzat dhe u bllokua për akuza të tjera. David Koul, ekspert i ligjit në Universitetin Georgetoen, i cili përfaqësohet nga një prej të pandehurve të tjere, tha se prokurorët në rastin al-Arian kishin proceduar "me një lloj teorie gjithëpërfshirëse të fajit-nga-asosacionet.... ku asnjë nuk tregon se ai në mënyre specifike nxiti ose kërkoi të nxiste ndonjë akt të dhunshëm të ndonjë lloji...."⁵⁰.

Ata i kanë shpallur prej kohësh këto si Prova Materiale A në përdorimin e suksesshëm të Aktit Patriot dhe si një nga ndjekjet e tyre më të rëndësishme në luftën kundër terorizmit. Pavarësisht 38 dështimeve të rasteve, qeveria vazhdoi ta mbante të arrestuar al-Arianin në pritje të një vendimi për të apeluar. Më në fund, pasi u burgos për më

⁴⁹*At his indictment, the evidence presented against him consisted primarily of intercepted phone conversations and magazines seized from his office, all of which demonstrated vocal support for the Palestinian cause but no connection to terrorist acts. During his trial, the prosecution witnesses were mostly Israeli citizens brought in to testify about terrorist attacks they said were committed by the Palestinian Islamic Jihad in Israel. None of the testimony suggested that al-Arian was connected to such attacks or that he even knew of them.*

⁵⁰*Finally, on December 6, 2005, al-Arian was acquitted of all charges. The jury found him not guilty on eight of seventeen counts and deadlocked on the other counts. David Cole, the Georgetown University law expert who represented one of the other defendants, said the prosecutors in the al-Arian case had proceeded 'on a kind of extremely sweeping guilt-by-association theory....without any showing that he specifically furthered or sought to further any violent act of any kind....'*

*shumë se tre vjet dhe u përball me paraburgimin e pacaktuar, al-Ariani ra dakord për një marrëveshje me Departamentin e Drejtësisë"*⁵¹.

*"Ai u deklarua fajtor për mbështetjen e xhihadit islamik palestinez dhe prokuroria specifikoi se veprimet e tij nuk kanë kontribuar në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në dhunë. Qeveria ra dakord se nuk do të impononte asnjë kusht tjetër për Al-Arianin dhe do të rekomandonte që t'i jepej dënim me burg minimal sipas ligjit dhe mirebesim për kohën e kaluar. Kjo do ta lejojte atë, në mënyrë efektive, që të shmangte kryerjen e dënimit, duke e liruar nën kujdestarinë e oficerëve të emigracionit për dënim të mundshëm"*⁵².

*"Në kohën e dënimit të tij, gjithçka ndryshoi. Gjykatësi i shpërfilli kushtet e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, dënoi al-Arianin për nxitjen e dhunës dhe vdekjes, pavarësisht se juria e shpalli të pafajshëm për veprime të tilla, duke i vendosur dënimin maksimal me burg të lejuar me ligj, pesëdhjetë e shtatë muaj. Si rezultat, edhe me mirëbesimin për kohën që ka shërbyer, al-Ariani u përball me një vit e gjysmë burgim, me dënim në pritje të këtij lirimi"*⁵³.

"Për t'i bërë gjerat edhe me keq, qeveria shkeli marrëveshjen e saj për pranimin e fajësisë, duke kërkuar që al-Ariani të paraqitet para një jurie të madhe në Virxhinia. Kur ai refuzoi të dëshmonte, duke përmendur marrëveshjen e tij me prokurorët federalë,

*They have long proclaimed this as Exhibit A in the successful use of the Patriot Act and as one of their most important prosecutions in the war on terror*⁵¹. *Despite the failure of its case, the government continued to detain al-Arian pending a decision to appeal. Finally, after being imprisoned for over three years and facing indefinite detention, al-Arian agreed to a deal with the Justice Department.*

⁵²*He would plead guilty to supporting the Palestinian Islamic Jihad and the prosecution would specify that his actions did not contribute directly or indirectly to violence. The government agreed that it would impose no other conditions on al-Arian and would recommend that he be given the minimal prison sentence allowed by law and credit for time served. This would effectively allow him to avoid serving any time, releasing him into the custody of immigration officers for probable deportation.*

⁵³*At the time of his sentencing, everything changed. The judge ignored the terms of the plea agreement, chastised al-Arian for promoting violence and death-despite the fact that the jury had found him not guilty of such actions-and imposed the maximum prison sentence allowed by law, fifty-seven months. As a result, even with credit for time served, al-Arian was faced with another year and a half of prison, with deportation awaiting this release.*

atij iu dha një dënim prej tetëmbëdhjetë muajsh burg për shpërfillje të gjykatës. Çdoherë që një juri e re e madhe thirrej, dënimi me burg i al-Arianit përtërihej në mënyrë efektive, duke e bërë periudhën e tij të burgosjes pa afat"⁵⁴.

"Më 21 janar 2007, al-Ariani filloi një grevë urie për të protestuar veprimet e qeverisë dhe kushtet e burgimit të tij. Pas ditës së njëzetetretë pa ushqim, ishte alivanosur dhe u zhvendos në një spital në Karolinën e Veriut, ku u mbajt në njëzet e katër orët e izolimit. Amnistia Ndërkombetare i dërgoi një letër Prokurorit të Përgjithshëm Alberto Gonzales, duke protestuar për trajtimin e al-Arianit e duke thënë se ishte "në degën e detyrimeve të SHBA-ve sipas standardeve dhe traktateve ndërkombëtare"⁵⁵.

Ministri i Drejtësisë Gonzales e konsideronte rastin e Sami Al-Arianit si një fitore e Patriot Act-it, duke deklaruar: *"Ne kemi një përgjegjësi për të mos lejuar kombin tonë që të jetë strehe e sigurt për ata që ofrojnë ndihmë për veprimtarinë e terroristëve. Sami al Ariani ka kaluar tashme kohë të konsiderueshme pas hekurave dhe tani do të humbase të drejtën për të jetuar në vendin që ai e quan shtëpi"*⁵⁶.

Section 215 e Patriot Act autorizon Drejtorin e FBI-së të urdhëroje prodhimin e "çdo gjëje të përafërt" (përfshirë libra, cd, dokumente dhe sende të tjera) që shërben për

⁵⁴*To make matters worse, the government reneged on its plea agreement by demanding that al-Arian appear before a grand jury in Virginia. When al-Arian refused to testify, citing his agreement with federal prosecutors, he has given an eighteen-month prison sentence for contempt of court. Each time a new grand jury was empanelled, al-Arian's prison sentence was renewed, effectively making his period of incarceration indefinite.*

⁵⁵*On January 21, 2007, al-Arian began a hunger strike to protest the government's actions and the conditions of his imprisonment. After the twenty-third day without food, he collapsed and was moved to a medical facility in North Carolina, where he was kept in twenty-four-hour solitary confinement. Amnesty International sent a letter to Attorney General Alberto Gonzales protesting al-Arian's treatment, saying it was 'in breach of the USA's obligations under international standards and treaties'.*

⁵⁶*"We have a responsibility not to allow our nation to be a safe haven for those who provide assistance to the activity of terrorists. Sami al Arian has already spent significant time behind bars and will now lose the right to live in the country he calls home".*

hetimet në mbrojtje të kombit nga terrorizmi ndërkombëtar dhe nga veprimtari klandestine të inteligjencës.

Section 411 i Patriot Act-it i përkufizon "organizime terroriste të huaja" dhe autorizon Sekretarin e Shtetit të vendosë për këto organizata. Parashikimi i ruajtjes së Section 411 kërkon shtatë ditë përpara piketimit të organizatës terroriste, Sekretari i Shtetit duhet t'u komunikojë lidereve të Dhomes dhe të Senatit qëllimin e piketimit të organizatave dhe arsytet për të cilat do të vepohet. Section 412 autorizon burgosjen e të huajve të rrezikshëm për sigurinë kombëtare. Dispozitat e survejimit të Section 412 kërkojnë që Ministri i Drejtësisë duhet të formulojë një relacion të numrit të të huajve çdo gjashtë muaj pranë Komisionit të Drejtësisë të Dhomës dhe Senatit; gjithashtu duhet të dëftojë mbi kombësinë e të huajve, mbi kohëzgjatjen e arrestimit, mbi numrin e të huajve të certifikuar, të cilët përjashtoheshin, të liruarit nga burgu, ose shtetasve të huaj që nuk janë me objekt certifikimi.

Section 1001 e Patriot Act-it është, në tërësinë e vet, një klauzolë e gabuar, që i kërkon Inspektorit të Përgjithshëm të Departamentit të Drejtësisë (DOJ) të vendosë një zyrtar për të marrë informacionet dhe denoncimet në lidhje me abuzimet e të drejtave dhe lirive civile nga ana e të punësuarve dhe zyrtarëve të Departamentit të Drejtësisë, dhe i paraqet Kongresit një relacion semestral, duke përshkruar çdo tipologji abuzimesh.

Gjatë seancës së Kongresit mbi Patriot Act-in në tetor 2001, Senatori Maria Kantuell u adresua te Judiciary Committee Chairman, Patrik Leahy:

"Mund të pyes Kryetarin, nëse pajtoheni me faktin se në këto rrethana është detyrë e komisionit, i cili ka juridiksion mbi Departamentin e Drejtësisë për të ruajtur mbikëqyrjen vigjilente të departamentit në përdorimin e saj nga autoritetet e FISA-s pas hyrjes në fuqi të këtij legjislacioni?"⁵⁷.

Leahi iu përgjigj: *"Unë pajtohem me ju plotësisht dhe ju mund të jeni të sigurt se komisioni gjyqësor nën drejtimin tim do të kryejë mbikëqyrje kuptimplote... Seksioni 306 i FISA-s... siguron raportet gjashtëmujore nga Prokurori i Përgjithshëm për urdhërat e*

⁵⁷" May I ask the Chairman, do you agree that, under these circumstances it is incumbent upon the committee which has jurisdiction over the Department of Justice to maintain vigilant oversight of the department in its use of FISA authorities after the enactment of this legislation?" -

kërkimeve fizike të bëra, të dhëna, të modifikuara ose mohuara, dhe numri i kërkimeve fizike, të cilat përfshirë pronësi të personave të Shteteve të Bashkuara" ⁵⁸.

Kantuelli iu përgjigj: *"Përgjegjësia e komisionit gjyqësor do të jetë më e madhe nën (Patriot Act) amendamentin e FISA-s, për shkak të kompetencave për të përdorur FISA-n për qëllime të zbatimit të ligjit. Unë do të doja t'i sugjeroja kryetarit... se Zyra e Përgjithshme e Kontabilitetit i siguron çdo gjashtë muaj Komisionit Gjyqësor të Senatit një raport mbi përdorimin e autoriteteve të pergjimit FISA, si edhe autoritet në mbikëqyrje të regjistruar në formë stilolapsi dhe pajisjet e "kurthit-dhe-gjurmëve"*"⁵⁹, nga Byroja e Hetimeve Federale apo agjenci të tjera në kuadër të Departamentit të Drejtësisë... Vetëm me mbikëqyrje të tilla mund t'i sigurojmë zgjedhësit tanë në mënyrë të arsyeshme se përdorimi i këtyre autoriteteve të reja nuk çënon të drejtat tona për ndryshime.

Në javët që vijuan kalimin e Patriot Act-it, Senate Judiciary Committee, i kryesuar nga senatori demokrat Patrik Leahi, thirri funksionarët e lartë të Departamentit të Drejtësisë për të emëruar autoritetet e reja të shërbimeve sekrete. DOJ qartësoi shpejt se kërkonte të bënte disa përmirësime mbi ligjet kundër terrorizmit, duke përfshirë zgjerimin e përkufizimit "foreign power", i cili përfshinte shtetasit joamerikane të përfshirë në terrorizmin ndërkombëtar. Leahi, i ndjekur nga koleget Çarlz Graslei dhe Arlen Spekter, denoncoi:

⁵⁸" I agree with you completely, and you can rest assured that the Judiciary Committee under my chairmanship will conduct meaningful oversight....Section 306 of FISAprovides for semiannual reports from the Attorney General for the physical search orders made, granted, modified or denied, and the number of physical searches which involved the property of United States persons. The Judiciary Committee's responsibility will be greater under (Patriot Act) amendment to FISA, because of the greater authority to use FISA for law enforcement purposes " .

⁵⁹"I would like to suggest to the chairman....that the General Accounting Office provide to the Senate Judiciary Committee every six months a report on the use of the FISA wiretap authorities, and the expanded pen register and trap-and-trace authorities, by the Federal Bureau Investigation or other agencies within the Department of Justice....Only with such oversight can we reasonably assure our constituents that the use of these new authorities is not impinging on our amendment rights".

*"Menjëherë pasi komisioni filloi seancat dëgjimore mbikëqyrëse dhe kishte konfirmuar drejtorin e ri të FBI-së, kombi pësoi sulmet terroriste të 11 Shtatorit 2001... Menjëherë pas sulmeve, Kongresi dhe, në veçanti, Komisioni Gjyqësor i Senatit, iu përgjigj kërkesave nga ana e Departamentit të Drejtësisë (DD) dhe FBI për më shumë kompetenca për të përmbushur sfidat e sigurisë që vijnë nga terrorizmi ndërkombëtar. Në kemi punuar së bashku për hartimin e Aktit Patriotik të SH.B.A-ve në mënyrë që të jepte kompetenca të tilla. Me kompetencat e zgjeruara vjen një potencial në rritje për abuzim dhe domosdoshmëria për mbikëqyrje të zgjeruar të kongresit... Herë pas here, DD-ja dhe FBI kanë qenë bashkëpunuese në përpjekjet tona të mbikëqyrjes"*⁶⁰.

*"Për fat të keq, megjithatë, nganjëherë DD dhe FBI kanë vonuar apo refuzuar përgjigjen e pyetjeve plotësisht legjitime të hetimit. Një heshtje e tillë vetëm nënvizon më tej nevojën për mbikëqyrje të vazhdueshme agresive të kongresit. Sistemi ynë kushtetues i kontrolleve dhe i ekuilibrave dhe shqetësimet tona jetësore të sigurisë kombëtare e kërkojnë një gjë të tillë. Në të ardhmen, ne kërkojmë nga DD-ja dhe FBI të përqafojnë, e jo të rezistojnë ndaj shqyrtimit të shëndetshëm që sjell mbikëqyrja e ligjshme e Kongresit"*⁶¹.

Marrëdhëniet me DOJ dhe Senate Judiciary Committee vazhduan të përkeqësoheshin. Gjatë dhjetë muajve të parë nga miratimi i Patriot Act-it, Komiteti i dërgoi njëzet e shtatë shkresa pa përgjigje Departamentit të Drejtësisë në lidhje me Patriot Act-in dhe çështje që lidheshin me të. Leahy komentoi: *"Për aq kohë sa kam qenë këtu, unë kurrë*

⁶⁰*"Shortly after the Committee initiated oversight hearings and had confirmed the new Director of the FBI, the Nation suffered the terrorist attacks of September 11, 2001....In the immediate aftermath of the attacks, the Congress and, in particular, the Senate Judiciary Committee responded to demands by the Department of Justice (DOJ) and the FBI for greater powers to meet the security challenges posed by international terrorism. We worked together to craft the USA PATRIOT ACT to provide such powers. With those enhanced powers comes an increased potential for abuse and the necessity of enhanced congressional oversight....at times, the DOJ and FBI have been cooperative in our oversight efforts.*

⁶¹*Unfortunately, however, at times the DOJ and FBI have wither delayed answering or refused to answer fully legitimate oversight questions. Such reticence only further underscores the need for continued aggressive congressional oversight. Our constitutional system of checks and balances and our vital national security concerns demand no less. In the future, we urge the DOJ and FBI to embrace, rather than resist, the healthy scrutiny that legitimate congressional oversight brings".*

*nuk kam njohur një qeveri më të vështirë, nga e cila të merret informacion sesa komisionet mbikëqyrëse kanë të drejtë të bëjnë "*⁶².

DOJ iu pergjigj disa pyetjeve, po jo Judiciary Committee, i cili i kërkoi, por Intelligence Committee, duke provokuar pakënaqesinë e Leahit: *"Përpyjekje të tilla, që lidhen me blerjen e forumit nga Dega e Ekzekutivi, nuk janë mjete produktive për të lehtësuar mbikëqyrjen legjitime"*⁶³.

Gjatë seancave të survejimit të datës 8 maj, 6 qershor, 10 shtator 2002, titullarët e Departamentit të Drejtësisë dhe Drejtori i FBI-së Myler, u dëgjuan gjerësisht, shpeshherë edhe në formë të shkruar, por disa herë nuk përgjigjeshin. Një relacion i Judiciary Committee deklaroi:

*"Veçanërisht në lidhje me përpjekjet tona mbikëqyrëse FISA, ne jemi të zhgënjyer me mosreagimin e DD-së dhe FBI-së. Edhe pse FBI-ja dhe DD-ja kanë bashkëpunuar ndonjëherë me përpjekjet tona të mbikëqyrjes, shpesh kërkesat legjitime mbeten pa përgjigje ose përgjigjet e DD-së janë vonuar për një kohë të gjatë, ose kanë qenë minimalisht të dobishme në përpjekjet e mbikëqyrjes së komisionit. Vështirësia në marrjen e përgjigjeve nga DD-ja nxiti senatorin Spekter për t'i kërkuar Prokurorit të Përgjithshëm në mënyrë të drejtpërdrejtë se "si mund të komunikojmë me ju, në një kohë që jeni ju me të vërtetë shumë i zënë për t'u përgjigjur?"*⁶⁴.

Judiciary Committee bëri një raportim duke konkluduar:

"FBI e ka bërë të vështirë ushtrimin e kompetencave tona të mbikëqyrjes. Kjo është shpresa jonë e sinqertë se FBI-ja dhe DD-ja do të rishqyrtojnë qasjen e tyre për

⁶² "Since I have been here, I have never known an administration that is more difficult to get information from than the oversight committees are entitled to ".

⁶³ "Such attempts at forum shopping by the Executive Branch are not a productive means of facilitating legitimate oversight ".

⁶⁴ "Particularly with respect to our FISA oversight efforts, we are disappointed with the non-responsiveness of the DOJ and FBI. Although the FBI and the DOJ have sometimes cooperated with our oversight efforts, often, legitimate requests went unanswered or the DOJ answers were delayed for the long or were of minimal use in the oversight efforts of the Committee. The difficulty in obtaining responses from DOJ prompted Senator Specter to ask the Attorney General directly, 'how do we communicate with you and are you really too busy to respond ?' ".

mbikëqyrjen e Kongresit në të ardhmen. Kongresi dhe populli amerikan meritojnë të dinë se çfare është duke bërë qeveria e tyre. Sigurisht, departamenti nuk duhet të presë që Kongresi të jetë "vulë gome" në kërkesën e saj për fuqi të reja ose të zgjeruara, nëse kërkesat për informacion në lidhje me mënyrën se si Departamenti i ka trajtuar kompetencat ekzistuese, ose janë injoruar apo kanë paguar menjëherë premtime bosh".⁶⁵

Më në fund, më 23 dhjetor 2002, zëvendësministri i Drejtësisë, Daniel Briant, gjeti një përgjigje për pyetjen e Leahit.

Leahi kërkoi:

"A. A-së i ka kërkuar FBI-ja të dhëna nga biblioteka ose libraria sipas nenit 215 të Ligjit Patriotik?

B. A mundet që FBI të japë një urdhër të tillë në një bibliotekë publike, duke kërkuar që ajo të prodhojë të dhëna në lidhje me përdorimin e internetit nga personat në patronazh?

C. A kanë biblioteka dhe libraria një "pritje të arsyeshme të privatësisë" në titujt e librave që kanë blerë apo huazuar?"⁶⁶

Departamenti i Drejtësisë iu përgjigj pyetjes si vijon:

A. Çdo informacion në lidhje me zbatimin e nenit 215 është klasifikuar "në nivelin SEKRET" dhe do të duhet të sigurohet nën një kapak/mbulesë të veçantë.

⁶⁵*"The FBI have made exercise of our oversight responsibilities difficult. It is our sincere hope that the FBI and DOJ will reconsider their approach to congressional oversight in the future. The Congress and the American people deserve to know what their government is doing. Certainly, the department should not expect Congress to be 'rubber stamp' on its request for new or expanded powers if requests for information about how the Department has handled its existing powers have either been ignored or summarily paid lip service".*

⁶⁶*Has the FBI requested records from the library or bookstore under Section 215 of the Patriot Act? Can the FBI serve such an order on a public library requiring it to produce records about patron Internet use? Do library and bookstore patrons have a "reasonable expectation of privacy" in the titles of books they have purchased or borrowed?*

B. "Një urdher i tillë mendohet të shërbehet në një bibliotekë publike, "por" mjeti më i përshtatshëm për të kërkuar komunikim elektronik të të dhënave të transaksioneve do të ishte një Letër e Sigurisë Kombëtare (NSL).

C. "Çdo e drejtë e privatësisë që zotërojnë personat në patronazh të bibliotekës dhe të librarisë për një informacion të tillë është domosdoshmërisht në thelb e kufizuar, pasi nga vetë natyra e këtyre transaksioneve, personi në patronazh mbështetet në atë informacion në bibliotekë ose librari dhe supozon rrezikun që dikush mund t'ia zbulojë atë tek një tjetër. Çfarëdo interesi privat që një person në patronazh mund të ketë dominohet nga interesat e qeverisë për marrjen e informacionit në rastet kur FBI-ja mund t'i tregojë rëndësinë personit në patronazh për një hetim të plotë të autorizuar, të mbrojtur kundër terrorizmit ndërkombëtar apo veprimtarive të inteligjencës klandestine.

Në qershorin e vitit 2002, House Judiciary Committee dërgoi një letër Ministrit të Drejtësisë, Xhon Ashcroft, duke i kërkuar t'u përgjigjet pesëdhjetë pyetjeve mbi Patriot Act-in. DOJ iu përgjigj vetëm njëzet e tetë prej tyre. Për shembull, pyetja numër 14 kishte të bënte me faktin nëse survejimi i autorizuar deri në atë moment autorizonte standardet e Section 218 (requiring that foreign intelligence be only "a significant purpose" o fan investigation rather than "the purpose") kishte shkaktuar apo jo kryerjen e akteve që nuk janë të autorizuar nga e drejta primare.

DOJ u përgjigj:

"Because we immediately began using the new 'significant purpose' standard after passage of the PATRIOT ACT, we had no occasion to make contemporaneous assessments on whether our FISA would also satisfy a 'primary purpose' standard. Therefore, we cannot respond to the question with specificity".

DOJ ishte më e qartë në përgjigjet e pyetjeve në lidhje me parashikimet e Patriot Act-it mbi emigracionin. Pyetja numer 35 A trajtonte faktin nëse Emigration and Naturalization Service (INS) përdorte përkufizimet mbi terrorizmin të Patriot Act-it. DOJ u përgjigj: " Edhe pse nuk janë ngritur akuza të tjera si rezultat i ndryshimeve të

nenit 411, ne kemi vlerësuar dhe do të vazhdojmë të vlerësojmë me kujdes çdo rast për potencialin e shtimit të akuzave të tjera të krijuara nga Ligji Patriotik"⁶⁷.

Pyetja 35 B kishte të bënte me çështjen nëse moslejimi i ndonjë shtetasi të huaj është i bazuar mbi motivacione të diktuar nga Patriot Act-i. DOJ u përgjigj: *"Një të huaji i është refuzuar pranimi bazuar në këto dispozita të reja. Atij i është refuzuar hyrja në Programin e Heqjes së VIZA-ve, sepse ka arsye të besohet se ai është pastrues parash"*⁶⁸.

Pyetja 35 C lidhej me efektet që Section 411 ka pasur mbi hetimet e kryera. DOJ u përgjigj: *"Përkufizimi i zgjeruar i Nenit 411 për "angazhimin në aktivitetet terroriste", si dhe përkufizimet e reja të "organizatës terroriste "duhet t'i mundësojnë INS t'i ngarkojë më shumë qytetarët e huaj me arsyet që lidhen me sigurinë e largimit... INS është duke shqyrtuar çdo hetim të mundshëm terrorist të lidhur me përdorimin e duhur të mjeteve të shtuara nga neni 411 "*⁶⁹.

Pyetja 35 D i kërkonte Ministrit të Drejtësisë nëse ai kishte përdorur Section 411 për të aneksuar ndonjë të huaj, i cili "kishte përdorur pozicionin e tij brënda çdo vendi për të mbështetur apo përqaftuar një veprimtari terroriste apo për t'u mbushur mendjen të tjerëve të mbështesnin një veprimtari terroriste ose organizatë terroriste". DOJ u përgjigj se ishte në pritje të sinjalizimeve të Departamentit të Drejtësisë për t'iu përgjigjur një pyetjeje të tillë.

Pyetja 35 E i referohet faktit se ndonjë i huaj është konsideruar i padëshuruar për shkak të ndonjë bashkimi me organizatat terroriste. DOJ u përgjigj se asnjë i huaj nuk është përjashtuar mbi bazën e Section 411, por ky i fundit *"që nga konceptimi i Ligjit*

⁶⁷" *Although no additional charges have been filed as a result of the changes to Section 411, we have and will continue to carefully assess each case for the potential of adding additional charges created by the Patriot Act "*.

⁶⁸" *One alien has been denied admission under this new provisions. He was refused admission under the VISA Waiver Program as there is reason to believe that he is a money launderer "*.

⁶⁹" *Section 411's expanded definition of 'engage in terrorist activity', as well as the new definitions of 'terrorist organization ' should enable the INS to charge more aliens with the security-related grounds of removal....The INS is currently examining each potential terrorist-related investigation for appropriate use of the additional tools added by Section 411".*

*Patriotik te SH.B.A-ve, dhe për shkak të dispozitave të reja, emrat e 304 të huajve... janë shtuar në bazën e të dhënave kënder terrorizmit, TIROFF"*⁷⁰.

Pyetja 36 lidhet me burgimin e detyrueshëm të permendur nga Patriot Act në Section 412. DOJ u përgjigj: *"Që nga 11 Shtatori dhe miratimi i Ligjit Patriotik, INS ka ndaluar një numër të madh qytetarësh të huaj për shkelje të ligjit të emigracionit, të cilët gjithashtu paraqesin rreziqe për sigurinë kombëtare. Megjithatë, ka qenë e panevojshme të përdorësh procedurën e re të certifikimit të shtuar nga Ligji Patriotik..."*⁷¹.

Pyetja 24: *"Ju lutemi, këshilloni Komitetin ⁴⁶ se sa shumë sulme terroriste janë penguar që prej 11 Shtatorit 2001, në ç'mënyrë.... ku ishin planifikuar të ndodhnin këto sulme terroriste"*⁷².

*DOJ u përgjigj: "Është e pamundur të dihet saktësisht se sa sulme terroriste janë parandaluar, por FBI, Departamenti i Drejtësisë, dhe të gjitha agjencitë përkatëse federale, së bashku me aleatët tanë ndërkombëtarë dhe qeveritë vendore janë duke punuar në mënyrë agresive për të parandaluar një tjetër sulm"*⁷³.

Pyetja 29 trajton sekuestron e të mirave civile duke iu referuar Section 806 të Patriot Act-it. Kërkohej: *"A e ka përdorur Departamenti i Drejtësisë këtë kompetencë? Nëse po, cili është statusi i pasurive të sekuestruara? A është gjykuar ndonjë nga këto konfiskime sipas këtij neni në gjykatë?"* DD përgjigjet: *"Aktualisht, është një rast i vetëm në proces, i cili nuk mund të bëhet publik. Asetet janë konfiskuar në bazë të një*

⁷⁰ "Since inception of the USA PATRIOT ACT, and due to the new provisions, the name of 304 aliens....have been added to the counter-terrorism database, TIROFF ".

⁷¹"Since September 11 and enactment of the Patriot Act, the INS has detained numerous aliens for violations of immigration law and who also present National security risks. It has been unnecessary, however, to use the new certification procedure added by the Patriot Act....".

⁷² "Please advise the Committee as to how many terrorist attacks have been prevented since September 11, 2001, how....where were this terrorist attacks planned to have taken place ?".

⁷³ "It is impossible to know exactly how many terrorist attacks have been prevented, but the FBI, Department of Justice, and all relevant Federal agencies, along with our international allies and colleagues in State and local government have been aggressively working to prevent another attack" -

urdhri gjyqësor të autorizuar për sekuestrim.... Asnjë nga konfiskimet sipas këtij neni nuk është kundërshtuar në gjykatë ⁷⁴.

Pyetja 50 godet Section 1001 të Patriot Act-it dhe interpelon DOJ Inspector General (OIG) të ekzaminojë denoncimet mbi abuzimet e të drejtave civile dhe lirive civile. Kërkohet: *"Sa ankesa të tilla janë pranuar që kur kanë filluar hetimet? Cili është statusi i këtyre hetimeve?"* DD përgjigjet: *"Që nga 15 qershori 2002, OIG kishte marrë rreth 450 ankesa me leter, e-mail, telefon, ose me rekomandim nga Divizioni për të Drejtat Civile?"* ⁷⁵.

Në fund të gushtit 2002, Judiciary Committee formuloi një seri pyetjesh të tjera DOJ, e cila u përgjigj me një shkresë të datës 20 shtator në SDensenbrenner. Pyetjet më të rëndësishme ishin 10 dhe 11, me anë të të cilave i kërkonte DOJ të pershkruante masat e marra për të evituar Section 214 dhe 215 të Patriot Act-in të përdorura kundër individëve vetëm duke iu referuar Amendamentit të Parë. DOJ përdori po të njëjtën gjuhë për t'iu përgjigjur të dyja pyetjeve. Në fillim po analizoj përgjigjen e pyetjes së parë:

"Një kujdes i madh është bërë për të siguruar që një urdhër që autorizon instalimin dhe përdorimin e një regjistruesi në formë stilolapsi ose një tjetër pajisje gjurmuese, nuk kërkohet vetëm në bazë të aktiviteteve të mbrojtura nga Amendamenti i Parë. Në secilin rast kur një urdhër është kërkuar nga Gjykata e Mbikëqyrjes së Inteligjencës së Jashtme, avokati për qeverinë kryen një rishikim themelor të bazës faktike, duke theksuar hetimin si dhe kërkesën për autoritetin që ka në mbikëqyrje stilolapsin/kurthin. Prokurori i Përgjithshëm ose i emëruari i tij, Avokati i Politikës së Inteligjencës..., personalisht miraton paraqitjen e çdo kërkesë pranë gjykatës. Një deklaratë e shkurtër e fakteve, në çdo rast, paraqitet më pas në gjykatë bashkë me certifikimin e qeverisë,

⁷⁴"Has the Department of Justice used this power? If so, what is the status of the seized assets? Have any seizures under this section been challenged in court?" DOJ rispose: "Currently, there is a single case ongoing, which is not matter of public record. The assets have been seized pursuant to a court authorized seizure warrant....No seizures under this section have been challenged in court".

⁷⁵"How many such complaints have been received? How many investigations have been initiated? What is the status of those investigations?"

*nënshkruar nga aplikuesi individual, që urdhri nuk është duke u kërkuar vetëm për aktivitetet e mbrojtura nga Amendamenti i Parë”.*⁷⁶

Përgjigjja e pyetjes 11 ishte po e njëjta, thjesht u zëvendësuan fjalët: “prodhimi i gjërave të prekshme” me “instalimi dhe përdorimi i një stilolapsi për shënime të ndryshme”.

Në qershor të vitit 2003, American Civil Liberties Union (ACLU), lëshoi një deklaratë që sugjeron se pyetjet dhe përgjigjet janë dhënë, por nuk janë inkurajuese. ACLU përfundon si më poshtë:

- 1. DD-ja nuk ka nevojë për shumë nga pokeri që përmbahet në Ligjin Patriotik të SH.B.A-ve, ose nëpërmjet rregulloreve të reja dhe ndryshimeve në politikat shumëvjeçare të qeverisë, të tilla si udhëzimet e hetimit të Prokurorit të Përgjithshëm;*
- 2. DD-ja përmendi frikën e terrorizmit për të marrë pushtet pa debatet e duhura, të cilat u përdorën me pas në rastet e zakonshme penale;*
- 3. DD-ja ka dështuar për t'iu përgjigjur shumë pyetjeve legjitime që Kongresi ka parashtruar në lidhje me përdorimin e Ligjit Patriotik të SH.B.A-ve dhe kompetenca të tjera të reja; dhe*

⁷⁶*"A great deal of care is given to ensure that an order authorizing the installation and use of a pen register or trap and trace device is not sought solely on the basis of activities protected by the First Amendment. In each case in which an order is sought from the Foreign Intelligence Surveillance Court, the attorney for the government conducts a review of the factual basis underlying the investigation and the request for the pen/trap authority. The Attorney General or his designee, the Counsel for Intelligence policy..., personally approves the filing of every application with the Court. A brief statement of facts in each case is then presented to the Court, along with the Government's certification, signed by the individual applicant, that the order is not being sought solely for activities protected by the First Amendment" .*

4. DD-ja ka qenë mashtruese në përshkrimin e fushëveprimit të kompetencave që i janë dhënë, me sa duket për të zbutur shqetësimin e gjerë publik.⁷⁷

Audicione të rëndësishme janë mbajtur në qershor të vitit 2003 deri në vitin 2005. Në audicionin e parë, Ministri i Drejtësisë Xhon Ashkroft mbrojti me këmbëngulje Patriot Act-in. Në audicionin e mëtejshëm të vitit 2005 Ministri i ri i Drejtësisë, Alberto Gonzales, i dërgoi një bashkëpunëtor të tij Ministrin të Drejtësisë, Xhejms Komei, për të qetësuar preokupimin në rritje të Kongresit në lidhje me aplikimin e Patriot Act-it. Një diferencë e madhe në dy vite. Komei përdori një ton bashkëpunimi, duke nxitur prirjen e personave për "mosbesim ndaj pushtetit të Qeverisë".

Toni i Ashkroftit në diskutimin e vitit 2003 ishte agresiv dhe ekzaltues. Ai e nisi dëshminë e tij duke e përzier me një thirrje për luftë:

"Departamenti i Drejtësisë së Shteteve të Bashkuara u thirr për të mbrojtur Amerikën. Ne e pranojmë përgjegjësinë. Ne luftojmë sipas traditës së të gjithë Amerikës së madhe me vendosmëri, këmbëngulje dhe nder. Ne luftojmë për të siguruar fitoren mbi të keqen mes nesh. Ne luftojmë për të mbështetur lirite dhe idealet që përcaktojnë një popull të lirë dhe të guximshëm. Çdo ditë, Departamenti i Drejtësisë po punon pa u lodhur, duke e çuar këtë luftë në strehimet e armiqve tanë, në mënyrë që kjo kurre të mos prekë zemrat dhe shtëpitë e Amerikës »".⁷⁸

⁷⁷The DOJ did not need many of the power it obtained in the USA PATRIOT ACT or through new regulations and changes in long standing government policies, such as Attorney General's investigative guidelines;

DOJ cited fears of terrorism to get powers without adequate debate which were then used in ordinary criminal cases;

DOJ has failed to answer many of the legitimate questions Congress has posed about its use of the USA PATRIOT ACT and another need powers; and

DOJ has been deceptive in describing the scope of the powers it has been granted, apparently to mollify widespread public concern.

⁷⁸" The United States Department of Justice has been called to defend America. We accept the charge. We fight in the tradition of all great America struggles with resolve, will defiance and honor. We fight to secure victory over the evil in our midst. We fight to uphold the liberties and ideals that define a free and brave people. Every day the Justice Department is working tirelessly, taking this war to the hideouts and havens of our enemies so that this never again touches the hearts and homes of America."

Jo të gjithë anëtarët e Komitetit mbetën të impresionuar nga retorika e patriotike e Ministrit të Drejtësisë. Një anëtar i Komitetit iu drejtua Ashkroftit duke i thënë:

"Ne jemi të shqetësuar për mënyrën se si e keni përdorur pushtetin tuaj, mënyrën se si keni paraburgosur emigrantë, dhe ne jemi gjithnjë e më të shqetësuar për mënyrën se si e keni përdorur Foreign Intelligence Surveillance Act-in.... Ju qëndroni në faktin se Shtetet e Bashkuara kanë dëbuar 5.145 të individëve lidhur me hetimin e terrorizmit të 11 Shtatorit... Nuk është e vërtetë se pasi qenë rrethuar këta individë, ju kuptuat se nuk kishin lidhje me terrorizmin, por gjetët problemin me statusin e tyre të emigracionit që keni dhene me një baze të thjeshtë ligjore për deportimin e tyre? Kjo është ajo që doni të thoni kur pohoni që këta individë ishin të lidhur me hetimin e 11 Shtatorit?"

Ky ishte një rizgjim i egër për Ministrin e Drejtësisë. Ashkroft iu përgjigj:

"Ju ngritët pyetjen se kush kishte - kush ishin - individët që ishin të lidhur me hetimin e terrorizmit. Ka individë të cilët kishin lidhje të forta me terroristët ndaj të cilëve nuk kemi asnjë rast që rezultonte i mjaftueshëm për të sjellë materiale në gjykatë që të ishin kundër interesave të sigurisë kombëtare të Shteteve të Bashkuara. Dhe disa nga ato raste që kemi për gjykim konsiderohen mbi bazën e interesit në të mirë të Shteteve të Bashkuara".

Një ballafaqim i tillë ndodhi edhe mes Ashkroftit dhe Uilliam Delahundit, i cili e nisi diskutimin e tij si më poshtë:

"Z. Prokuror i Përgjithshëm, hera e fundit që ju u paraqitet para këtij komisioni ishte rreth 18 muaj më parë dhe na kërkuat të miratonim Patriot Act -in. Në atë kohë, ne ishim të gjithë duke luftuar për të kuptuar madhësinë e sulmit mbi vendin dhe humbjen e jetëve të pafajshme

Sot, realiteti është se shumë amerikanë janë gjithnjë e më të shqetësuar në lidhje me disa nga masat e ACT -it. Siç jua treguan, bibliotekat dhe dyqanet e librave kanë nisur një fushatë për të përmbysur nenin 215, dhe rezultatet e qyteteve dhe qytezave në të gjithë Amerikën kane miratuar rezoluta të cilat kundërshtojnë Patriot Act-in... Duket se... populli amerikan mendon se Qeveria ka si qëllim të duket në çdo qoshe dhe të mësojë për jetën private të njerëzve, ndërsa, në të njëjtën kohë, duke bërë gjithçka që

mundet për të bllokuar qasjen me informatat e Qeverisë që do të informojnë popullin amerikan se çfarë po bëhet në emër të tyre....

Ju thoshit në deklaratën tuaj se "ne nuk duhet të harrojmë që armiq të tanë janë fanatikë të pamëshirshëm", dhe keni të drejtë. Ne të gjithë jemi dakord me këtë. Por zgjidhja për ne nuk është të bëhemi fanatikë që të rëformojmë imazhin e shoqërisë sonë mbi bazën e atyre sulmeve. Pastaj unë mendoj se në këtë mënyrë ne u kemi dhënë atyre një fitore që askush këtu nuk do t'ua jepte".

Ashcrofti iu përgjigj: *"Para se gjithash, arsyetimi për të mos nxjerrë asgjë është në interesin kombëtar. Ka shumë raste, sidomos në inteligjencën ndërkombëtare, në çështjet e sigurisë, kur ne nuk nxjerrim sekrete, sepse nuk është në interesin kombëtar për ta bërë këtë".⁷⁹ Përmbyllja: "Mua më duket zbavitëse, kur më është sugjeruar në Kongres që kam një plan sekret për të ndryshuar ligjin... Unë mund t'ju siguroj se, në rast se ligji ndryshon, ky Kongres do të përfshihet në atë proces dhe unë nuk do të kem një votë për të".⁸⁰*

Në vitin 2005, lidhjet mes Kongresit dhe Ministrit të Drejtësisë drejtoheshin nga Ministri i ri i Drejtësisë, Alberto Gonzales. Kur Xhejms Komei (Deputy Attorney General) në qershor të vitit 2005 u paraqit përpara Judiciary Committee, u prit ngrohtësisht nga Sensenbrenner, i cili i çeli diskutimet me një logjikë mbështetëse: *"A besoni ju se neni 218 i Ligjit Patriotik shembi murin që pengonte komunikimin mes agjencive? A duhet të bëhet kjo pjesë e përhershme? Dhe a mund të na jepni disa detaje specifike se pse kishte probleme para 9/11, dhe se si zgjidhet kjo?"*.⁸¹

Komei iu përgjigj qetësisht:

⁷⁹"First of all, the rationale for not releasing anything is the national interest. There are lots of times, especially in international intelligence, security matters, when we don't release things because it is not the national interest to do so".

⁸⁰I tend to find it amusing when it is suggested to me in the Congress that I have a secret plane to change the law....I can assure you that in the event that law is changed, this Congress will be involved in it and I won't have a vote on it".

⁸¹" Do you believe that Section 218 of the Patriot Act helps tear down the wall that prevented communications between agencies? Should we make this section permanent? And can you give us some specific details on why had problems before 9/11, and how this was solved?"

*“Po, Zoti Kryetar, unë ndihem i kënaqur dhe ju falënderoj për pyetjen. Neni 218 e ka ndryshuar botën tonë. Kjo është një pjesë e Ligjit Patriotik, që thyen çdo gjë, “tund botën”, befasues për ata që i kanë përkushtuar jetën kësaj pune, sepse e rrezoi atë mur... kjo është pjesa absolutisht më e rëndësishme e Ligjit Patriotik. Dhe në qoftë se ajo do të hiqej, ne do të ktheheshim në një vend ku njerëzit nuk do të donin të ishin. Kjo e ka ndryshuar botën për mirë, zoti Kryetar”.*⁸²

Disa prej demokratëve në Komitet kishin disa pyetje për t’i drejtuar Komeit dhe mbetën të kënaqur nga përgjigjja e tij. Në fund të diskutimit dukej se kishte rënë njëfarë optimizmi dhe bashkepunimi mes Kongresit dhe DOJ.

Ky fakt është përmbledhur nga Sensenbrenner, në reflektimin e tij të fundit:

*“Unë besoj se një vit e gjysmë më parë Departamenti i Drejtësisë ka qenë shumë më i disponueshëm në Ligjin Patriotik edhe për çështje të tjera krahasuar me dy vite e gjysmë më parë. Dhe kjo karrige ka shprehur edhe publikisht dhe privatisht tek ish-Prokurori i Përgjithshëm, Xhon Ashcroft, se qendrimi “unë kam një sekret” në lidhje me mbikëqyrjen legjitime, që nuk ka të bëjë me informacionin e klasifikuar, është vetësfiduese”.*⁸³

“Unë do të doja t’ju përshëndesja ju dhe Prokurorin e Përgjithshëm, Gonzales. Mendoj se ka pasur një ndryshim në qendrim, që ka qenë veçanërisht i dukshëm në seancat që kemi pasur mbi këtë. Ju ndihmoni kauzën tuaj duke ardhur deri këtu dhe duke iu

⁸²*"Yes, Mr. Chairman, I'd be glad to, and thank you for the question. Section 218 changed our world. It is the one part of the Patriot Act that is groundbreaking, earthshaking, breathtaking to those of us who have devoted our lives to this work, because it broke down that wall....That is the absolutely most important part of the Patriot Act. And if it were to go away, we would go back to a place that people don't want us to be. That changed our world better, Mr. Chairman".*

⁸³*"I believe that in the last year and a half the Justice Department has been much more forthcoming on the Patriot Act and on other issues than in the two and a half years prior to that. And this Chair has both publicly and privately expressed to former Attorney General John Ashcroft that an 'I've got a secret' attitude on legitimate oversight that does not involve classified information is self-defeating.*

*përgjigjur pyetjeve mbi mënyrën se si ju vepruat, dhe mënyrën se si shefi juaj veproi disa muaj më parë. Dhe unë shpresoj që ajo të vazhdojë”.*⁸⁴

Edhe pse i gjithë Patriot Act-i sjell interes të gjerë, seksioni më i rëndësishëm është Section 1001, i cili u referohet abuzimeve mbi të drejtat civile dhe mbi liritë civile nga ana e zyrtarëve të shërbimeve sekrete, ose të Departamentit të Drejtësisë. Janë ekzaminuar tri pika thelbësore:

- Mundësia e të ndaluarve për të marrë këshillues ligjor;
- Koha e qeverisë për lëshimin e akuzave penale ose administrative; dhe
- Kushtet e përgjithshme të ndalimit që të burgosurit kanë përjetuar, duke përfshirë akuzat e abuzimit fizik dhe verbal, kufizimeve mbi vizitat, kujdesin mjekësor, kohezgjatjen e paraburgimit, politikat e izolimit dhe kushtet e banimit.⁸⁵

Relacioni përmbyllet si vijon: *“OIG ka identifikuar zyrtarë që dyshohet të jenë përfshirë në abuzim. Përveç kësaj, OIG ka intervistuar viktimat e supozuara dhe ka rishikuar të dhënat e tyre mjekësore”.*⁸⁶

Relacioni i dytë i OIG nis në këtë mënyrë: *“Gjatë kësaj periudhe raportuese, OIG ka hapur 6 hetime të reja lidhur me Ligjin Patriotik, ka kryer 11 hetime të vazhdueshme lidhur me Ligjin Patriotik dhe ka mbyllur 4 hetime, 3 prej të cilave i diskutuam në raportin tone të mëparshëm gjashtëmujor në Kongres”.*

⁸⁴*I would like to salute both you and Attorney General Gonzales. I think that there has been a change in attitude that has been particularly marked in the hearings that we’ve had on this. You help your cause by coming up here and answering questions in the way that you did, and the way that your boss did a couple of months ago. And I hope that continues”.*

⁸⁵The detainees’ ability to obtain legal counsel;

The government’s timing for issuance of criminal or administrative charges; and

The general conditions of detention experienced by the detainees, including allegations of physical and verbal abuse, restrictions on visitations, medical care, duration of detention, confinement policies, and housing conditions.

⁸⁶*“The OIG investigation has identified the correctional officers allegedly involved in the abuse. In addition, the OIG has interviewed the alleged victims and is reviewing their medical records”.*

Mes rasteve të reja, kujtohet edhe ai i një funksionari i cili mbante një pistoletë të mbushur mbi kokën e një të dënuari të huaj, i cili kërcënohet⁸⁷.

Relacioni i tretë i OIG, i cili mban datën 13 qershor 2003, përshkruan 6 investigime të reja mbi Patriot Act-in, tetë raste investigimesh në vazhdim dhe tri investigime të përfunduara. Rasti i parë lidhet me akuzat e njëzet të dënuarve, të cilët denonconin një zyrtar që kishte shfaqur një sjellje ofenduese ndaj të dënuarve të fesë islamike. Bureau of Prisons i dha dëshminë e saj OIG me një deklaratë që konfirmon akuzat e ngritura nga të dënuarit. Një tjetër investigim lidhet me kërkesat e dëmshperblimit të një shtetasi egjiptian i arrestuar padrejtesisht nga FBI pas 11 Shtatorit 2001. Ky shtetas i është nënshtruar kontrollit fizik tepër invaziv dhe i është mohuar e drejta e ushtrimit të fesë së tij. Në shtetin më demokratik, aty ku liria është një DUHET, ky mohim i të drejtave të personit, mes këtyre të drejtave edhe ajo e ushtrimit të fesë, nuk është i lejueshem.

FBI e detyroi shtetasin egjiptian të konsumojë ushqim të ndaluar nga feja islamike dhe i mohoi të drejten e aksesin në Konsullatën Egjiptiane.

Në këtë periudhë, anëtarët e Kongresit duhej t'u përgjigjeshin relacioneve të OIG. Një përfaqësues i Kongresit pyeti Ministrin e Drejtësisë, Xhon Ashkroft: *“Raporti IG mbi të burgosurit e 9/11; A besoni ju se ky raport sugjeron se krimet mund të jenë kryer nga zyrtarët e Qeverisë, duke përfshirë mungesën e drejtësisë, sulmet kriminale dhe mohimin e qëllimshëm të të drejtave civile dhe, nëse po, a do të caktoni një prokuror të posaçëm, ose këshilltar të veçantë?”*.⁸⁸

Ashkrofti iu përgjigj: *“Ne jemi të vetëdijshëm për 18 rastet të cilat janë të dyshuara të jenë raste të abuzimit... Unë nuk kam asnjë plan në këtë kohë për të punësuar një këshilltar të veçantë në këtë çështje”*.

Përfaqësuesi Houard Berman këmbënguli mbi problemin dhe deklaroi:

⁸⁷ Report to Congress on implementation of Section 1001 of the USA Patriot Act, January 22, 2003, faqe 5.

⁸⁸ “The IG report on the 9/11 detainees, do you agree that that report suggests that crimes may have been committed by Government officials, including obstruction of justice, criminal assaults and antentional denial of civil rights and, if so, are you going to appoint a special prosecutor, or special counsel?”.

“Ajo që më shqetëson, kur Inspektori i Përgjithshëm jep një listë të dështimeve institucionale në DD, të cilat janë të zgjatura e pa akuza; një politikë që njihet si ndalim derisa të krijohet ajo që të çon në paraburgimin mesatar prej 80 ditë, por ndonjëherë deri në 200 ditë, një "politikë e pengimit të mundësisë së këshillimit; dhe një politikë e pashkruar e mohimit të lidhjes për të gjithë të huajt, jo një politike të kufizuar për terroristët e dyshuar....”.

*“Zëdhënësi i Departamentit të Drejtësisë thotë, në një deklaratë mjaft mbrojtëse: “Raporti i Inspektorit të Përgjithshëm është plotësisht në përputhje me atë që gjykatat kanë vendosur gjithmonë, dhe veprimet tona janë plotësisht brenda ligjit dhe të nevojshme për të mbrojtur popullin amerikan. Ne nuk kërkojmë asnjë ndjesë për gjetjen e ndonjë mënyre të mundshme ligjore për të mbrojtur popullin amerikan nga akte të mëtejshme terroriste. Këtë lloj përgjigjeje e shoh shqetësuese”.*⁸⁹

Relacioni i pestë i OIG, në qershorin e vitit 2004, dokumenton hetimin e bërë gjerësisht publik ndaj Brandon Mejfilldit, shenjat e gishtave të të cilit janë identifikuar me falsifikim nga ana e FBI-së në një çantë me material eksploziv. Mbi bazën e shenjave të gishtave, qeveria burgosi Mejfilldin, duke u bazuar te një dëshmi për një atentat të ndodhur në Spanjë. FBI, më vonë, zbuloi se shenjat mbi çante nuk ishin të Mejfilldit dhe ai në atë moment u lirua. Mejfilldi më tej pohoi se FBI kishte drejtuar në mënyre të gabuar një kërkim mbi analizën e shenjave të gishtave, duke e bazuar analizën ekskluzivisht në fenë islamike.

OIG i zhvilloi hetimet mbi Mejfilldin nga fillimi i vitit 2006, kur arriti ne konkluzionin se feja e tij *“nuk ishte shkak i vetëm ose kryesor i keqidentifikimit të shenjave të gishtërinjve të tij”.*⁹⁰Më pas shtoi: *Megjithatë, ne besojmë se përfaqësimi i Mejfilldit si një terrorist i bindur dhe fakte të tjera të dala gjatë hetimeve në terren, duke përfshirë edhe fenë e tij myslimane, gjithashtu, me shumë gjasa, kontribuojnë në dështimin e*

⁸⁹“The Department of Justice spokesman says, in quite a defensive articulation, ‘ The Inspector General report is fully consistent with what courts have ruled over and over, that our actions are fully within the law and necessary to protect the American people. We make no apologies for finding every legal way possible to protect American public from further terrorist acts ‘. I find that kind of response troubling”.

⁹⁰“ was not the sole or primary cause of its misidentification of his fingerprints ”.

ekzaminimit për të rikonsideruar identifikimin, pasi u ngritën pyetje legjitime në lidhje me të nga policia spanjolle”.

Relacioni i OIG në vitin 2006 konkludoi se aftësia e FBI-së, bazuar në Patriot Act-in, për shpërndarjen e informacioneve të mbledhura nga funksionarët e policisë, ka dhënë një kontribut në çështjen “Mejfilld”, por është vërejtur edhe konflikti i turpshëm mes OIG dhe DOJ. Relacioni ka pohuar:

“OIG fillimisht kishte për qëllim që të hetonte të gjithë çështjen “Mejfilld”, duke përfshirë sjelljen e avokateve të DD që punojnë me FBI-në... Megjithatë, DD ZPP (Zyra e Përgjegjësisë Profesionale) nuk u pajtua. Ajo kundërshtoi avokatët tanë në rastin e Mejfilldit, dhe mbroi juridiksionin mbi gjithë këtë çështje...”⁹¹

“Ajo gjithashtu nuk u pajtua me qëndrimin tonë se neni 1001 na jep autoritetin për të shqyrtuar sjelljen e avokatëve. Përfundimisht, zëvendësprokurori i përgjithshëm e zgjidhi çështjen duke vendosur që... ZPP (Zyra e Përgjegjësisë Profesionale) duhet të hetojë sjelljen e agjentëve të FBI-së lidhur me rastin Mejfilld. Si rezultat i hetimeve të saj, DD ZPP (Zyra e Përgjegjësisë Profesionale) arriti në përfundimin se avokatët e DD-së të caktuar për çështjen “Mejfilld” nuk kanë kryer sjellje të pahijshme...”⁹²

Qeveria e Shteteve të Bashkuara kishte akorduar t'i paguante dy milione dollarë Mejfilldit dhe familjes së tij, duke kërkuar falje për vuajtjet e shkaktuara atij dhe familjes së tij dhe e shtyu Mejfilldin të ndiqte rrugët gjyqësore.

Mbështetësit më të mëdhenj të Patriot Act-it vunë re se situata e urgjencës pas ngjarjeve të 11 Shtatorit 2001 ushtronte presione, derisa Kongresi mund të miratonte një ligj antiterrorizëm në një kohë tepër të shkurtër.

⁹¹" The OIG initially had intended to investigate the entire Mayfield matter, including the conduct of the DOJ attorneys working with the FBI....However, DOJ OPR (Office of Professional Responsibility) disagreed. It contested our attorneys in the Mayfield case, and asserted jurisdiction over the entire matter...."

⁹²It also disagreed with our position that Section 1001 provides us the authority to review the conduct of attorneys. Eventually the Deputy Attorney General resolved the matter by ruling that....the OPR should investigate the conduct of FBI agents in the Mayfield case. As a result of its investigations, DOJ OPR concluded that the DOJ attorneys assigned to the Mayfield matter did not commit misconduct."

Në qershor të vitit 2003, senatorët Lisa Murkoeski dhe Ron Uajden prezantuan Protecting the Rights of Individuals Act, një ligj bipartizan që:

- Kufizon autoritetin e qeverisë për operacionin sekret "vjedhje dhe përgjim", duke kërkuar që ato të kryhen vetëm si hetim i terrorizmit dhe vetëm kur zbulohet se kërkimi rrezikon jetën ose sigurinë e një individi.
- Kufizon përkufizimin e "terrorizmit të brendshëm".
- Kufizon qasjen e të dhënave të biznesit, duke përfshirë edhe të dhënat e bibliotekave dhe librave, sipas nenit 215.
- Kufizon aftësinë e FBI-së për të përdorur regjistrimet.
- Rrit shqyrtimin gjyqësor për telefoninë dhe monitorimin e internetit.
- Kërkon aprovimin paraprak për përzgjedhjen e për "të dhënat e minierave".
- Kërkon zbulimin publik të informacionit bazë në lidhje me hetimet sekrete të inteligjencës së FBI-së.
- Aplikon procedurat tradicionale të zbulimit të provave të përdorura në proceset gjyqësore.
- Ngritja e standardit të rishikimit për kapjen e të dhënave arsimore

Me siguri, amendamenti më ambicioz i propozuar në vitin 2003 ishte Benjamin Franklin True Patriot Act, i miratuar më 24 shtator 2003. Amendamenti do të shfuqizonte njëmbëdhjetë seksione të ndryshme të Patriot Act-it, dy dispozita të Homeland Security Act-it dhe një sërë legjislacionesh federale pas 11 Shtatorit. Parashikimet më të rëndësishme të tekstit janë:

- Shfuqizimi i kërkimeve bibliotekare, mjekësore dhe të dhënat financiare pa urdhër gjyqësor.
- Shfuqizimi i arrestimeve apo deportimeve të shtetasve që nuk kanë pasur një gjykim të kujdesshëm.
- Vendosja e një ligji themelor për avokatët dhe klientët e privilegjuar.
- Rishikimi i transparencës së procedurave se DOJ dhe Departamentit të Sigurisë Kombëtare për revokimin e urdhrave sekrete dhe zgjerimit nga Federal Advisory Committee Act.

Një përfaqësues, Xhim MekDermot, u shpreh:

*"Patriot Akti Benjamin Franklin kërkon shfuqizimin e dispozitave antikushtetuese të Patriot Act-it dhe për të mbrojtur Kushtetuten... Unë jam krenar të kem një sponsor të përbashkët për këtë projektligj dhe do të vazhdoj të kundërshtoj përpjekjet e administratës së Bushit për të vjedhur liritë tona civile. Kongresi nuk duhet të ulet, ndërsa administrata përdor frikën dhe kërcënimin e terrorizmit për të shkelur liritë tona të garantuara nga Kushtetuta."*⁹³

Përfaqësuesi Pete Stark tha:

*"Prokurori i Përgjithshëm Ashcroft ka përdorur Patriot Act-in për t'u angazhuar në një sulm jashtë lirive themelore civile. Ai është tallur me procesin e rregullt, ka shkelur mbrojtjen themelore të privatësisë dhe i ka autorizuar agjentët federalë për të spiunuar nën sigurinë e fshehtësisë absolute... Duke ristudiuar dispozitat më të këqija të Patriot Act-it, ai do të mbretërojë në këtë abuzim total të pushtetit dhe do të rivendosë të gjitha të drejtat tona kushtetuese themelore.."*⁹⁴

Më 22 tetor, Butch Otter miratoi Security Ensured (SAFE) Act në Dhome pastaj në Senat. SAFE Act do të ishte:

- Kufizimi i autoritetit të qeverisë për sekretet e rëndësishme në lidhje me situatat ku informimi i subjekteve mund të dëmtojë jetën apo sigurinë e një individi dhe që shkatërron evidencat.
- Kufizimi i pushtetit të FBI-së për të përdorur regjistrimet.
- Kufizimi i aksesit në biblioteka, librashitës ose në biznese të tjera të ngjashme.
- Parandalimi i FBI-së për përdorimin e National Security Letters për të marrë regjistrime të ndryshme nga memoria e kompiuterave.

⁹³ Congressman Jin McDermott cosponsors the Benjamin Franklin True Patriot Act, September 29, 2003.

⁹⁴ Representative Pete Stark, press release, September 24, 2003.

- Shfuqizimi i Section 213, furnizimi i “sneak and peek”, dhe furnizime të tjera që zgjerojnë aftesinë e FBI-së të marrë regjistrime pa një urdhër gjykate.
- Ngushtimi i përkufizimit tepër të gjerë të "terrorizmit të brendshëm" të krimeve të rënda federale, si për shembull bombardimet dhe rrëmbimet.

Në vitin 2005 pati disa zhvillime mbi Patriot Act-in, i cili u konfirmua sërish.

Në lidhje me këtë temë, Senatori Patrik Leahy mbajti pozicionin e tij:

*"Sapo u bë e qartë se raporti i konferencës së paraqitur nga udhëheqja republikane do të ishte i papranueshëm për Senatin, unë u bashkova të enjten, 8 dhjetor, duke bërë thirrje për një zgjatje 3-mujore për të punuar më mirë për ligjin. Në ditën e parë, Senati trajtoi një tjetër argument në seancë... senatori Sununu dhe unë prezantuan projekt-ligjin... Kjo gjë do ta kishte zgjatur Patriot Act-in deri më 31 mars 2006, për të na lejuar një shans më tepër për të punuar për të qartësuar dallimet e mbetura dhe për të përmirësuar riautorizimet në legjislacion për të mbrojtur më mirë të drejtat e amerikanëve të zakonshëm... Në kundërshtim me kërkesat dhe keqinterpretimet nga ana e disave, nuk kishte asnjë përpjekje nga të dyja anët për t'u larguar nga Patriot Act-i... Nuk ka asnjë arsye se pse populli amerikan të mos e ketë Patriot Act-in, që është efektiv dhe adekuat, i cili mbron të drejtat dhe privatësinë e tyre. Të vetmit njerëz të cilët ishin të kërcënuar nga miratimi i Patriot Act-it ishin Presidenti dhe republikanët... Ata e njohën aktin në ditët që pasuan. Por tani, ndërsa i afrohem miratimit të aktit këtë të premte, liderët republikanë nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim të mtejshëm dhe ne rrezikojmë të mos i miratojmë dhe kjo gjë rrezikon skadencën e afateve."*⁹⁵

Maksin Uotërs kritikonte Section 215, duke konkluduar: *"Qytetarët amerikanë kanë të drejtë të njoftohen nëse ata janë nën mbikëqyrje dhe neni 215 pengon këtë të drejtë, duke lejuar qeverinë të kryejë hetime të pakontrolluara"*.⁹⁶

Deputeti Xhejms Komei iu përgjigj:

⁹⁵ Congressional record-senate, January 31, 2006, pp. S363.

⁹⁶ Hearing before the Committee on the Judiciary, House of Representatives, 109th Congress, 1st session, June 8, 2005, p. 3.

"Seksioni 215 është kritikuar nga disa, sepse ai nuk përjashton bibliotekat dhe shitësit e librave. Mungesa e një përjashtimi të tillë është në përputhje me praktikën penale hetimore. Prokurorët kanë qenë gjithmonë në gjendje për t'i marrë të dhënat nga bibliotekat dhe libraritë përmes fletëthirrjeve nga ana e gjykatave. Bibliotekat dhe shitësit e librave nuk duhet të bëhen strehë e sigurt e terroristëve dhe spiunëve... Lidhur me nenin 215, ai lejon qeverisë për të piketuar amerikanët në bazë të librave që ata lexojnë apo faqet e internetit që ata vizitojnë. Dispozita, në mënyrë eksplicite, e ndalon qeverinë të kryejë një hetimi ndaj një shtetasi të SHBA-ve të bazuar vetëm në mbrojtjen e veprimtarisë së Amendamentit të Parë".

Por Komei nuk e specifikoi se të ndalosh investigimet e bazuara vetëm mbi veprimtaritë që gëzojnë mbrojtjen e Amendamentit të Parë nuk është prekluzive për mundësinë e kryerjes së hetimeve që pjesërisht i referohen Amendamentit të Parë.

"Departamenti është shumë i shqetësuar për propozimet aktualisht në pritje para Kongresit, që do t'i kërkonin qeverisë të tregonte "fakte të veçanta dhe të artikulueshme", duke qenë se të dhënat kërkojnë përmes një urdhri të seksionit 15, të cilat i përkasin një fuqie të huaj apo agjentit të një fuqie të huaj. Një kërkesë e tillë do të çaktivizonte qeverinë nga përdorimi i një urdhëri sipas seksionit 215 në fazat e hershme të një hetimi, i cili verifikohet pikërisht kur një urdhër i tillë është më i dobishëm".

Don Lundgren nuk ishte i bindur: *"Ju thoni, se nëse ne përjashtojmë ose ndryshojmë seksionin 215 në krahasim me bibliotekat..., ky është fundi i botës. Fundi do të jetë për ne. Terroristët do t'i bëjnë bibliotekat streha të sigurta. Dhe unë mendoj se jam skeptik... Njerëzit kanë frikë se të drejtat e tyre të lexuara janë duke u zbehur sot në fakt.... Pse të mos kërkojnë personalisht që informacionet personale të identifikueshme të përjashtohen nga seksioni 215?"*.

Komei nuk e pranoi faktin që çdo modifikim i Section 215 ishte i nevojshëm. *"Diçka është thyer..., por unë mendoj se nga ana e njerëzve duhet kuptuar seksioni 215... Unë jam duke shkuar në punë, duke qenë se nuk kam më shumë frymë që të përpiqem ta rregulloj atë, në vend që të ndryshojë seksioni 215 vetëm për shkak se njerëzit nuk e kuptojnë atë ".*

Përfaqësuesi republikan Xherard Nadler deklaroi:

"Seksioni 215 duhet të ndryshohet për të siguruar mbrojtje kuptimplote nga abuzimi nga një qeveri që kërkon dokumentacion të ndjeshëm dhe personal. Ne duhet të zëvendësojmë shfaqjen e thjeshtë ose standardin rilevues me një provë tripjesëshe, që ishte baza e kompromisit të Senatit. Përfituesit e 215 urdhrave dhe të nenit 505 të letrave të sigurisë kombëtare duhet të lejohen për një sfidë kuptimplote gjyqësore ndaj rendit, dhe autoriteti për letren e sigurisë kombëtare duhet garantojë mbikëqyrjen e Kongresit".

Siç e nisa studimin tim në fillim të kapitullit, Patriot Act-i është një ligj federal i Shteteve të Bashkuara të Amerikës i miratuar nga Kongresi më 26 tetor 2001, me qëllimin e vetëm për t'i bërë balle terrorizmit nëpërmjet fuqizimit të instrumenteve investiguese dhe të kontrollit dhe forcimit të masave të sigurisë së brendshme. Është e lehtë të imagjinohet se si ky ligj prek sferën e lirive personale dhe të drejtave civile. Në këtë mënyrë survejimi i rritur mbi telekomunikacionet dhe komunikimet telematike, përdorimi i teknologjive të avancuara për identifikimin dhe ruajtjen e informacioneve (nga kartelat klinike deri tek te dhënat bankare), marrja e shenjave të gishtave në biblioteka, deri në mundësinë e kryerjes së kontrolleve në banesa pa një mandat të posaçëm kontrolli (të nevojshëm dhe të parashikuar nga ligji).

E gjithë kjo në emër të sigurisë kombëtare. Më e vështirë është jetesë e të huajve. Patriot Act-it i jep Prokurorit të Përgjithshëm të drejtën e burgosjes së një të huaji të klasifikuar si terrorist i dyshimtë, i cili mund të mbahet i burgosur mbi bazën e ekzistencës së vetme të dyshimeve të logjikshme mbi një pjesëmarrje në veprimtari të cilat vënë në rrezik sigurinë kombëtare të Shteteve të Bashkuara, ose ta dëbojnë si një terrorist të dyshuar për terrorizëm, sabotim apo spiunim. Si rrjedhojë, të gjithë individët e dyshuar si "suspected terrorists" janë subjekt arrestimi me afat të pacaktuar. Siç e ilustrua gjerësisht, Patriot Act-i kishte parashikuar që disa instrumente të jashtëzakonshme në dispozicion të forcave të policisë dhe të inteligjencës të përdreshin deri më 31 dhjetor 2005, më pas do të kishte rishikim të dispozitave relative të ligjit. Por u arrit në një normalizim të emergjencës. Ky vendim është firmosur nga Presidenti Bush më 9 mars 2006 dhe vetëm lehtësoi disa kufizime. Nëse është e vërtetë që 11 Shtatori

2001 ka përfaqësuar një faktor destabilizues të rëndë të rendit demokratik dhe të ndërgjegjes së amerikanëve, duhet të pyesim veten nëse sakrifica e detyruar nga Patriot Act-i i vlerave dhe parimeve që e kanë bërë Amerikën simbolin e lirisë është në gjendje t'u kthejë amerikanëve qetësinë e nevojshme për të vazhduar lumturinë solemne, atë të përmendur në Kushtetutën e vitit 1776.

Kapitulli III: GARANCITË KUSHTETUESE NË AMERIKËN LATINE

Studimi i garancive kushtetuese është i një rëndësie thelbësore në vendet e Amerikës Latine. Në kartat kushtetuese të pjeses më të madhe të shteteve, deklaratat solemne të të drejtave kushtetuese dhe bekimi i tyre si të drejta të gjeneratës së parë dhe të fundit, kanë një vlerë formale, që vetëm garancitë kushtetuese janë në gjendje t'i transformojnë në reale. Pra, të gjitha të drejtat e

përmendura nga kartat kombëtare dhe ndërkombëtare, nëse nuk mbështeten nga garancitë kushtetuese me instrumente procesuale të nevojshme për mbrojtjen e tyre, nuk janë gjë tjetër veçse dëshira politike të thjeshta. Nuk kanë asnjë bazë në realitet.

Sistemi i drejtësisë kushtetuese në pjesën më të madhe të vendeve latino-amerikane (eksperiencat e Argjentinës, Brazilit, Kosta Rikës, Kolumbisë, Venezuelës, Perusë), parashikon rekurse dhe gjykime të *habeas corpus*, *amparo* dhe *habeas data*, për të gjithë individët të cilëve u është cenuar një e drejtë.

Po kështu, njhet edhe e drejta e shtetasve të bëjnë rekurs të drejtpërdrejtë në Gjykatën Kushtetuese kundër antikushtetueshmërisë totale apo parciale të ligjeve ose të akteve normative, të cilat janë dukshëm në kundërshtim me kushtetutën. Mund të pohojmë se sistemi latino-amerikan i drejtësisë dhe i garancive kushtetuese është zhvilluar dhe pasuruar⁹⁷ që nga vitet e para të pavarësisë së shteteve të reja, duke filluar nga krijimi i *habeas corpus*, *amparo* dhe aksionit publik të antikushtetueshmërisë. Sot ky sistem përfaqëson një konsakrim kushtetues të disa garancive dhe të drejtave të tjera të rëndësishme. Mes tyre mund të përmendim mbrojtjen e të dhenave, të informacioneve dhe të intimitetit personal dhe familjar. *Habeas corpus* në Amerikën Latine e ka zanafillën nga modelet spanjolle të *fuero*-s. Aktualisht, kjo garanci është e konsakruar në të gjitha kushtetutat e shteteve latino-amerikane, si një institut për mbrojtjen e lirisë personale.

⁹⁷ D. Garcia Belaunde, "De la jurisdicción al derecho procesual constitucional", Ed. Grijley, Lima, 2003.

Për sa i përket *amparo*-s ose mbrojtjes juridiksionale të të drejtave, mund të pohojmë se kjo e fundit është një institucion i përbashkët i pjesës më të madhe të shteteve latino-amerikane. *Amparo*-ja në Kontinentin Amerikan, ndryshe nga Europa, paraqet një karakter procesual kushtetues, sepse rezulton të jetë një proces i vërtetë alternativ në lidhje me atë të zakonshëm. Për këtë arsye, mund të nisim pa qenë nevoja të pritët konkluzioni i proceseve eventuale në vazhdim për të arritur mbrojtjen e së drejtës thelbësore ose kushtetuese të cënuar apo të shkelur.⁹⁸

Garancia tjetër kushtetuese përfaqësohet nga mbrojtja e një të drejte të gjeneratës së fundit, *habeas data*⁹⁹.

Habeas data, si garanci kushtetuese e të drejtave dhe lirive të informacionit, të mbrojtjes së nderit, të emrit, të intimitetit personal dhe familjar, është adoptuar nga pjesa më e madhe e shteteve latino-amerikane.¹⁰⁰

Në këtë kuptim, garancia e *habeas data* mbron një nga të drejtat kushtetuese të gjeneratës së fundit që legjislacionet përpunohen si mbrojtëse përballë një zhvillimi teknologjik, i cili vë në rrezik të drejtën e intimitetit, të ashtuquajturën *right to be alone*.¹⁰¹

3.1 Konstitucionalizmi në vendet andine (Venezuelë, Kolumbi, Ekuador, Peru dhe Bolivi)

Kjo pjesë e studimit mbi të drejtën publike dhe konstitucionalizmin e Amerikës Latine fillon me një paraqitje të shkurtër të zhvillimeve politike dhe konstitucionalizmin në fuqi të secilit nga vendet e Komunitetit Andin të shteteve, i cili përfshin faktet politike dhe juridike thelbësore që kanë shënuar historinë e çdo vendi andin dhe një studim të përgjithshëm të kartave kushtetuese të tyre sot në fuqi. Renditja e ndjekur për

⁹⁸ Osasuna Patino, N. I. (1998). "*Tutela y amparo, estudio comparato*", Uniexternado, Bogotá, fq 24-34.

⁹⁹ Ashtu si garancia kushtetuese e *habeas corpus*-it, domethënë liria personale, sistemet latino-amerikane kanë konsakruar në mënyrë progresive garancinë e së drejtës së *privacy*-së, *habeas data*.

¹⁰⁰ E. Rozo Acuna, (2002). "*Habeas data costituzionale: nuova garanzia costituzionale del diritto pubblico latinoamericano*", IV, 1921 ss.

¹⁰¹ E drejta për të qëndruar vetëm.

prezantimin e studimit të vendeve korrespondon me shpalljen e kushtetutave në fuqi: Kolumbi (1991); Peru (1993); Venezuelë (1999)¹⁰²; Ekuador (2008) dhe Bolivi (2009). Studimi mbyllet me një analizë krahasimore të karakteristikave kryesore dhe tendencave të konstitucionalizmit andin sot në fuqi dhe, më saktësisht, merren në konsideratë tematikat e parimeve dhe deklaratave të përgjithshme; marrëdhëniet shtet-kishë, të drejtat dhe detyrimet, garancitë dhe garantimi i të drejtave; gjendjet e jashtëzakonshme; organizimi administrativ dhe autonomia politiko-territoriale; institucionet dhe organet shtetërore, marrëdhëniet ekzistuese mes pushtetit dhe funksioneve ekzekutive dhe legislative, institucionet e reja, funksionet dhe organet e shtetit, studimin normativo-kushtetues të konflikteve të interesit dhe përgjegjshmërinë e konflikteve të interesit; normat elektorale dhe krijimin e drejtësisë elektorale; partitë politike, kushtetutën ekonomike; universalitetin dhe kulturën; rolin institucional të forcave të armatosura; supremacinë dhe mbrojtjen e kushtetutës dhe shtetin e së drejtës.

3.2 Zhvillimi politik dhe kushtetues i Kolumbisë

Kolumbia, ose Nueva Granada antike e epokës koloniale spanjolle, pas pavarësisë (1810-1819), ka adoptuar formën e qeverisjes presidenciale me formën e shtetit unitar dhe republikan. Që nga ajo epokë, Kolumbia ka pasur kushtetuta të ndryshme, e fundit ajo e vitit 1886, në fuqi deri në vitin 1991.¹⁰³

Kushtetutat kolumbiane, ndryshe nga ato argjentinase të vitit 1994, nuk kanë dashur të marrin kushtetutën e vjetër prej më shumë se një shekulli jete, duke preferuar përpunimin e një kushtetute tërësisht të re.

Në fakt, në vitin 1990, nëpërmjet një referendumi, populli kolumbian vendosi reformën kushtetuese, duke mbizotëruar mbi Parlamentin (Kongresin), me anë të zgjedhjes së një

¹⁰² Republika Bolivariene e Venezuelës u bë pjesë e Paktit Andin, sot Komuniteti Andin i Shteteve (CAN), më 1973. Megjithatë, me dëshirën e Presidentit Çavez në ushtrimin e politikës së tij të jashtme anti-SHBA, u tërhoq nga Komuniteti në mënyrë efektive më 2006, në shenjë proteste kundër Traktateve të Tregtisë së Lirë, që Kolumbia dhe Peruja duhet të firmosnin në atë epokë me Shtetet e Bashkuara. Sidoqoftë, gjeografikisht Venezuela është dhe do të jetë gjithnjë pjesë e zonës andine të Amerikës së Jugut dhe është për këtë arsye që studimi i saj kushtetues përfshihet mes vendeve të kësaj zone.

¹⁰³ E. Rozo Acuna, (1982). *El Sistema Constitucional Colombiano*, Bogotá, fq 40.

Asambleje Kushtetuese. U arrit kjo procedurë apo reformë, jo duke respektuar kushtetutën, pasi neni 218 i kushtetutës së vjetër parashikonte që vetëm Kongresi mund ta reformonte (rishikonte) atë. Duke konsideruar se kongresi, gjatë viteve të fundit të dy dhjetëvjeçarëve, nuk kishte qenë në gjendje, ose nuk kishte arritur të realizonte reformën e shumëdëshiruar, fenomen ky i përbashkët në shumë vende, presidenti i atëhershëm, Enrike Gaviria, vendosi të ngrinte një Këshill Popullor me objekt reformën kushtetuese me rrugë anti-kushtetuese, domethënë nëpërmjet një asambleje kushtetuese me 74 anëtarë, të zgjedhur nga populli në mënyrë demokratike dhe të drejtpërdrejtë. Populli kolumbian iu përgjigj pozitivisht këtij këshilli, por kolumbianët nuk proceduan vetëm me reformën por, madje, krijuan një kushtetute të re.¹⁰⁴

Për të kaluar në studimin e garancive kushtetuese, është i rëndësishëm një *excursus* historik i kushtetueshmërisë kolumbiane.

Historia kushtetuese kolumbiane mund të përmblihet në katër periudha të ndryshme: 1. Periudha pas-pavarësisë (1810 - 1815); 2. periudha e shtetit unitar të centralizuar, "bolivarian" dhe neogranadin (1819 - 1853); 3. periudha e federalizmit (1853 - 1886); 4. nga periudha e shtetit unitar të centralizuar tek ajo e shtetit të decentralizuar (nga viti 1886 deri në ditët e sotme).

Periudha fill pas pavarësisë (1810 - 1815) karakterizohet mbi të gjitha nga fakti se të gjitha tipologjitë e grupeve creoli ¹⁰⁵ dëshirojnë shtetin e tyre. Kjo situatë manifestohet në faktin se çdo provincë e Nueva Granada-s (që më pas do të quhet Kolumbi) do të konsiderohet e pavarur nga Spanja dhe do të pajiset me kushtetuten e saj.¹⁰⁶

Në këtë kuptim, nuk do të ketë një kushtetutë të vetme, por disa kushtetuta me karakteristikën e përbashkët të faktit se janë liberale, në kuptimin e ndarjes së pushteteve, të të drejtave të njeriut dhe të qytetarit, të pavarësisë së gjyqtarëve dhe të origjinës popullore të autoritetit dhe qeverisësve. Disa nga këto kushtetuta, si për shembull ajo e Tunja-s (1811), Cartagena (1811), Cundinamarca (1812), Antioquia

¹⁰⁴ Lleras de la Fuente C, (1992). *Interpretación y génesis de la Constitución de Colombia*, Bogotá, fq 22-45.

¹⁰⁵ Fëmijet e spanjollëve të lindur në kolonitë amerikane.

¹⁰⁶ Uribe Vargas D, (1977). *Las Constituciones de Colombia*, Madrid, I. fq 29-58.

(1812) dhe Mariquita (1815) janë të stampës rusojane, domethënë afirmonin sovranitetin popullor, kontratën sociale dhe të drejtat e njeriut në shoqëri.¹⁰⁷ Por, me gjithë influencën franceze dhe amerikano-veriore, të gjitha provincat e Nuova Granada-s, tashmë të deklaruara "shtete", manifestohen si sisteme me besim katolik.¹⁰⁸ Mungesa e bashkimit të këtyre provincave, si dhe mungesa e suksesit në tentativën për integrim, që do t'i kishte dhënë jetë Konfederatës së Provincave të Nuova Granada-s, lehtësoi pushtimin e ri spanjoll dhe vendosjen e dominimit kolonial, edhe pse për një kohë të shkurtër (1815 - 1819).

Në fakt, me mposhtjen e Napoleonit, Spanja vendos monarkinë e saj dhe rifiton kolonitë amerikane deri më 1819, vit në të cilin ushtritë e Bolivarit mundin Morilon dhe i rikthejnë sërish pavarësinë Nuova Granada-s: në këtë mënyrë nis periudha e dytë e zhvillimit kushtetues të Kolumbisë.¹⁰⁹

Pjesa e parë e kësaj periudhe mund të konsiderohet "bolivariane" për rolin aq të rëndësishëm që zinte "Liberatori" Simon Bolivar në organizimin politik të vendeve që sot përbëjnë Venezuelën, Kolumbinë, Ekuadorin, Bolivinë dhe Perunë. Nga 1890 deri më 1830, Bolivari jo vetëm që luftoi për pavarësinë e këtyre vendeve, por luftoi edhe për ndërtimin e shteteve të tyre kombëtare si dhe për integrimin e këtyre të fundit në një shtet të vetëm: Kolumbia e Madhe.¹¹⁰

Në fakt, nga Kongresi i Angosturës (1819) deri në Kushtetuten e Kikutës të vitit 1821, Bolivari përgatiti projekte të ndryshme kushtetuese për të krijuar një shtet të madh kombëtar me të gjitha territoret e pavarura nga Spanja, me modele organizimi politik që Bolivari i kishte marrë si shembull nga romakët republikanë, nga Rusoi dhe nga liberalizmi anglez.¹¹¹

¹⁰⁷ Botero F, (1964). *Las Constituciones comparadas*, Medellin, Bogotá, fq 22-26.

¹⁰⁸ Vásquez A. (1974). *El Concordato del Colombia con la Santa Sede*, Bogotá, fq 111.

¹⁰⁹ Ocampo Londono J, (1982). *Proceso Politico, military social de la independencia*, in Manual de Historia de Colombia, Bogotá, , II, faqe 17 e vijuese.

¹¹⁰ Rozo Acuna E, (1982). *Bolívar: Pensamiento constitucional*, Bogotá, fq 86.

¹¹¹ Rozo Acuna E, (1988). *Bolívar: la Organización de los poderes publicos*, Bogotá, fq 26-89.

Deri në momentin që Bolivari ishte lider, domethene deri në vdekjen e tij të parakohshme¹¹², këto tentativa patën njëfarë suksesi; me vdekjen e tij ato nuk u ndoqën dhe as u aplikuan nga kreolët, të cilët moren pushtetin vetëm për të kryer interesat e tyre feudale, fenomen ky i pranishëm edhe sot në pjesën më të madhe të Amerikës Latine¹¹³. Pra, viti 1819 deri në vitin 1830 ka pasur gjithsej tri kushtetuta me influencën e ideve të Bolivarit: ato të Agosturës (1819), Kukutës (1821) dhe Bogotës (1830). Vetëm dy të parat janë zbatuar në territoret që në atë kohë formonin Kolumbinë e Madhe. E fundit nuk hyri kurrë në fuqi, dhe në të njëjtën kohë, Kolumbia e Madhe u shpërbë me ndarjen e Venezuelës dhe Ekuadorit. Këto kushtetuta ishin liberale, në kuptimin e shtetit demokratik të së drejtës dhe preferonin formën republikane unitare dhe të centralizuar në lidhje me atë feudale¹¹⁴.

Pas shkrirjes së Kolumbisë së Madhe miratohet në vitin 1831 Ligji Themeltar i Shtetit të Nuova Granada-s dhe në vitin 1832 Kushtetuta e Shtetit të Nuova Granada-s, që përfaqëson Kushtetutën e parë kolumbiane, pasi, pas pavarësisë, në vitin 1810, nuk janë shënuar kushtetuta kombëtare, por provinciale¹¹⁵ dhe nga viti 1819 deri në vitin 1830, me Bolivarin, kushtetutat ishin vetëm rajonale (për Kolumbinë e Madhe), duke përfshirë edhe Venezuelën, Perunë dhe Ekuadorin.

Kushtetuta e Republikës së Nuova Granada-s mbeti në fuqi deri në vitin 1843, vit në të cilin u miratua kushtetuta e Republikës së Nuova Granada-s, e cila do të zgjaste deri në vitin 1853. Këto dy kushtetuta mund të konsiderohen të tipit unitar të centralizuar, edhe pse provincave iu dha njëfarë pushteti politik autonom, mbi të gjitha për sa i përket zgjedhjes së organit legjislativ kombëtar i cili kishte detyrën të zgjidhte Presidentin e Republikës: senatorët dhe deputetët përfaqësonin, në fakt, provincat dhe ishin pikërisht

¹¹² Në vitin 1830, në moshën 47 vjeçare.

¹¹³ Tirado Mejía A, (1982). *El Estado y la política en el siglo XIX*, in Manual de Historia de Colombia, Bogotá, , II, fq 327 e vijuese.

¹¹⁴ Rozo Acuna E, (1982). *Bolívar: Pensamiento constitucional.....cit.*, fq 77 dhe vijuese.

¹¹⁵ María Samper J, (1974). *Derecho Público Interno*, Bogotá, I. fq. 25.

ato që zgjidhnin Presidentin. Gjithashtu, pushteti i provincave përfshinte edhe zgjedhjen e magjistrateve të Gjykatës së Lartë¹¹⁶.

Forma e centralizuar e pushtetit shërbente për të tejkaluar krizën e qëndrueshme, mungesën e stabilitetit politik të provokuar nga betejat e vazhdueshme të klasave dhe anarkisë, efekti i mungesës së liderëve kombëtarë dhe i partive politike kombëtare. Edhe pse në prani të një përqendrimi politik, provincat kane pasur edhe njëfarë zhvillimi ekonomik dhe politik. Në përmbajtjen e tyre, dy kushtetutat e Nuova Granada-s janë demokratike dhe liberale dhe ndjekin nga afër modelin francez pas-jakobin¹¹⁷; pra, organizojnë shtetin dhe qeverinë në mënyrë republikane dhe përfaqësuese, edhe pse të dyja u japin jetë sistemeve me stampë katolike.

Në fundin e gjysmës së parë të shekullit të kaluar, partia e federalistëve, ose e radikalëve liberalë, u rrit në atë pikë sa fitoi zgjedhjet parlamentare të vitit 1852 dhe solli në pushtet Presidentin Murilo Toro, i cili do të hapë rrugën drejt një shteti federal¹¹⁸.

Periudha feudale (1853-1886) nis, pra, me kushtetutën e vitit 1853 dhe u lë autonomi të madhe provincave për administrimin e tyre dhe organizimin politik. Nga ana tjetër, mbi të ushtronin influencë të madhe lëvizjet franceze të vitit 1848, për këtë arsye kushtetuta rifiton dhe konfirmon teorinë e origjinës popullore të pushtetit (diskutohet për sovranitetin popullor dhe jokombëtarë) dhe harton liri të gjera publike: shteti garanton sigurinë personale, të drejtën për të mos u dënuar ose ndaluar për shkaqe që nuk lidhen me krimin, konform ligjeve; liria e shprehjes së mendimit, duke qartësuar faktin se shtypi nuk ka asnjë kufizim. Shënohet edhe liria e skllëvërve, liria fetare dhe ajo e kultit¹¹⁹.

¹¹⁶ Diego Uribe Vargas, op. cit. faqe 68.

¹¹⁷ Fernando Botero, op. cit. faqe 46.

¹¹⁸ Në fakt, neni 10 i kushtetutës së vitit 1853 zgjeron pushtetin bashkiak; nenet 42 dhe 44 vendosin zgjedhjen popullore të magjistratëve të Gjykatës së Lartë; neni 48 zgjeron mundësinë e pushteteve provinciale, të asambleve, të qeverisësve, të gjithë të zgjedhur nga populli (neni 13). Më këtë kushtetutë nis procesi i krijimit të të ashtuquajturve shtete sovranë: Panama (1855); Santander (1857); Cauca, Cundinamarca, Boyacá; Bolivar e Magdalena (1857). Nisi kështu liberalizmi radikal, që më vonë, më 1863, do të krijonte shtetin federal me Shtetet e Bashkuara të Kolumbisë.

¹¹⁹ Enrique Tascón T, (1953). *Historia del Derecho Constitucional Colombiano*, Bogotá, fq 76.

Pas kësaj kushtetute vijon ajo më e theksuar feudale e vitit 1858, që vendos pikërisht krijimin e Konfederatës Granadine. Me këtë kushtetutë u delegohet provincave, që do të quhen shtete, pushteti legjislativ në fushat civile dhe penale, si dhe mundësia për të miratuar kushtetutat e tyre: është e qartë influenca e modelit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Në fushën e të drejtave, praktikisht përsëriten ato të kushtetutës së mëparshme.

Mund të vërehet me kuriozitet se kushtetuta e vitit 1858 ishte rezultat i lëshimeve të forcave liberale, radikale ose federaliste, në një moment ku konservatorët kishin (zotëronin) mazhorancën parlamentare. Liberalët radikalë dhe konservatorët miratuan një kushtetutë federale, edhe pse ideologjia e konservatorëve ishte apo akoma është kundër federalizmit¹²⁰.

Aplikimi i kësaj kushtetute u siguroi një sukses të madh forcave liberale radikale, derisa në vitin 1863, kur tashmë ishte fituar pushteti, shfuqizuan kushtetutën, duke miratuar një të re, me federalen e historisë kolumbiane: shteti i ri do të quhet Shtetet e Bashkuara të Kolumbisë. Lideri i regjimit të ri, gjenerali Mosquera, do të jete për shumë vitë presidenti i një shteti ku provincat ose shtetet anetare kanë të gjithë pushtetin dhe shteti kombëtar praktikisht vetëm pushtetet dytësore.

Shpallet një shtet jokatolik, laik, për disa aspekte antiklerikal¹²¹. Në fushën e të drejtave individuale, Kushtetuta e vitit 1863 është e pakrahasueshme me kushtetutat e tjera kolumbiane, në kuptimin e garantizimit të saj të gjerë. Mjafton të mendohet fakti se të gjithë kishin të drejtën dhe lirinë e shkrimit apo të fjalës pa asnjë limit dhe qytetaret kishin të drejtën e armëve kundër "keqqeverisjes". Siç është e lehtë të kuptohet, Kolumbia, pas vitit 1863, hyri në një periudhë instabiliteti të madh, lufte dhe dhune politike, që shpejt sollën në një luftë civile; kjo luftë do të përfundojë në fundin e vitit 1885 me fitoren e konservatorëve, përfaqësues të klasave sociale latifondiste, armiq të federalizmit dhe lirive të pakufizuara, mbështetës të shtetit me besim katolik: këto forca politike eliminuan kushtetutën federale dhe miratuan kushtetutën unitare dhe të

¹²⁰ Autorët e cituar, Tascón, Botero dhe Samper në veprat e tyre janë të një mendjeje për afirmimin e faktit se pa mbështetjen e konservatorëve federalizmi kolumbian në atë epokë nuk do të ishte i mundur.

¹²¹ Enrique Tascón T, op. cit., fq 96 dhe vijuese.

centralizuar të vitit 1886, që edhe pse me anë të reformave të ndryshme (me stampe unitare dhe te centralizuar) mbeti në fuqi deri në vitin 1991¹²².

Periudha e katërt kushtetuese ose e shtetit unitar që i referohet kushtetutës së vitit 1886, karakterizohet nga mbizotërimi dhe dominimi i forcave politike të djathta, konservatore që, shpesh edhe në aleance me forcat e qendrës dhe ato liberale, kanë mbajtur dhe ushtruar pushtetin politik në mënyrë tradicionale, pa i hapur dyert pjesëmarrjes popullore dhe duke urdhëruar një dominim absolut si në fshatra ashtu edhe në zonat urbane.

Edhe pse në prani të disa reformave kushtetuese të vitit 1886, në veçanti duhen përmendur reformat liberale të viteve 1836 dhe 1968, që formalisht konsideroheshin në Kolumbi si fillimi i shtetit modern social të së drejtës dhe ndërhyrjes së programuar të shtetit në zhvillimin ekonomik dhe social, shoqëria dhe jeta politike kolumbiane mbetën të rrënjosura në interesin politik të klasave dominuese, me një shkallë të lartë dhune politike për mungesën absolute të modernizimit dhe për modelin e demokracisë pa popullin, ose nga lart, i cili ka mbizotëruar në njëqind vitet e fundit të historisë kolumbiane¹²³.

Është pikërisht në këtë periudhë historike që duhet hartuar kushtetuta e re kolumbiane, dhe pikërisht mbi bazën e këtyre konsideratave duhet kuptuar dëshira garantiste, pluraliste, ajo e mundësisë së një pjesëmarrjeje më të gjerë popullore, që ka qenë inspiracioni i kushtetuesve kolumbianë, duke i shtyre ata të përpunonin dhe miratonin një kushtetute të gjatë, kontradiktore, jo pa gabime, edhe gjuhësore; në çdo rast, duhet t'u njihen meritat kushtetuese për entuziazmin e madh me të cilin kanë kryer veprën e tyre dhe për vullnetin për ta aplikuar, duke prishur skemat e mëparshme, të periudhës së pestë të konstitucionalizmit kolumbian: ai i shtetit të së drejtës me pjesëmarrje demokratike, domethënë të një shteti me popullin dhe për popullin¹²⁴.

¹²² Carlos Sàchica L, (1984) .*Constitucionalismo Colombiano*, Bogotá, fq 34.

¹²³ Rozo Acuna E. (1986). *Problemi attuali dell'ordinamento costituzionale colombiano*, in *Diritto e Società*, Padova,.

¹²⁴ Rozo Acuna E.(1974). *Desarrollo Politico de Colombia*, Bogotá, fq 22-46..

Kolumbia nga vitet '70 të shek. XX kishte nevojë të rishpallte kushtetutën në fuqi të viteve 1886, edhe pse kjo e fundit ishte reformuar disa herë. Në vitin 1977 dhe 1979 u shënuan dy tentativa reforme kushtetuese, të cilat dështuan sepse Gjykata e Lartë e Drejtësisë¹²⁵, vërejti disa gabime proceduriale ose forme, dhe i deklaroi kushtetueshmërisht të paligjshme¹²⁶.

Në vitin 1990, Presidenti i Republikës¹²⁷, pasi konstatoi atë që përmendëm më lart, pra faktin që Kongresi pas vitit 1979 nuk kishte qenë në gjendje të miratonte asnjë reforme kushtetuese, vendosi t'i nënshtrohte konsultës popullore problemin e reformës kushtetuese. Formalisht, pyetja që i nënshtrohej popullit kolumbian kishte të bënte me vendimin për të krijuar apo jo një asamble kushtetuese në vend të kongresit për të realizuar reformën e dëshiruar. Populli, me një mazhorancë të madhe u përgjigj në mënyrë pozitive dhe Qeveria, më 27 mars 1990, veproi duke deklaruar zgjedhjet për Asamblenë Kushtetuese¹²⁸.

Fillimisht, Qeveria, me anë të një dekreti legjislativ, mendoi të kufizonte pushtetet e Asamblesë Kushtetuese, duke renditur një sërë tematikash mbi të cilat, dhe vetëm mbi to, ajo mund të shprehej. Ky dekret u deklarua antikushtetues nga ana e Gjykatës së Lartë për së u përket limiteve të vëna nga kushtetuesja dhe, në këtë mënyrë, duke mos u bazuar te një reformë e thjeshtë, ajo procedoi me përpunimin e një kushtetute tërësisht të re.

Koha në dispozicion e Asamblesë Kushtetuese për reformën ishte vetëm gjashtë muaj, nga janari deri në korrik 1991, pa mundësi të zgjatjes së afatit. Mbase, koha e shkurtër në dispozicion ishte edhe shkak i defekteve dhe gabimeve që mund të përmbajë kushtetuta e re.

Mbi të gjitha, Kushtetuta ishte tepër e gjatë, pa asnjë dyshim më e gjata në botë. Artikullimi në pjesën më të madhe ka të bëjë me lëndët ligjore të thjeshta, përsëritjet

¹²⁵ Titullare ekskluzive e kontrollit të kushtetueshmërisë.

¹²⁶ Rozo Acuna E. (1986). *El Control de Constitucionalidad de las Reformas Constitucionales en Colombia*, Bogotá, fq 68..

¹²⁷ Cèsar Gaviria.

¹²⁸ Fescol.(1991). *Una Constituyente para la Colombia del futuro*, Bogotá, fq 37-49.

janë të shpeshta, disa herë nenet janë kontradiktore dhe të tejzgjatura. Në të vërtetë, ka munguar koha e duhur për kushtetuesit kolumbianë për të përpunuar një tekst më të përmbajtur, të sakte dhe teknik¹²⁹.

Me punën e tyre kushtetuesit shfuqizuan një kartë kushtetuese më shumë se shekullore dhe adoptuan një kushtetutë të re, përmbajtja e së cilës, për disa aspekte, mund të jetë e diskutueshme:

1. Kushtetuesit kanë modifikuar një sistem kontrolli të kushtetueshmërisë së ligjeve, efënca e të cilit rezultonte e provuar gjatë dhjetëvjeçarëve të gjatë, me krijimin e Gjykatës Kushtetuese tërësisht të re për konstitucionalizmin kolumbian.

Në fakt, përpara reformës dhe, për më tepër se një shekull, kontrolli i ligjshmërisë kushtetuese të ligjeve dhe akteve administrative me forcë ligji (dekretet legjislative) ishte ushtruar nga Gjykata e Lartë e Drejtësisë, duke ndjekur në njëfarë mënyre modelin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Në vitin 1986 u shfaq një reformë me krijimin e një seksioni kushtetues pranë kësaj gjykate, me funksionin e përgatitjes së një relacioni mbi kushtetueshmërinë e aktit në fjalë, i cili do të paraqitet më tej në seancën plenare, domethënë Seksionet e Bashkuara të Gjykatës për vendimin përfundimtar.

Për sa i përket legjitimitetit kushtetues të akteve administrative, të cilat ndryshojnë nga dekretet legjislative, sistemi nuk ka ndryshuar, sepse edhe sipas kushtetutës së re gjykimi u takon Gjykatave Administrative të Shkallës së Parë dhe Këshillit të Shtetit në shkallën e fundit të gjykimit. Gjykimi i përgjithshëm në lidhje me këtë formë kontrolli kushtetues ka qenë përgjithësisht pozitiv¹³⁰.

2. U krijua një organ, Këshilli i Lartë i Magjistraturës ("Giudicatura" në Kushtetutën kolumbiane), sipas modelit italian, që vazhdon akoma të japë rezultate të diskutueshme. Përpara reformës, sistemi parashikonte kontrollin e gjyqtarëve nga ana e Prokurorisë së

¹²⁹ Përbëhet nga më shumë se 380 nene, të ndara në 13 tituj dhe 49 kapituj, me 8 kapituj me nene tranzitore që përfshijnë 60 nene të tjera.

¹³⁰ Carlos Sàchica L. (1970). *La reforma constitucional de 1968*, Bogotá; Gaona M. (1988). *Estudios constitucionales*, Bogotá, fq 68-112, II.

Përgjithshme¹³¹ dhe, veçanërisht për magjistratët e Gjykatës së Lartë dhe Këshillit të Shtetit, ishte parashikuar një Gjykatë Disiplinore, e cila përbënte organin që zgjidhte konfliktet e kompetencës. Siç u përmend më sipër, sistemi funksionoi pa shumë probleme deri në vitin 1991. Që nga ajo kohë, organi i ri i vetëqeverisjes së gjyqtarëve, Këshilli i Lartë i "Giudicatura"-s ka provokuar konflikte mes organeve të larta të drejtësisë, mbi të gjitha për sa u përket funksioneve të kompetencës, në lidhje me kontrollin funksional dhe drejtimin e autonomisë financiare të pushtetit gjyqësor¹³².

3. U krijua sërish zëvendëspresidenca e Republikës me një zëvendëspresident të zgjedhur drejtpërdrejt nga populli, me një kujtim të trishtë të së shkuarës kushtetuese kolumbiane, me eliminimin e një institucioni, atë të Primo Designato, të një dobishmërie të provuar, i cili i dha për shumë vite stabilitet qeverisë dhe vendit. "Designato" ishte funksionari që zëvendësonte presidentin në rast mungese absolute për arsye shëndetësore, vdekje, dorëheqje apo *impeachment*, si dhe në rast mungese absolute për arsye shëndetësore, pushime ose license të Presidentit. Designato nuk kishte funksione të tjera dhe ishte i zgjedhur nga Kongresi për një periudhë dyvjeçare, pa mundësi rizgjedhjeje, meqenëse duhet t'i përkiste të njëjtës parti të Presidentit. Për mungesat e përkohshme, mbi të gjitha në rast sulmi jashtë vendit në ushtrimin e detyrave si kryetar i Shtetit dhe i Qeverisë, Presidenti mund të emëronte një ministër me detyrën për të ushtruar funksionet e vendosura në mënyrë specifike nga vetë Presidenti. Në atë kohë u shfaq si një sistem që mund të tejkalonte me sukses problemet historike të zëvendëspresidencës¹³³.

4. Një tjetër aspekt i kritikueshëm i reformes është fakti i dhënies së funksioneve politike disa organeve gjyqësore; është rasti i Këshillit të Shtetit, organ suprem i juridiksionit administrativ, të cilit i është dhënë pushteti i emërimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar Elektorale, organ ky, përbërja e të cilit reflekton përfaqësimin politik

¹³¹ E cila nuk mbulon funksionin e akuzës publike si në Shqipëri, por është garante e ligshmërisë dhe e kontrollit të funksionit publik.

¹³² Në fakt, neni 256, pika V, i Kushtetutës lejon KLD - në kolumbiane

¹³³ V. H. Herrera et altri, Designatura - Vicepresidencia. Informe, Ponencia, Gaceta Constitucional, Bogotá, 1991, faqe 76.

të partive: është e lehtë të imagjinohen presionet dhe kompromiset që krijohen përreth këtij organi gjyqësor.

Në të njëjtën mënyrë, Këshilli i Shtetit ndërhyr në zgjedhjen e Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës, duke prezantuar në Kongres kandidatët për t'u emëruar dhe në zgjedhjen e Kontrolluesit të Përgjithshëm të Kombit. Gjykatës së Lartë të Drejtësisë dhe Gjykatës Kushtetuese i janë dhënë detyrat e ndërhyrjes në zgjedhjen e Fiscal General¹³⁴ dhe të Prokurorit të Përgjithshëm; të njëjtat pushtete u janë dhënë edhe gjykatave të larta dhe administrative për zgjedhjen e kontrollorëve të departamenteve (provincave) dhe të qyteteve kryesore.

Përfshirja e organeve të administrimit të drejtësisë në çështjet me kuptim apo përmbajtje politike u tregua një zgjidhje e diskutueshme. Eksperienca politike kolumbiane e të fundve e tregon: ne më shumë se një rast kemi asistuar në tratativat mes organeve gjyqësore dhe sekretarive të partive ose të magjistratëve që përkrahën disa kandidatë në detyrat e lartpërmendura, duke ndjekur qartësisht interesa partiake; në këtë mënyrë u komprometuan karakteri *super partes* dhe imazhi i paanshmërisë politike pikërisht i magjistratëve.

5. U shndërruan në norma kushtetuese disa lëndë që i përkisnin ligjit të thjeshtë dhe, si rrjedhojë, kushtetuta kolumbiane u bë kushtetuta më e gjatë në botë. Disa shembuj: kushtetuta përmban kërkesa për emërimin ose zgjedhjen e pothuajse tërësisë së funksionarëve civilë, madje të gjitha çështjet e mungesës së kompatibilitetit të tyre; ligjit mbi bilancin kushtetuta i dedikon një kapitull të tërë për të qartësuar në detaje të gjithë lëndën; në të njëjtën mënyrë rregullohen Banka Qendrore, *Contraloria* (Gjykata e Llogarive), administratat e decentralizuara të enteve publike dhe lokale e kështu me radhë, të gjitha lëndët e disiplinuar me ligj dhe jo nga kushtetuta.

Në bazë të këtyre parashtrimeve të përgjithshme është e mundur të procedojmë me një analizë të përmbajtjes së kushtetutës së re kolumbiane, mbi të gjitha në lidhje me garancitë kushtetuese që, edhe pse në praninë e aspekteve të kritikueshme, paraqet të tjera aspekte që mund t'i konsiderojmë funksionale dhe të lavdërueshme.

¹³⁴ Prokurori titullar i akuzës.

Titulli i Kartës lidhet me parimet themelore, mes të cilave meriton të përmendet ai i sovranitetit popullor, i cili zëvendëson konceptin e sovranitetit kombëtar, që në kushtetutën e mëparshme ushtronte influencë negative në lidhje me formën e demokracisë. Nëpërmjet këtij ndryshimi, demokracia kolumbiane ka mundësinë të bëhet me pjesëmarrëse dhe e drejtpërdrejtë, të paktën në teori, sepse populli bëhet titullar i pushtetit politik, duke ushtruar në këtë mënyrë këtë pushtet jo vetëm nëpërmjet përfaqësuesve të tij të zgjedhur në të gjitha nivelet qeverisëse dhe administrative, por edhe drejtpërdrejt nëpërmjet instituteve si referendumi, plebishiti, konsultimet popullore, iniciativa ligjvënëse, aksioni popullor i kushtetueshmërisë, revokimi i mandatit për përfaqësuesit e zgjedhur¹³⁵. Një tjetër parim themelor është ai i njohjes së diversitetit etnik dhe kulturor të kombit kolumbian, nga i cili lind detyrimi i shtetit për njohjen jo vetëm të gjuheve të ndryshme, traditave dhe kostumeve, por edhe të një juridiksioni të posaçëm për popullin indigjen (neni 7).

3.3 Të drejtat, garancitë dhe detyrimet në Kushtetutën Kolumbiane

Titulli i II. mbi garancitë dhe të drejtat është më i gjati i kushtetutës së vitit 1991, me 84 nene¹³⁶ të ndara në pesë kapituj: të të drejtave themelore, të të drejtave sociale, ekonomike dhe kulturore, të të drejtave kolektive dhe të mjedisit, të mbrojtjes dhe aplikimit të të drejtave e të detyrimeve¹³⁷. Shtetësia dhe të drejtat politike inkuadrohen në tituj të tjere, i III dhe i IV në pjesëmarrjen demokratike dhe partitë politike¹³⁸.

Nga titulli mbi të drejtat duhet të rilevohen më tepër aspekte pozitive sesa negative. Mes të dytëve duhet përmendur retorika e disa prej këtyre neneve, si ajo mbi "zhdukjen e forcuar" (neni 12), i vështirë apo i pamundur për t'u kuptuar në një shtet që garanton të drejtën e jetës. Madje, neni 17, i cili ndalon skllavërinë dhe tregtimin e qenieve njerëzore, nuk shpjegohet nëse konsiderojmë ekzistencën e neneve mbi barazinë dhe

¹³⁵ Nenet nga 1 deri në 5.

¹³⁶ Për këto instrumente, pjesëmarrja popullore v. respektivisht neneve 3, 40 dhe 103 të Kushtetutës.

¹³⁷ Shiko nenet nga 1 deri në 95.

¹³⁸ Uribe Vargas D, (1991). *Carta de Derechos, deberes, garantias y libertades. Informe, ponencia, Gaceta Constitucional*, Bogotá, fq 8.

lirinë, me përjashtim të rastit nëse kujtojmë që Kolumbia, nga epoka e Bolivarit, shfuqizoi skllavërinë. Një tjetër nen, 22, i cili shpall paqen si një e drejtë dhe detyrë, që mund të kuptohet vetëm nëse kujtojmë faktin që vendi jeton, prej më shumë se gjysmë shekulli, në një luftë të padeklaruar dhe, si rrjedhojë, ka nevojë për paqe. Me këtë qëllim mbase është e nevojshme të kujtohet se paqja është bija e drejtësisë dhe se emri i ri i paqes është zhvillimi.

Një tjetër nen që nuk ka një shpjegim juridik, por as i një politike ekonomike është neni 65, i cili shpreh tekstualisht se shteti do t'i ofrojë mbrojtje të posaçme prodhimit të ushqimeve, kur problemi, më tepër se për prodhimin ushqimor, është ai i zhvillimit të përgjithshëm dhe i reformave sociale dhe ekonomike, mes të cilave mbi të gjitha ajo bujqësore.

Mes aspekteve pozitive të këtij titulli meritojnë të kujtohen: e drejta - garanci e re e *habeas data* -s (neni 15), e nevojshme në epokën elektronike, të teknologjisë informatike dhe e bankave të të dhenave. Mbi bazën e këtij instituti, çdokush ka të drejten të njohë, azhurnojë dhe ratifikojë informacionet që mbi personin janë mbedhur në bankat e të dhenave dhe në arkivat e enteve publike dhe private, me një rekurs juridiksional analog me atë në fuqi prej shumë shekujve për mbrojtjen e lirisë personale, pikërisht *habeas corpus*¹³⁹.

Një tjetër e drejtë e re e kushtetutës kolumbiane të vitit 1991 është *amparo*, ose mbrojtja (neni 86), sipas të cilës çdo individ mund t'u kërkojë gjyqtarëve, nëpërmjet një procedure preferenciale dhe të shpejtë, drejtpërdrejt ose nëpërmjet një të treti, mbrojtjen imediate të të drejtave të tij kushtetuese themelore, nëse janë shkelur ose nëse parashikohet një shkelje e tyre për veprimin apo mosveprimin e çdo autoriteti publik ose privat, ose nëse sjellja e këtyre të fundit cënon rëndë dhe drejtpërdrejt interesin kolektiv, ose respekti ndaj të cilëve kërkuesi gjendet i nënshtruar apo pa mbrojtje. Duhet shtuar

¹³⁹ Është një e drejtë kushtetuese themelore që tashme është e pranishme në shumë kushtetuta latino-amerikane (Argjentinë, Peru, Ekuador, Bolivi, mes atyre më të reja), për mbrojtjen e intimitetit, nderit dhe emrit të mirë të personave nga futja dhe nga pushtimi pa kufij të informatikës dhe nga abuzimet që mund të kryhen me informacionet e mbledhura dhe të arkivuara nëpërmjet bankave të të dhenave publike dhe private. Si në epokën e Magna Charta-s ishte e nevojshme garancia e *habeas corpus* - it, në ditët e sotme është i domosdoshëm aplikimi i kësaj të drejte - garancie të re themelore e *habeas data* - s.

fakti se *amparo*, ose mbrojtja, i korrespondon një garancie tradicionale dhe shekullore të së drejte publike latino-amerikane¹⁴⁰ dhe se sistemi kushtetues kolumbian në këtë rast është azhornuar pozitivisht¹⁴¹.

Një normë e re kushtetuese, që lidhet me të drejtën e pronësisë dhe që, nëse përdoret në mënyrë efektive ose funksionale, shërben për të zgjidhur shumë problematika të drejtësisë dhe të barazisë sociale ekzistuese në Kolumbi, si në zonat rurale ashtu dhe në ato urbane. Bëhet fjalë për nenin 58, sipas të cilit për arsye të nevojave publike ose të interesit social, ligji mund të dekretojë shpronësimin pa asnjë lloj dëmshpërblimi. Gjithashtu, në raste të veçanta të vendosura nga ligjvënësi, shpronësimi mund të kryhet edhe me rrugë administrative, domethënë në mungesë të një vendimi gjyqësor, pa prekur natyrisht të drejtën e një rekursi administrativ. Duke aplikuar këtë normë të re, shteti kolumbian mund të çojë përpara mbi të gjitha reformën agrare. Megjithëse ekziston ky nen, nuk është realiste të mendojmë për aplikimin apo ekzekutimin e tij, të paktën në epokën aktuale, duke marrë në konsideratë marrëdhëniet e forcave politike ekzistuese sot dhe mungesën e partive politike moderne me ideologji të favorshme për sa i përket ndryshimit social¹⁴².

Duke marrë në konsideratë faktin që Kolumbia përjeton një problem tepër të rëndë, atë të fëmijëve të braktisur, fenomen ky fatkeqësisht i përbashkët i shumë vendeve të Amerikës Latine, Kushtetuta e re u dedikon të drejtave themelore të fëmijëve nenin 44, që mes të tjerave ka aspektin pozitiv që i liston dhe qartëson ato, gjë që nuk ndodh me të drejtat themelore të subjekteve të tjera. Nga kjo renditje duhen përmendur të drejtat e fëmijëve për t'u ushqyer në mënyrë të ekuilibruar, e drejta për të pasur një familje, e dashurisë, e mbrojtjes kundër çdo forme braktisjeje, dhune fizike ose morale, sekuestrim, abuzim seksual, shfrytëzim ekonomik apo në punë¹⁴³.

¹⁴⁰ Lindi në Meksikë në gjysmën e parë të tetëqintës.

¹⁴¹ Rozo Acuna E.(1994), *La tutela o amparo ne diritto pubblico colombiano*, Studi Urbinati, Urbino,; Zubieta Reina F.(1990), *La acción de amparo*, Lima, fq12-36.

¹⁴² Hinestrosa F, (1996). *La proprietà nella nuova costituzione colombiana*, Studi Urbinati, Urbino. fq14.

¹⁴³ Maria V. De Guzmán. (1991), *La alegría de ser*, Bogotá. fq 98.

Duke ndjekur hapat e kushtetutave të tjera latino-amerikane, ajo kolumbiane e vitit 1991 ka dashur t'i dedikojë një nen të drejtës së banesës (neni 51). Shembulli i Kushtetutes Sovjetike të viteve gjashtëdhjetë për të aplikuar të drejtën e të gjithë personave për të zotëruar një banesë private, është imituar nga ato vende që për shumë dhjetëvjeçarë nuk kanë mundur të tejkalonin problemet e mungesës së zhvillimit dhe aq më tepër nuk kanë realizuar reforma të mëdha, si për shembull ajo urbane; kjo reformë është baza e zgjidhjes së problemit të rëndë të banimit që prek Amerikën Latine. Mund të pohojmë se kjo e drejtë përbën, pra, vetëm një dëshirë me rrezikun se mund të transformohet në një shembull retorike kushtetuese¹⁴⁴.

Në fushën e lirive fetare dhe të kultit, kushtetuta e re ka ecur përpara me nenet 18 dhe 19, të cilët garantojnë lirinë e ndërgjegjes dhe të kultit dhe barazinë e të gjitha besimeve fetare përpara ligjit. Në fushën e martesës dhe divorcit, kushtetuta (neni 42) ka sjellë supremacinë e ligjit civil mbi legjislacionin fetar, duke disponuar në këtë mënyrë që efektet e ligjit civil të çdo martese do të ndërpriten me divorcin, sipas ligjit civil¹⁴⁵.

Një hap i rëndësishëm në fushën e garancive dhe realizimit të të drejtave kushtetuese përfaqësohet edhe nga neni 84, i cili disponon që një e drejtë ose veprimtari, që janë të disiplinuar në pergjithësi, nuk kërkojnë për ushtrimin e tyre asnjë autorizim, kërkesë apo ndërhyrje të mëtejshme të autoriteteve publike; në këtë këndvështrim, janë menjëherë të aplikueshme të gjitha të drejtat kushtetuese themelore.

Një gjykim i përgjithshëm mbi titullin e të drejtave është pozitiv, edhe pse aplikimi mbetet akoma parcial. Mund të pohojmë, megjithatë, që është më mirë të kemi të gjitha këto të drejta të shkruara në kartën kushtetuese sesa të mos ishin as të përmendura në të. Madje, duhet të besojmë në funksionin edukativ të normave.

3.4 Garancitë kushtetuese në Peru

Konstitucionalizmi i Amerikës Latine është karakterizuar, që nga origjina e tij, nga institucione që janë të drejtuara për garantimin e lirive themelore të njeriut, si *amparo*

¹⁴⁴ Asamblea Nacional Constituyente, Plan de alivio social, Bogotá, 1991.

¹⁴⁵ Rozo Acuna E. (1995). *Stato, Chiesa e libertà religiosa in Colombia*, në Quaderni di Diritto e Politica Ecclesiastica, 2.

dhe mbrojtja. Me këtë qëllim, Peruja paraqet në kushtetutën aktuale¹⁴⁶ gjashtë mekanizma mbrojtjeje të lirive themelore: aksioni i *habeas corpus*-it, me një origjinë antike angleze dhe spanjolle; aksioni i *amparo*-s dhe *habeas data*-s së bashku me aksionin e antikushtetueshmërisë, aksionin popullor dhe aksionin e veprimit.

Aksioni i *amparo*-s, ose i mbrojtjes kundër veprimeve apo mosveprimeve të çdo autoriteti, funksionari apo personi privat, që prek apo cënon çdo të drejtë të njohur nga kushtetuta, ndryshe nga e drejta individuale dhe nga të drejtat kushtetuese të lidhura, të cilat garantojnë nga aksioni i *habeas corpus* -it, si dhe nga të drejtat e mbrojtura me aksione juridiksionale specifike.

Aksioni i *habeas data*-s del kundër veprimit apo mosveprimit nga ana e çdo autoriteti, funksionari ose personi privat, që prek apo cënon të drejtën e çdo personi për të kërkuar, pa përmendur arsyen, informacionin që dëshiron dhe ta marrë atë nga çdo ent publik, brenda afatit ligjor, me përjashtim të rastit kur informacionet prekin intimitetin personal dhe ato shprehimisht të përjashtuara nga ligji ose për motive sigurie kombëtare. Precizohet se sekreti bankar mund të ndërpritet me kërkesë të gjyqtarit, të Prokurorit të Përgjithshëm (Task Force) ose e një Komisioni Hetimor të Kongresit. Habeas data procedon edhe në rastet që lidhen me të drejtën me qëllim që shërbimet informatike, kompiuterike, publike apo private të mos rrëfejnë informacione të pasakta apo ofenduese të nderit, reputacionit të mirë, intimitetit personal, familjar dhe të imazhit, me të drejtën konsekuente për t'i ratifikuar falas, në mënyrë direkte dhe proporcionale.

Aksioni i antikushtetueshmërisë procedon kundër normave të një rangu ligji, dekreti legjislativ, dekreti urgjent, traktate, rregullore të kongresit, si dhe norma rajonale me karakter të përgjithshëm dhe urdhra komunale, në rastin kur janë në kundërshtim me kushtetutën në formë dhe substancë. Nga ana tjetër, aksioni popullor procedon, për shkelje të kushtetutës dhe të ligjit, kundër rregulloreve, normave administrative, si dhe zgjidhjeve dhe dekreteve me karakter të përgjithshëm, të leshuara nga çdo autoritet.

Mund të propozojnë aksionin e antikushtetueshmërisë: Presidenti i Republikës, Prokurori i Kombit, Avokati i Popullit, 25% i numrit ligjor të anëtarëve të Kongresit; në fushat e kompetencës së tyre: Presidenti i Rajoneve me marrëveshje të Këshillit dhe

¹⁴⁶ Neni 38 i Kushtetutës.

Kolegjeve Profesionale. Ky aksion duhet të paraqitet nga jo më pak se 5.000 shtetas (kushtetuta e mëparshme kërkonte 50.000). Si kontrast, duhet të nënvizohet fakti se në konstitucionalizmin kolumbian mjafton vetëm një shtetas për të nisur aksionin.

Gjithashtu, aksioni funksionon si një garanci juridiksionale, që siguron bindjen ndaj normave ligjore, ose ndaj akteve administrative nga ana e një autoriteti ose e një funksionari¹⁴⁷.

3.5 Të drejtat e njeriut, detyrat dhe garancitë në Venezuelë

Në Titullin e III-të të Kushtetutës së re, Venezuela mori të gjithë eksperiencën e fushës së vendeve më të rëndësishme të Amerikës Latine nga fundi i viteve '80 deri më sot. Në këtë periudhë, pjesa më e madhe e vendeve kanë përjetuar lindjen e demokracisë, të paktën të asaj formale, mbi bazën e mbetjeve politike që kanë lënë diktaturat ushtarake të Kepit të Jugut (Argjentinë, Brazil, Uruguai, Kili, Paraguai), të vendeve andine, Ekuador, Bolivi, Peru, dhe të vendeve të Amerikës Qendrore, Salvador, Nikaragua dhe Guatemalë, të njohura për historitë e trishta të shkeljeve pa limit të të drejtave njerëzore. Mjafton të mendojmë fenomenin e "desaparecidos". Me demokracinë hapet edhe një etapë e re për të drejtat njerëzore dhe miratohen në të gjitha kushtetutat e reja latino-amerikane të drejta dhe garanci të reja, si *amparo*, *habeas data*, të drejtat mjedisore, të konsumatorit, të drejtat e pjesëmarrjes në administratën publike, kontrolli i qeverisësve, avokati i popullit, për të përmendur disa nga më të rëndësishmet¹⁴⁸.

Ndryshimet më të rëndësishme të kushtetutës së fundit venezuelane në këtë fushë mund të përmbledhen në këto pika:

1. Perfeksionohen normat mbi të drejtat e njeriut, duke i vënë në një rang kushtetues me dispozitat e traktateve ndërkombëtare mbi këtë fushë dhe me parimin e progresivitetit. Në këtë kuptim, katalogu i të drejtave dhe garancive të përmbajtura në kushtetutë nuk përfaqëson një limit apo mohim të të tjerëve, që lidhen me personin dhe traktatet, paktet dhe marrëveshjet në fushën e të drejtave të njeriut, të firmosura dhe ratifikuara nga

¹⁴⁷ Shiko nenin 200 pika 6.

¹⁴⁸ Shiko në këtë kuptim, Brecher-Carias A. (1999). *Asamblea Constituyente y Ordenamiento Constitucional*, Caracas, faqe 122 e vijuese.

Venezuela, kanë hierarki kushtetuese dhe mbizotërojnë në sistemin juridik të brendshëm, në sensin se ato janë më të favorshme se normat e vendosura nga kushtetuta dhe ligjet, për gëzimin dhe ushtrimin e të drejtave, duke qenë se kanë aplikim direkt nga gjykatat dhe nga organet e tjera shtetërore.

2. Krijohet e drejta e *amparo*-s ose e mbrojtjes, si garanci juridiksionale edhe e atyre të drejtave që nuk janë përmendur shprehimisht në kushtetutë, nëpërmjet një procedimenti oral, publik, të shkurtër, të thjeshtë, në të cilin gjyqtari kompetent ka pushtet për të vendosur menjëherë situatën juridike të shkelur, ose atë që i përafrohet më shumë. Aksioni mund të paraqitet dhe gjyqtari në çdo moment duhet ta trajtojë atë në mënyrë preferenciale.

3. Mbi kombesinë dhe shtetësinë, normat kushtetuese kanë ndryshuar mbi të gjitha duke lejuar shtetësinë e dyfishtë: nuk e humb shtetësinë venezuelane personi që merr një shtetësi tjetër. Gjithashtu, parashikohet për të huajt një periudhë qëndrimi në territorin vendas prej të paktën dhjetë vitesh për të kërkuar natyralizimin, por për shtetasit latino-amerikane, spanjollë dhe italianë këto afate zvogëlohen në pesë vite, ashtu si për bashkëshortët e një shtetasi apo shtetase venezuelane.

4. Për sa u përket të drejtave të shtetasit, në radhë të parë, parashikohet që venezuelanët për adoptimin gëzojnë të njëjtat të drejta, por nuk mund të zgjedhin apo emërojnë: presidentin dhe zëvendëspresidentin e Republikës ose Asamblenë Kombëtare; magjistrat e Gjykatës Supreme të drejtësisë, Prokurorin e Përgjithshëm, Kontrollorin e Përgjithshëm; ministrat për çështjet që lidhen me sigurinë, financat, energjinë dhe minierat, arsimin; guvernatorë apo kryetarë bashkie të shteteve dhe komunave kufitare; oficerë të lartë të forcave të armatosura.

5. Në kushtetutën e re zgjedhësit kanë të drejtën e kërkesës së llogarisë nga ana e perfaqësuesve të tyre; krijohet në këtë mënyrë e drejta e shtetasit për të revokuar mandatin e funksionarëve të zgjedhur nga populli, nga Presidenti i Republikës e poshtë. Krijohen edhe mekanizmat e pjesëmarrjes politike popullore, si referendumi për miratimin e ligjeve nëse e kërkon dy e treta e anëtareve të Asamblesë Kombëtare; Krijohet edhe referendumi konsultiv me kërkesë të Presidentit të Republikës, të Asamblesë Kombëtare ose i 10% të totalit të të regjistruarve në listat elektorale;

referendumi revokues, pikërisht për revokimin e të gjitha detyrave dhe magistraturave me zgjedhje popullore, me kërkesë të të paktën 20% të elektoratit.

6. Në lidhje me të drejtat civile, konfirmohet barazia e plotë e personave dhe zgjerohen përgjegjësitë e shtetit në mbrojtjen e personave që ndodhen në burg, duke ushtruar detyrat ushtarake apo civile, ose në çdolloj forme tjetër të nënshtruar në autoritetin e tij. Rrjedhimisht, lind ndalimi për autoritetet publike, civile ose ushtarake, që të praktikojnë, lejojnë ose tolerojnë zhdukjen e forcuar të personave, krim për fat të keq i shpeshtë në kontinentin latino-amerikan jo vetëm për arsye politike, por edhe të krimit.

7. Në fushën e lirisë fetare garantohet pavarësia dhe autonomia e kishave dhe e besimeve fetare. Gjithashtu, rinovohet e drejta për informacionin e duhur, të vërtetë, të paanshëm dhe pa asnjë censurë, e shoqëruar nga të drejtat e replikës dhe të rishikimit kundër informacioneve të pasakta ose ofenduese. Parashikohet e drejta e fëmijëve dhe e adoleshentëve për të marrë informacionin e duhur për zhvillimin e tyre integral; ashtu si e drejta e çdo personi për nderin, jetën private, intimitetin, imazhin e tyre, "konfidencialitetin" dhe reputacionin e personave; liria e ndërgjegjes dhe manifestimet e saj në mënyrë që kundërshtimi i saj të kërkohej për të anashkaluar përmbushjen e ligjeve ose për të ndaluar të tjerët ta bëjnë ose të ushtrojnë të drejtat e tyre.

8. Në lidhje me të drejtat sociale, aspektet më të rëndësishme janë konstitucionalizimi i bashkimeve të lira dhe të familjeve mes bashkëjetuesve; parashikimi i të drejtave dhe garancive të të moshuarve; garancia e punës me të drejtën për të pasur një pension jo më të ulët se paga minimale; e drejta për një banesë të denjë, të sigurt dhe të rehatshme; garancia e shërbimit shëndetësor kombëtar të drejtuar nga shteti me ndalimin e privatizimit të shërbimeve të shëndetit publik; njihet puna e shtëpiakeve si një veprimtari ekonomike që krijon një vlerë të shtuar, prodhon pasuri dhe mirëqenie sociale dhe lejohet e drejta e sigurisë sociale për shtëpiaket.

9. Në fushën e lirisë sindikale parashikohet që statutet dhe rregulloret e organizatave sindikale duhet të këmbëngulin mbi alternimin e drejtuesve të tyre dhe përfaqësuesve nëpërmjet një vote universale, direkte dhe sekrete dhe deklaron si vepra penale që dënohen abuzimin me benefitet që e kanë prejardhjen nga liria sindikale nga ana e drejtuesve për përfitime ose interesa personale.

10. Kultura mbahet në konsideratë, mbi të gjitha, për sa i përket shoqërisë multietnike, duke parashikuar lehtësime dhe stimuj për personat, institucionet dhe komunitetin në këtë fushë, mbulimin e sigurisë sociale për operatorët kulturorë, garancinë e përhapjes së kulturës. Shteti impenjohet për zhvillimin e kulturave popullore, të cilat konsiderohen pjesë esenciale e *venezualitetit*.

11. Një tjetër aspekt i kushtetutës së re në fushën e të drejtave sociale është ai i arsimit publik, i cili ofrohet falas deri në momentin e diplomimit universitar, duke vendosur rregullin e konkursit me meritë dhe vlerësimit personal dhe krahasues dhe duke përjashtuar çdo kriter tjetër. Parashikohet detyrimi i arsimit në fushën mjedisore dhe shoqërore dhe garantohet përdorimi i posaçëm i informatikës për të lejuar aksesin universal të informacionit. Konstitucionalizohet autonomia universitare, paprekshmëria e selive universitare dhe njihet si interes publik shkenca, teknologjia, dija, inovacioni dhe shërbimet e informacionit, duke garantuar zhvillimin e tyre me mjete të mjaftueshme.

12. Mes të drejtave ekonomike të reja duhet përmendur karakteri kushtetues i privatizimeve. Parashikohet edhe e drejta e cilësisë dhe e informacionit të përmbajtjes së mallrave të konsumit.

13. Një pjesë e rëndësishme u dedikohet të drejtave të popujve indigjenë, duke ndjekur tashmë një tendencë kushtetuese të Amerikës Latine. Me këtë pjesë të kushtetutës, shteti venezuelan njeh ekzistencën e popujve dhe të komuniteteve indigjene, organizimin e tyre shoqëror, politik dhe ekonomik, kulturor, zakonet, idiomat dhe fetë, gjithashtu edhe mjedisin e tyre dhe të drejtat origjinare mbi tokat që zënë tradicionalisht, të nevojshme për zhvillimin dhe për t'i siguruar formën e tyre të jetesës. Shfrytëzimi i resurseve natyrore të shtetit duhet të bëhet në respektim të këtyre të drejtave dhe nëpërmjet konsultimit paraprak me komunitetet indigjene.

Pjesa e të drejtave mbyllet duke përmendur detyrat¹⁴⁹, mes të cilave mbrojtja e kombit, e simboleve të tij, vlerave kulturore, sovranitetit, kombësisë, bashkimit territorial, interesave të kombit; detyra e cilit për të përmbushur përgjegjësitë e tyre sociale dhe e pjesëmarrjes në formë aktive në jetën politike, civile dhe komunitare të vendit, duke

¹⁴⁹ Kapitulli X, nenet 130-137.

promovuar dhe mbrojtur të drejtat e njeriut si bazë e bashkëjetesës demokratike dhe paqes sociale.

Mbi bazën e kësaj panoramike mbi të drejtat mund të pohojmë se Kushtetuta e re e Venezuelës është hartuar në formën më të përshtatshme me tendencat e nënkontinentit amerikan dhe të vendeve demokratike.

3.6 Garancia kushtetuese e *Habeas Corpus*-it në Amerikën Latine

Habeas corpus-i përfaqëson institutin më antik të garancive juridiksionale të një prej të drejtave themelore që simbolizon qytetërimin juridiko-politik perëndimor: lirinë. Siç kujtojnë të gjithë studiuesit e lëndës, vetë Magna Charta angleze e vitit 1215¹⁵⁰ garancia duket se ngjan me *habeas corpus ad subjiciendum*¹⁵¹, domethënë si një e drejtë për të disponuar për personin, ose e drejtë mbrojtjeje e lirisë personale kundër akteve apo veprimeve arbitrare apo të paligjshme nga ana e autoriteteve ose privatëve.

Duke marrë në konsideratë faktin se konsakrimi i bërë në Magna Charta angleze në fillimet e shekullit XIII i së drejtës së pronës mbi trupin e secilit dhe kundrejt drejtësisë, domethënë *habeas corpus*¹⁵², me kalimin e kohës është konsideruar i pamjaftueshëm për të garantuar në mënyrë efektive të drejtën, në vitin 1628 u miratua *Petition of Rights*, e cila garantonte të drejtën për një proces të rregullt ligjor përpara se t'i hiqet liria ose të mirat materiale. Më vonë, në vitin 1679, u miratua *Habeas Corpus*

¹⁵⁰ Siç është e ditur, Magna Charta ka qenë rezultat i një këshilli të nobilitetit anglez, që u mbodh në vitin 1213 në mbrojtje të interesave të tyre ndaj regjimit absolut të mbretit Xhon pa tokë. Mes të drejtave të përmendura në të është edhe ajo që vendos që çdo njeri i lirë nuk mund të privohet nga jeta ose prona pa u bazuar në ligj ose pa një vendim gjykate.

¹⁵¹ Siç është e ditur, emri *habeas corpus* e ka prejardhjen nga fjalët e para që vendosnin paraqitjen e të dënuarit përpara autoritetit juridiksional, në 24 orët nga arrestimi i tij, për t'i bërë të ditur arsyen e arrestimit dhe për të vendosur direkt për lirimin e tij.

¹⁵² Neni 29 i Kartës parashikon se "Asnjë njeri nuk mund të arrestohet, kapet, ose zhvishet nga të mirat e tij, nga të drejtat ose nga liria, jashtë ligjit, të mbahet në azil ose si i përndjekur, ashtu si nuk mund t'i nënshtrohet gjykimit apo të dënohet, vetëm me një procedim ligjor që i aplikohet nga të barabartët e tij dhe në bazë të ligjit të vendit". Askujt nuk do t'i mohohet, as ndërpritet, e drejta apo drejtësia. F. Battaglia, *Le Carte dei diritti*, Baruffa Editore, Reggio Calabria, 1998, 13.

Amendment Act, për të riafirmuar lirinë personale dhe për të arritur një mbrojtje më efikase dhe moderne të saj. Në vitin 1689, në përfundim të Gloriosa Rivoluzione-s, që transformoi monarkinë absolute angleze në monarki parlamentare, u miratua *Bill of Rights*, që konfirmoi në mënyrë definitive të gjitha të drejtat dhe liritë e popullit të Mbretërisë së Bashkuar, mes të cilave edhe të drejtën garanci të lirisë personale, ose *habeas corpus*-in.

Instituti kaloi nga Anglia në kolonitë e saj në Amerikë, të cilat e huazuan në deklaratat e tyre të pavarësisë. Në fakt, Karta Federale e Shteteve të Bashkuara i referohet institutit vetëm për të afirmuar mundësinë e saj për t'u kufizuar si vijon: "Privilegji i *habeas corpus*-it nuk do të ndërpritet përveç rasteve të rebelimit ose pushtimit, nëse e kërkon siguria publike"¹⁵³.

Në të vërtetë, në këtë vend, liria personale garantohej me anë të këtij mjeti juridiksional, që aplikohet kundër shtrëngimeve të paligjshme dhe përfaqëson në radhë të parë një gjykim që fillon me një rend të caktuar (ërit of *habeas corpus*), që gjyqtari lëshon me kërkesë të drejtpërdrejtë të të interesuarit ose me anë të të tretëve, me qëllim që personi që ka urdhëruar heqjen e lirisë së një individi, ta vërë në dispozicion të tij duke shpjeguar arsyet që justifikojnë heqjen e lirisë. Pas dëgjimit të palëve, në kontradiktor dhe publikisht, autoriteti gjyqësor vendos nëse konfirmon ose anulon vendimin e arrestimit ose heqjen e lirisë.

Megjithatë, origjina e këtij instituti ka rrënjë më të hershme, kohore dhe gjeografike, dhe në këtë aspekt është e rëndësishme të kujtojmë eksperiencën interesante të privilegjeve (*fueros*) spanjolle, dhe në veçanti, *Derecho de Manifestación Aragonés*. Mes këtij të fundit dhe *habeas corpus* -it anglez ekziston një analogji e madhe dhe në disa raste vërehet një identitet, duke qenë se të dy rekurset, aksionet, të drejtat dhe gjykimet kanë si objektiv të vetëm atë të efektivitetit të lirisë personale ose civile, falë adoptimit të mekanizmave ligjore konkrete, praktike dhe të sigurta për të ndaluar abuzimet e autoriteteve kundër lirise.

¹⁵³ Neni 1, Seksioni 9, pika 3, Kushtetuta. Në këtë nen vërehet influenca e modelit të ligjit procesual civil anglosankson, sipas të cilit *habeas corpus*-i mund të ndërpritet në raste të veçanta rebelimi ose çrregullime të rënda të rendit publik.

Në këtë kuptim, rekursi i *Manifestaciòn-it* të Mbretërisë së Aragonës përfaqëson një garanci ligjore tepër antike dhe efikase kundër çdo abuzimi të pushtetit¹⁵⁴. Paraqitet përpara një prej autoriteteve të Mbretërisë së Aragonës, e njohur me emrin *Giustizia*¹⁵⁵, dhe konsistonte në një aksion të drejtpërdrejtë për të nisur gjykimin, për të ndaluar që autoritetet e zakonshme të vepronin kundër një personi të posaçëm, duke parashikuar në këtë mënyrë çdolloj sjellje arbitrare ose abuzimi, jo vetëm kunder aragonezëve, por edhe, në formë shumë moderne, *erga omnes*, domethënë edhe kundër atyre që ishin origjinale të Mbretërisë së Aragonës. Titullariteti për të paraqitur rekurs i përkiste atij që ishte i dënuar ose burgosur pa një proces të rregullt apo me urdhër të një autoriteti jokompetent. Rekursi mund të paraqitej përpara *Giustizia-s* në mënyrë të drejtpërdrejtë ose me anë të një të treti, me qëllim që të ndalonin urdhrin e forcës që mbante viktimë të burgosurin.

Në të mirë të aksionit ose rekursit të *Manifestaciòn-it* mbetej vetëm alternativa që i arrestuari ose i dënuari të rekuperonte lirinë e tij, duke mos ekzistuar një bazë ligjore për dënimin e tij, ose të vazhdonte të ishte i dënuar, duke u vërtetuar ekzistenca e një shkaku të mjaftueshëm për burgimin e tij, deri në momentin e mbylljes së procesit. Edhe në këtë rast, i pandehuri nuk i nënshtrohej drejtësisë, por *Giustizia* urdhëronte transferimin e tij në një burg të posaçëm të *manifestado-s*, ose të atyre që ushtronin aksionin e *Manifestaciòn-it*, duke i garantuar këtij *fuero amparo-n*, apo mbrojtjen e lirisë së tij¹⁵⁶.

¹⁵⁴ Të vendosësh se cili është momenti historik i origjinës së tij është e vështirë, por mund të pohojmë se lindja e institutit dhe përdorimi i tij gjendet në zakonet dhe kostumet juridike dhe, në veçanti, në *procesos forales* në Mesjetë, ose në protohistorinë e Mbretërisë Aragoneze, dhe është zhvilluar dhe imponuar për të formuar një kompleks privilegjesh mbi lirinë personale për vlefshmërinë zakonore, e cila është në zhvillim konstant, deri në arritjen në fazen e përpunimit të shkruar që nis në vitin 1398, siç provohet nga Aktet e Oborreve të Saragozës.

¹⁵⁵ Ishte titullar i institutit aragonez të njohur me emrin Justiciazgo, përfaqësuesi më i lartë i pushtetit gjyqësor, i cili kishte funksione të gjera, si interpretues i ligjit dhe garant i respektimit të *fuero-s* së mbretërisë.

¹⁵⁶ Për një analizë të plotë të institutit, F. Sa'ez de Tejada de Olozaga, *El Derecho de Manifestaciòn aragonès y el Habeas Corpus inglés*, Compania Bibliografica Espanola, Madrid.

Nëse është i sugurt fakti që instituti anglez i *Habeas Corpus* -it është ai që, si model, ka influencuar më shumë në fushën e të drejtës publike në Amerikën Latine, nuk mund të mohohet rëndësia që kanë pasur *fuero*-t aragoneze dhe veçanërisht aksioni i *Manifestaciòn*-it, si kriptotipe të aksionit, rekursit apo gjykimit të *habeas corpus* ose *exhibitiòn personal*, sipas dënominimit klasik kastiljan, ashtu si dhe e drejta e *amparo*-s, ose e mbrojtjes juridiksionale të të drejtave, si instrumente për mbrojtjen e lirisë dhe në përgjithësi të të gjitha të drejtave themelore në fuqi në konstitucionalizmin e Amerikës Latine, nga më shumë së një shekull e gjysme, nga jugu i Rio Grandes deri në Patagoni¹⁵⁷.

Habeas corpus ose *exibitiòn personal*, në mënyrën universalisht të pranuar, nënkupton sot të drejtën e rekursit individual përpara pushtetit gjyqësor për të arritur mbrojtjen ose *amparo*-n e lirisë personale në lidhje me vendimet apo sjelljet e autoriteteve ose privatëve që e ofendojnë atë ose e shkelin. Në përgjithësi, në sistemet liberal-demokratike parashikohet që kufizimet e lirisë personale mund të urdhërohen në mënyre ekskluzive nga autoritetet gjyqësore, duke përdorur të gjitha rrugët gjyqësore, të vendosura më parë. Për respektimin e këtyre parimeve, që kanë si qëllim ruajtjen e lirisë personale, ekziston një garanci maksimale kushtetuese, *habeas corpus*.

Në këtë kuptim, rekursi apo gjykimi i *habeas corpus* -it e ka origjinën e tij dhe zhvillimin mbi të gjitha në fushën penale, por aktualisht zgjerohet gjithnjë e më shumë në të gjithë fushën e të drejtës procesuale kushtetuese. Në kontinentin amerikan ky evoluim nis, siç u shpjegua më sipër, nga eksperiencia e Shteteve të Bashkuara, ku instituti i *habeas corpus* -it, sipas jurisprudencës të gjykatave federale dhe të Gjykatës Supreme, u konvertua, edhe pse me kufizimet ose shkeljet e çdo të drejte kushtetuese, të pandehurit mund të kërkojnë dhe arrijnë rishikimin e vendimeve të formës së prerë, të lëshuar nga gjykatat shtetërore¹⁵⁸.

Nga Shtetet e Bashkuara, ku, siç u konstatua, evoluimi dinamik shtetëror dhe federal i institutit dhe zhvillimi i tij jurisprudencial e kanë transformuar në mbrojtjen më të

¹⁵⁷ Rozo Acuna E, (2000). *La Tutela o Amparo dei Diritti Fondamentali in America Latina*, Rimini, Maggioli, fq 213 e vijues.

¹⁵⁸ Shembulli i fundit në këtë drejtim, Patriot Act si instrument lufte kundër terrorizmit.

madhe dhe të vetme të mjaftueshme për të garantuar lirinë personale dhe të drejtat e tjera kushtetuese federale të garantuara¹⁵⁹, kalimi në sistemet kushtetuese të shteteve të reja amerikane, të lindur nga luftërat e pavarësisë kundër Spanjës, ishte imediat. Kjo vërtetohet nga kartat kushtetuese ibero-amerikane që filluan të miratoheshin që nga viti 1810. Si provë e përgjithshme është e mjaftueshme të citojmë shembullin e disa kushtetutave të ish-kolonive spanjolle të miratuara fill pas pavarësisë.

Në këtë renditje idesh, mund të kujtojmë Kushtetutën e parë të Boyacà-s, provincë e ish-mbretërisë të Nuova Granada-s, që përfaqëson aktin e themelimit të Republikës së Kolumbisë, duke qenë se ka adoptuar për herë të parë formen republikane të qeverisjes. Ky tekst i vitit 1811 konsakron *habeas corpus*-in në nenin 8, i cili adopton pothuajse të njëjtën formë të Magna Charta-s: "Asnjë njeri nuk mund të akuzohet, dënohet, arrestohet, përveçse në rastet dhe kushtet e parashikuara nga ligji...." dhe shton se, në forme moderne, përgjegjësinë e funksionarëve: "Ata që ngrenë, kërkojnë, kryejnë vendime arbitrare, janë kriminelë dhe duhet të dënohen". Këtë nen e ndjekin të tjerë që kompletojnë institutin: "Askush nuk duhet të gjykohet dhe ndëshkohet, nëse nuk dëgjohet ligjërisht, dhe në bazë të një ligji të miratuar përpara se të ndodhte krimi. Ligjet që do të ndëshkojnë veprime të mëparshme në lidhje me ekzistencën e tyre dhe që në bazë të tyre janë deklaruar kriminale, janë të padrejta, tirane dhe të papërputhshme me lirinë, ashtu si asnjë ligj civil apo penal nuk ka efekt prapaveprues" (neni 11). "Çdo njeri prezumohet i pafajshëm deri në momentin e deklarimit fajtor; në këtë mënyrë, në çdo rast, të vlerësohet i nevojshëm arrestimi i tij, ligji duhet të ndalojë rreptësisht çdo veprim që nuk është absolutisht i nevojshëm për të garantuar lirinë e tij personale" (neni 9)¹⁶⁰.

Pas kësaj hyrjeje të rëndësishme, instituti adoptohej në formë të kompletuar, precize dhe taksative: "Askush nuk mund të mbahet nëse nuk ka një urdhër të shkruar nga autoritetet kompetente" (neni 155).

¹⁵⁹ Shiko analizën mbi *habeas corpus*-in në SHBA, F. Machado Pelloni. (2003). *Derecho Procesal Constitucional*, Ad Hoc, Buenos Aires, fq 117 e vijues.

¹⁶⁰ A. Suescun, (1991). *Las Constituciones de Boyacà*, Academia Boyacense de Historia, Tunja, fq 22-23.

"Ky urdhër nuk mund të lëshohet pa një motivim paraprak, që vërteton kryerjen e krimit që meriton një dënim korigjues dhe, nëse nuk rezulton, të paktën në bazë të dëshmimeve, se cili është fajtori" (neni 156). "Mund t'u hiqet liria: 1. kriminelëve, të cilët përbëjnë rrezik arratisjeje; 2. atyre që janë kapur në flagrancë dhe, në këtë rast, të gjithë mund të kapen për t'i dërguar përpara autoriteteve gjyqësore" (neni 157). "Heqja e lirisë, që trajtohet në nenin e mësipërm, nuk mund të zgjasë më tepër se 48 orë dhe, brenda këtij afati, autoriteti që e ka urdhëruar duhet të vërë në praktikë parashikimet e nenit 156, dhe të lëshojë me shkrim urdhrin e arrestit, ose të rikthejë në gjendje të lirë të burgosurin" (neni 158).

Siç u shpreha më sipër, shembujt e përmendur janë vetëm një demonstrim i faktit se si *habeas corpus*-i është adoptuar e zgjeruar në të gjitha shtetet e Amerikës Latine. Mund të përmendet vetëm një përjashtim, që akoma sot ekziston, Meksika. Në asnjë prej kushtetutave të saj të së shkuarës dhe as në atë aktualen, në fuqi nga viti 1917, nuk përmendet instituti. Arsyeja e këtij përjashtimi duhet të kërkohet në historinë kushtetuese të Meksikës, që na mëson se ky shtet adoptoi në sistemin e tij federal që nga gjysma e parë e viteve '800 garancinë efektive kushtetuese juridiksionale të të drejtave: *Amparo*-n. E njohur në të gjithë të drejtën publike, ky institut, që ka pasur një zhvillim unik dhe në zgjerim të vazhdueshëm, jo vetëm në Amerikën Latine, por edhe në sistemet e botës perëndimore, përfshin fusha të ndryshme zbatimi dhe një nga këto fusha është ajo e lirisë personale.

Në këtë kuptim, në Meksikë rekursi ose gjykimi i *habeas corpus*-it është i përfshirë në rekursin apo gjykimin e *amparo*-s që ofron në këtë fushë një garanci dhe mbrojtje të mjaftueshme, efikase dhe imediate për të gjitha të drejtat e lirisë¹⁶¹.

3.7 Adoptimi aktual kushtetues në vendet e komunitetit andin

Në vitin 1969 u firmos një marreveshje integrimi ekonomik mes Venezuelës, Kolumbisë, Ekuadorit, Bolivisë, Perusë dhe Kilit, që i dha jetë një Tregu të Përbashkët Andin, i cili ndoqi shembullin e Tregut të Përbashkët Europian. Për arsye historike të

¹⁶¹ I. Burgoa, *El Juicio de Amparo*, Porrua, Mèxico, 1943; H. Fix – Zamudio. (1993), *Ensayos sobre el derecho de amparo*, UNAM, Mèxico, fq 43.

njohura, Kili, pas vitit 1973, u tërhoq nga pakti, por projektet e integritit ekonomik mes shteteve të mbetura vazhduan me një rezultat duke arritur në krijimin, jo vetëm të hapësirës ekonomike të përbashkët, por edhe të Parlamentit Andin dhe të Gjykatës Andine të Drejtësisë. Në vitin 1997, me firmosjen e protokollit të Kuitos, si efekti i zhvillimit të integritit, Tregu i Përbashkët Andin u transformua në Komunitetin Andin të Kombeve, duke dhënë prova për procesin në rritje të unifikimit jo vetëm ekonomik, por edhe politik të vendeve të zonës.

Pesë shtetet anëtare të këtij komuniteti, të ndodhur në Ande, njihen edhe si shtete bolivariane, duke qenë se kanë një emërtim të përbashkët, që konsiston në fitoren e luftërave të pavarësisë kundër Spanjës dhe formimin e shteteve të tyre, në dekadat e para të '800-s, falë gjenisë ushtarake, politike dhe kushtetuese të Simon Bolivarit, i quajtur *El Libertador, Padre della Patria*. Për të gjithë dhe secilin prej shteteve të reja andine, Venezuela, Kolumbia, Ekuadori, Bolivia dhe Peruja, Bolivari përgatiti projekte kushtetuese dhe integrimi politik, që ishin themelore për zhvillimin e tyre të mëtejshëm juridik dhe politik dhe mes tyre kryesojnë kapitujt e dedikuar të drejtave të lirisë dhe garancive të tyre¹⁶².

Shtetet Andine i kanë reformuar sistemet e tyre kushtetuese në mënyrë të veçante në dhjetevjeçarin e kaluar, në vitet nëntëdhjete, duke pasur si objektiv të rëndësishëm azhornimin dhe fuqizimin e pjesës së të drejtave themelore dhe garancitë e tyre kushtetuese dhe juridiksionale¹⁶³. Në fushën e aksionit, rekursit apo gjykimit të *habeas corpus*-it, azhornimi kushtetues, substancial dhe procesual, ka qenë i plotë dhe integral, siç mund të tregohet duke analizuar në rendin e tyre gjeografik të prejardhur nga vendet që përbëjnë Komunitetin Andin¹⁶⁴.

¹⁶² E. Roza Acuna (1988), *Bolivar y la organización de los poderes públicos*, Temis, Bogotá, fq 22-45.

¹⁶³ H. Fix-Zamudio, *Algunas tendencias predominantes en el constitucionalismo latinoamericano contemporáneo*.

¹⁶⁴ Natyrisht, analiza është vetëm institucionale dhe e vetëdijshme për diferencat e mëdha që ka mes kushtetutës formale dhe materiale, duke pranuar në të njëjtën kohë që situata e të drejtave të njeriut të kontinentit amerikan është përmirësuar mbi të gjitha pas kalimit të regjimeve diktatoriale të pësura nga pjesa më e madhe e këtyre vendeve.

Nga dhjetori i vitit 1999, Venezuela ka një kushtetutë të re, që e ka ndryshuar në mënyrë rrënjësore sistemin e mëparshëm¹⁶⁵ dhe, në fushën e garancive kushtetuese, në veçanti të *habeas corpus*-t, është verifikuar një azhornim thelbësor. Në fakt, kushtetuta e re forcon sistemin e përgjithshëm dhe garancitë e të drejtave të njeriut, duke bërë që shteti t'i garantojë çdo personi në formë progresive dhe pa asnjë diskriminim, gëzimin dhe ushtrimin e paevitueshëm, të pandashëm dhe të pavarur të të drejtave të njeriut, konform Kushtetutës, traktateve ndërkombëtare të ratifikuara - që kanë hierarki kushtetuese - dhe ligjeve.

Për këtë qëllim, Kushtetuta përfshin një rregullim të plotë të garancive kushtetuese të të drejtave thelbësore me qëllim që të bëjë me efektiv ushtrimin e tyre. Parashikohen garancitë esenciale të *habeas corpus*-it; fuqia prapavepruese e ligjit (neni 24); nuliteti i akteve që shkelin ligjin dhe përgjegjësia e funksionarëve (neni 25); barazia përpara ligjit (neni 21); e drejta e aksesit në drejtësi për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave, mbrojtja e tyre efektive dhe e drejta për të marrë një vendim të shpejtë dhe të drejtë (neni 26); aksioni i amparos për mbrojtjen ose sigurisë së lirisë, që mund të nisët nga cilido, derisa i dënuari të vihet në mënyrë urgjente (neni 27), pa qenë nevoja që ushtrimi i kësaj garancie të kufizohet ose pezullohet gjatë gjendjeve të jashtëzakonshme ose të emergjencës.

Në formë akoma më të drejtpërdrejtë të lidhur me *habeas corpus*-in Kushtetuta në fuqi e Venezuelës parashikon të drejtën e moscënimit të lirisë personale dhe, si rrjedhojë, garanton që asnjë person nuk mund të arrestohet apo mbahet i dënuar nëse nuk ka një urdhër gjyqësor, me përjashtim të rastit kur personi është kapur në flagrancë për kryerjen e një veprë penale. Në këtë rast, personi duhet të dërgohet përpara një autoriteti juridiksional brenda një kohe të shkurtër, duke mos tejkaluar 48 orë nga momenti i arrestimit, me qëllim që të gjykohet në liri, me përjashtim të arsyeve të vendosura nga ligji dhe të pranuar nga gjykata. Gjithashtu, çdo të dënuari i garantohet e drejta e komunikimit në mënyrë urgjente me familjarët e tij, një avokat apo person të besueshëm dhe këtyre u garantohet e drejta për t'u informuar për vendin, arsyet e arrestimit dhe

¹⁶⁵ Rozo Acuna E, *Il principio democratico nella Costituzione della Repubblica Bolivariana del Venezuela*, Studi Urbinati, LXX 2002/03, 54.1, 59 e vijues.

kushtet psiko-fizike të të arrestuarit; nëse i arrestuari është i huaj, do të lajmërohet autoriteti konsullor i parashikuar nga traktatet ndërkombëtare; autoriteti që ekzekuton masat e heqjes së lirisë duhet të jetë plotësisht i identifikueshem. Së fundmi, asnjë person nuk mund të vazhdojë të mbahet i dënuar pasi të jetë dhënë urdhri i lirimit të tij, ose pasi ka kryer dënimin (neni 44); në të njëjtën mënyrë, çdo person ka të drejtën të lëvizë lirisht dhe me çdo mjet në territorin kombëtar, të ndryshojë vendbanim, të mungojë apo të kthehet në vend, duke qenë se është rreptësisht i ndaluar largimi i përhershëm nga territori kombëtar (neni 50).

Për fat të keq, në disa vende të Amerikës Latine që kanë vuajtur nga diktaturat ushtarake të viteve '70 dhe të një pjese të viteve '80, në veçanti në vendet e ashtuquajtura "Cono Sur", por edhe në vende të tjera si Kolumbia, që nuk kanë pasur formalisht një diktaturë ushtarake, është praktikuar politika e quajtur e "sigurisë kombëtare"¹⁶⁶. Si rrjedhojë e drejtpërdrejtë e kësaj të fundit, është ushtuar një represion i dhunshëm dhe i planifikuar kundër forcave opozitare, në veçanti kundër partive dhe lëvizjeve të majta, duke i dhënë jetë fenomenit të famshëm e të trishtë të "desaparecidos", domethënë viktimat e një krimi të tmerrshëm kundër jetës njerëzore, të njohur si "zhdukja e sforcuar". Ky krim shkel jo vetëm të drejtën e jetës, por mbi të gjitha *habeas corpus*-in dhe për ta evituar e luftuar pjesa më e madhe e kushtetutave latino-amerikane ka parashikuar ndalimin e tij¹⁶⁷.

Teksti venezuelan parashikon të drejtën e lartpërmendur në nenin 45, duke ndaluar çdo autoriteti publik, si civil ashtu dhe ushtarak, edhe gjatë gjendjeve të jashtezakonshme, emergjencave ose kufizimeve të garancive kushtetuese, të praktikojnë, lejojnë apo tolerojnë zhdukjen e sforcuar të personave. Gjithashtu, parashikohet që funksionari që merr urdhrin ose instruksionet për ta praktikuar, të ketë detyrimin e mosbindjes dhe ta denoncojë pranë autoriteteve kompetente, duke parashikuar edhe që autorët moralë dhe

¹⁶⁶ Shiko, J. R. A. Vanossi, (2000). *El Estado de derecho en el constitucionalismo social*, Eudeba, Buenos Aires, fq 733 e vijues.

¹⁶⁷ Organizata e Shteteve Amerikane - OSA - që përfshin gati të gjitha vendet e Amerikës, nga viti 1994 ka një Konventë kundër zhdukjes së forcuar të personave.

materiale, bashkëpun torët ose favorizuesit e këtij lloji krimi, ashtu si tentativën e kryerjes së këtij të fundit, të sanksionohen konform ligjit.

Në mënyrë komplementare, si *habeas corpus*-i, janë bërë pjesë e kushtetutës edhe parimet e procesit të rregullt ligjor që u aplikohen të gjitha detyrimeve juridiksionale dhe administrative: e drejta e mbrojtjes, prezumimi i pafajësisë, e drejta për t'u dëgjuar, e drejta e gjyqtarit natyror, e drejta për të mos dhënë dëshmi kundër vetë personit, vlefshmëria e rrëfimit, *nullum crimen nulla pena sine lege*; *parimi i ne bis in idem*, përgjegjësia e shtetit për gabimet gjyqësore (neni 49).

Në përfundim, nga pikëpamja formale, teksti i ri kushtetutës venezuelane i vitit 1999, në fushën e mbrojtjes dhe garancise së të drejtës së lirisë personale ose *habeas corpus*, tejkalon, përmirëson dhe azhornon atë të mëparshmen të vitit 1961. Gjithashtu, me krijimin e *Defensore del Popolo* (neni 280), me detyrën e promovimit, mbrojtjes dhe kontrollit të aplikimit të të drejtave, të garancive kushtetuese dhe të traktateve ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut, jemi në prani të një instrumenti që forcon edhe *habeas corpus*-in. Në fakt, mes funksioneve të rëndësishme të *Difensore del Popolo*-s është edhe titullariteti dhe mundësia për të ndërmarrë veprime për antikushtetueshmërinë, *amparo*-n, *habeas data*-n dhe *habeas corpus*-in, ashtu si dhe veprimet e tjera, ose rekursat e nevojshme me qëllim që funksionarët publikë të përgjegjshëm për shkeljen ose cënimin e të drejtave të njeriut të ndëshkohen (neni 281, pika 3 dhe 4). Në këtë mënyrë, banorët dhe shtetasit e Venezuelës gëzojnë, të paktën në mënyrë formale, një sistem të plotë dhe integral të garancive kushtetuese.

Në korrikun e vitit 1999 hyri në fuqi Kushtetuta e re kolumbiane që, mes risive të shumta dhe të medha, përmban azhornimin dhe forcimin e të drejtës, aksionit dhe rekursit të *habeas corpus*-it, si një garanci juridiksionale. Për të qenë më preciz, teksti i ri nis me deklaratën që të gjithë personat janë të lirë dhe, si rrjedhojë, asnjë nuk mund të cenohet në personin e tij ose në familje, as të dërgohet në burg ose të arrestohet, banesa e tij nuk mund të dhunohet as në prani të një mandati të shkruar nga autoriteti kompetent - që duhet të jetë ekskluzivisht gjyqësor ose i autorizuar prej tij -, në respektim të formalitetit të ligjit dhe për një motiv të vendosur nga vetë ligji. Nëse personi është i paraburgosur duhet të vihet në dispozicion të gjyqtarit kompetent brenda

36 orëve, në mënyrë që ky i fundit të marrë vendimin përkatës. Gjithashtu, mbetet kushtetueshmërisht i ndaluar burgimi dhe arrestimi për borxhe (neni 28). Në të njëjtën kohë, teksti kolumbian imponon procesin e duhur për të gjitha sjelljet gjyqësore dhe administrative dhe, si rrjedhojë, askush nuk mund të dënohet nëse nuk respektohet ligji ekzistues para faktit ose veprës së kryer, përpara një gjyqtari apo një gjykate kompetente dhe me respektimin e plotë të formave ligjore¹⁶⁸ (neni 29).

Më konkretisht, duke iu referuar *habeas corpus*-it, teksti kolumbian parashikon që personi të cilit i është hequr liria dhe mendon se ky ka qenë një vendim i padrejtë, ka të drejtën t'i drejtohet çdo autoriteti kompetent gjyqësor, në çdo kohë, ose nëpërmjet një përfaqësuesi, aksionin ose rekursin për lirinë personale, që duhet të vendoset brenda 36 orëve (neni 30). Siç mund të kuptohet lehtësisht, kushtetuesi kolumbian ka krijuar me këtë aksion dhe gjykim mbrojtjeje të lirisë, duke qenë se *habeas corpus*-i ka të njëjtën natyrë me aksionin e mbrojtjes kushtetuese¹⁶⁹ kundër çdo akti të lëshuar nga autoriteti gjyqësor, përfshirë edhe vendimet, me qëllim kërkimin e lirisë personale në ato raste në të cilat mendohet se liria është hequr në mënyrë të padrejtë.

Duhet kujtuar eksperiencia meksikane e *amparo*-s si e drejtë, aksion, rekurs apo gjykim edhe i *habeas corpus*-it. Në ushtrimin e kësaj të drejte dhe mbrojtjeje kolumbiane, çdo person mund të pretendojë përpara autoritetit gjykues, në çdo moment dhe vend, nëpërmjet një procedimi preferencial dhe të përmbledhur, mbrojtjen imediate të të drejtave të tij kushtetuese themelore, atëherë kur këto jenë shkelur ose kërcënuar nga veprimi apo mosveprimi i çdo autoriteti publik. Mbrojtja gjyqësore konsiston në një vendim, i cili vepron ndaj atij që kërkon mbrojtjen.

Vendimi është ekzekutiv dhe përmbushet direkt, por mund të apelohej pranë gjykatës kompetente dhe, në këtë rast, kjo e fundit ia dërgon Gjykatës Kushtetuese për një rishikim të mundshëm. Duke qenë se kemi të bëjmë me një gjykim preferencial dhe të përmbledhur, në asnjë rast nuk mund të kalojnë më shumë se 10 ditë nga kërkesa e mbrojtjes ose *amparo* e të drejtës dhe zgjidhja e tij.

¹⁶⁸ Me të njëjtat forma ligjore esenciale të përmendura më parë në Kartën Venezuelane.

¹⁶⁹ Risia e tekstit kushtetues kolumbian të vitit 1991, neni 86.

Në fushën procesuale, duhet nënvijezuar fakti se, si nga pikëpamja kushtetuese dhe ajo ligjore, ashtu dhe nga ajo e zhvillimit jurisprudencial, ushtrimi i mbrojtjes ose i *amparo*-s ka qenë i kushtëzuar nga detyrimi i paraqitjes në gjykatë të një shtate konkrete dhe specifike të shkeljes apo cënimit të të drejtave themelore, nga ana e çdo autoriteti publik¹⁷⁰. Gjithashtu, kërkuksi duhet të ketë një interes juridik dhe të kërkojë mbrojtjen jurisdikcionale, gjithnjë në mungesë të mjeteve të tjera gjyqësore për mbrojtjen.

Duke përdorur analogjinë, duhet kujtuar që nga pikëpamja kushtetuese *habeas corpus*-i, ashtu si të drejtat e tjera themelore të njeriut, gëzon një aplikim të menjëhershëm, domethënë ka supremaci mbi arsyen shtetërore, historikisht e përmendur nga autoriteti për të kufizuar ushtrimin e të drejtave dhe lirive të personit, në mbrojtje të vlerave abstrakte dhe të nocioneve si morali, rendi publik dhe interesi i përgjithshëm. Kjo do të thotë që, sipas jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese Kolumbiane¹⁷¹, këto të drejta për ushtrimin e tyre nuk kushtëzohen nga asnjë rregullorë legjislativë, nuk mund të pezullohen as gjatë gjendjeve të jashtëzakonshme, ose të emergjencës dhe mund të kërkojnë në çdo moment¹⁷².

Sistemi kushtetues kolumbian i vitit 1991 parashikon, gjithashtu, një organ mbrojtjeje të të drejtave të njeriut dhe interesave kolektive, *Difensore del Popolo*, që numëron mes funksioneve të tij të shumtë atë të referimit të së drejtës së *habeas corpus*-it dhe ushtrimin e aksionit të mbrojtjes ose *amparo*-s, pa paragjykimet e së drejtës që u takon të interesuarve¹⁷³. Gjithashtu, Prokurori i Përgjithshëm i Kombit, titullar i *Procuraduria General de la Nación*, organ që nuk duhet shkëmbyer me institutet homonime të vendeve europiane, si për shembull Italia, në ushtrimin e funksioneve thelbësore ka

¹⁷⁰ Kushtetuta kolumbiane ka parashikuar edhe aksionin kundër privatëve kur ata janë përgjegjës për dhënien e një shërbimi publik ose kur sjellja e tyre prek rëndë dhe drejtpërdrejt interesin kolektiv (neni 86, pika e fundit).

¹⁷¹ Mbi këtë temë, Gomez Sierra F. (2003), *Constitucion Politica de Colombia Anotada*, Bogotá, Leyer, fq 114.

¹⁷² Vendimi T - 403 date 3 qershor viti 1992.

¹⁷³ Neni 282, pika 3.

edhe atë të mbrojtjes së të drejtave të njeriut duke siguruar efektivitetin, me ndihmën e Avokatit të Popullit¹⁷⁴.

Gjithashtu, gjithnjë në lidhje të ngushtë me *habeas corpus*-in, Kushtetuta kolumbiane parashikon ndalimin e krimit të zhdukjes së sforcuar të personave, të torturave dhe dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose degraduese¹⁷⁵.

Në përfundim, teksti kushtetues kolumbian, nga pikëpamja formale, është i mirazhornuar dhe, nëse konsiderojmë që është miratuar përpara kartave të tjera kushtetuese të Shteteve të Komunitetit Andin të Kombeve, si dhe të pjesës më të madhe të teksteve ekzistuese të vendeve të tjera të Amerikës Latine, mund të deduktohet që është i servirur si një model veçanërisht në fushën e të drejtave të njeriut dhe të garancive kushtetuese.

Mbi bazën e këtyre konsideratave lidhur me të drejtat dhe garancitë e lirisë në Amerikën Latine, më saktësisht *Habeas Corpus*, ose aksioni *Exhibición Personal*, mund të formulohen disa konsiderata mbi aspektet më karakteristike dhe rregulla të përgjithshme në lidhje me shtrirjen e mbrojtjes së të drejtave, pluralitetit të subjekteve procesuale titullare të aksionit, për efektet e tyre jo vetëm në fushën procesuale penale, por edhe procesuale kushtetuese, veçanërisht në eksperiencën më të vonshme dhe mbi ekzistencën e garancisë gjatë periudhave të gjendjeve të jashtëzakonshme, emergjente, ose përjashtimeve kushtetuese.

Siç u tregua nga analiza e kryer, në fushën e të drejtave dhe lirive të mbrojtura nga Habeas Corpus-i, në Amerikën Latine mund të thuhet që në radhë të parë garantohet e drejta apo liria fizike ose personale dhe e drejta e lëvizjes dhe e qarkullimit, në rastin e heqjes së lirisë në mënyrë arbitrare, ose pa respektimin e formaliteteve procesuale ose kufizimit të lirisë. Me këtë garanci mbrohet edhe personi kundër çdo forme ofendimi, kushti, kohe apo vendi të burgimit të paligjshëm dhe, së fundmi, duke qenë se tipologjia e veprës penale është e re, aplikohet edhe kundër zhdukjes së forcuar të mundshme të personave, ose kundër persekutimit nga ana e autoriteteve të privatëve. Në mënyrë analoge, instituti mbron të drejtën e integritetit personal kundër dhunës fizike, psikike

¹⁷⁴ Neni 277, pika 2.

¹⁷⁵ Neni 12.

ose morale. Së fundmi, një karakteristikë me rëndësi të madhe qëndron në faktin se garancia latino-amerikane përdoret edhe si një instrument efikas ndaj sjelljes së çdo autoriteti, funksionari ose personi, që shkel ose kërcënon lirinë personale ose të drejtat kushtetuese të përmendura.

Mbi bazën e teksteve kushtetuese dhe ligjeve që zhvillojnë parimet kushtetuese të *Habeas Corpus*-it në Amerikën Latine, mund të dalim në përfundimin se kjo garanci shërben për t'u mbrojtur kundër shkeljeve dhe për të rivendosur të gjitha të drejtat e *due process of law*; sigurimin e lirisë së ndërgjegjes, opinionit dhe bindjeve ideologjike; shmangjen e përjashtimit nga shoqëria; garantimin e azilit politik; mospërfundimin në izolim me përjashtim të rasteve dhe për periudhën minimale të përcaktuar nga ligji; shmangien e burgimit për shkak të borxheve; sigurinë e pajisjes me pasaportë ose kartë identiteti, brenda dhe jashtë vendit; përmbushjen e vendimeve gjyqësore të dhënies së lirisë, pafajësisë, arkivimit, parashkrimit të veprës penale ose ekzekutimit të dënimit, dhe vendimet politiko-administrative të amnistisë së faljes.

Për sa u përket subjekteve procesuale, titullare të aksionit ose rekursit, siç patëm mundësi të konstatojmë, *Habeas Corpus*-i në Amerikën Latine karakterizohet nga shtrirja dhe pluraliteti i tij, nëse marrim në konsideratë cënimin apo kërcënimin e të drejtave të tij, por çdo person ose grup personash -garantë të të drejtave të njeriut -, pa qenë nevoja për një prokuror. Mund të paraqesë rekurs një person i tretë, që përfaqëson formalisht subjektin procesual ose personi i cili ka nevojë për mbrojtjen e të drejtave të lirisë dhe, në mënyrë analoge, familjarët e tij, ose ata që kanë pasur lidhje me të. Pluraliteti që lidhet me subjektet e garancisë zgjerohet nëse kujtojmë institutin e quajtur Ombudsman, Komisari Parlamentar, ose Avokati i Popullit, ka gjithnjë të drejtë të nisë rekursin. Në të gjitha rastet procesuale, cilido qoftë subjekti kërkues, mekanizmi i mbrojtjes së të drejtës nis të funksionojë pa qenë nevoja që organet gjyqësore të ndryshojnë procedimin, efektet në lidhje me titullarin e të drejtës për t'u mbrojtur ose pasojat për autoritetet ose funksionarët e përfshirë në gjykim, aksion apo rekurs.

Nga pluraliteti i subjekteve që mund të ngrenë aksionin dhe nga detyrueshmëria e domosdoshme e funksionimit gjyqësor-procesual, pa limitin e lidhje me kërkesat e legjitimitetit ose kualifikimit të subjektit kërkues, mund të deduktohet se garancia e

Habeas Corpus-it në Amerikën Latine ka një karakter veprimi publik, pikërisht për të evituar që kushtet e kufizimit të lirisë të ndalojnë ose anulojnë elementin esencial të garancisë kushtetuese, që është vlefshmëria permanente. Në këtë fushë teorike dhe praktike, mbrojtja e të drejtave të lirisë nëpërmjet *Habeas Corpus*-it në Amerikën Latine fiton karakterin e elementit formues të rendit publik. Si rrjedhojë, në përfundim, bëhet fjalë për mbrojtjen e supremacisë së Kushtetutës në fushën e të drejtave më elementare dhe themelore, siç janë ato të lirisë personale e të lidhur me to, përgjegjësia e ushtrimit të së drejtës - përgjegjësi të aksionit të *Habeas Corpus*-it është e të gjithëve.

Për këtë arsye, u drejtohet efekteve të aksionit të *Habeas Corpus*-it, është natyrale që procesi të lidhet me lirinë e subjektit të cilit i është hequr liria në mënyrë arbitrare apo të paligjshme. Gjithashtu, janë të rëndësishme edhe efektet kushtetuese të *Habeas Corpus*-it që, siç patëm mundësi të konstatojmë, fokusohen në mbrojtjen e supremacisë së Kushtetutës së të drejtave të njeriut, dhe kujtojmë që në Amerikën Latine traktatet ndërkombetare, veçanërisht ato në fushën e të drejtave dhe lirive, janë pjesë e të drejtës së brendshme dhe formojnë të ashtuquajturin *bllok kushtetues*, me detyrueshmërinë dhe aplikimin imediat nga ana e autoriteteve dhe privatëve.

Deri në epokën më të afërt fusha institucionale dhe funksionimi i *Habeas Corpus*-it ishin të kufizuar ekskluzivisht në fushën penale, kompetencave të gjyqtarit penal, procesit penal, funksioneve të policisë gjyqësore dhe kodit të procedurës penale. Aktualisht, aksioni, rekursi dhe gjykimi janë pjesë e kushtetutës, janë zhvilluar deri në transformimin në garanci kushtetuese, siç patëm mundësi të tregojmë. Nëse këtij fenomeni i shtohet perfshirja kushtetuese e traktateve ndërkombetare në fushën e të drejtave të njeriut dhe mbrojtja e tyre ndërkombëtare, rajonale dhe nënrajonale, nuk ka dyshim që në Amerikën Latine *Habeas Corpus*-i është bërë pjesë e temave të mëdha të drejtësisë kushtetuese. Është e qartë që për momentin përjetohet epoka e parë e këtij zhvillimi juridiko-politik, por dinamizmi është i konsiderueshëm, siç mund të kujtojmë karakterin e rendit publik të rekursit. Esencën e një aksioni popullor, që në mënyrë progresive është imponuar në këtë kontinent.

Në studimin e drejtësisë kushtetuese në Amerikën Latine, pranë *amparo*-s, aksionit popullor të antikushtetueshmërisë dhe *habeas data*-s, duhet patjetër të përfshijmë edhe *habeas corpus*-in.

Nuk është i rëndësishëm fakti që gjyqtari kompetent deri më sot ka qenë ai i fushës penale, të paktën për fazat e para të procesit. Edhe në këto raste, gjyqtari penal, duke u bazuar te karakteri i përhapur i kontrollit të legjitimitetit kushtetues të ligjeve dhe akteve administrative, nuk është vetëm gjyqtar i ligjeve por, mbi të gjitha një gjyqtar i kushtetutës dhe, si rrjedhojë, i të drejtave dhe garancive kushtetuese.

Në një sistem kontrolli të kësaj tipologjie, mund të pohojmë se nuk është i nevojshëm krijimi i një gjyqtari kushtetues për fazat e para të procesit kushtetues, sepse ekziston gjyqtari i cili ka edhe funksione dhe kompetenca të tilla. Gjithashtu, në fazën e fundit të procedimeve të *habeas corpus*-it, ashtu si për garancitë e tjera kushtetuese, prej kohësh, kompetencën e kanë Gjykata e Lartë ose Seksioni Kushtetues i kësaj të fundit, Gjykatat ose Gjykatat Kushtetuese. Nga ana tjetër, nuk janë të pakta vendet e Amerikës Latine që ndjekin institutin antik të *amparo*-s së lirisë, duke iu referuar fushës së drejtësisë kushtetuese dhe, si rrjedhojë, të drejtës procesual-kushtetuese.

Në lidhje me *habeas corpus*-in, gjendjet e emergjencës ose përjashtimeve kushtetuese, siç konstatuam, akoma edhe sot paraqitet në disa vende fenomeni i papërputhshmërisë funksionale. Nëse deklarohet gjendja e jashtezakoshme pezullohen të drejtat e lirisë dhe duke konsideruar që kushtet politike, ekonomike dhe shoqerore janë në gjendje të vazhueshme emergjence, keto të drejta dhe garancia e tyre kushtetuese mund të gjenden në vështirësi të qëndrueshme.

Për këtë arsye, është tendenca e kufizimit për një kohë të gjatë të periudhave të emergjencës, për zgjerimin e kontrolleve politike nga ana e legjislativit dhe forcimi i kontrollit juridiksional, në ngarkim të seksionit kushtetues të Gjykatës ose Gjykatës Kushtetuese, nga deklarimi i gjendjes së emergjences nga ana e legjislativit ose ekzekutivit, që e ka prejardhjen nga deklarimi i sipërpërmendur. Për më tepër, tendenca e të drejtës publike latino-amerikane në këtë fushë është e drejtuar drejt një ndalese të rreptë kushtetuese për ndërprerjen e garancive kushtetuese gjatë gjendjeve të emergjencës kushtetuese.

Në këtë tendencë ecin edhe parashikimet kushtetuese kolumbiane të vitit 1991, që janë marrë si shembull nga të gjitha eksperiencat e tjera shtetërore, që shprehimisht parashikojnë dispozita të përgjithshme, të cilave duhet t'u nënshtrohen deklarata dhe ushtrimi i të drejtave gjatë gjendjeve të jashtëzakonshme. Mes dispozitave dallohet parashkrimi mbi bazën e të cilit gjatë gjendjes së emergjencës nuk mund të pezullohen të drejtat e njeriut, as liritë themelore, në bazë të të cilave, në çdo rast, duhet të respektohen normat e së drejtës ndërkombëtare humanitare. Në të njëjtën kohë, vendoset që Gjykata Kushtetuese duhet të ushtrojë një kontroll automatik të kushtetueshmërisë së deklaratës së gjendjeve të jashtëzakonshme, ashtu si edhe për ushtrimin e pushteteve që kanë prejardhjen nga kjo deklaratë dhe që janë të parashikuara në mënyrë taksative nga Kushtetuta¹⁷⁶.

Për fat të keq, në realizimin e shtetit të së drejtës, ka shtete latino-amerikane, kushtetutat e të cilave autorizojnë ndërprerjen e garancive të *habeas corpus*-it dhe të të drejtave të lidhura me të, gjatë gjendjeve të emergjencës, edhe pse mund të tregohet një tendencë garantiste. Për fat të keq, për progresin e shtetit të së drejtës, forcat politike kundërshtare në këtë aspekt, përgjithësisht forca konservatore që kundërshtojnë institucionet liberal-demokratike, kanë nga ana e tyre shembullin negativ të disa shteteve të konsideruara demokratike dhe liberale, si dhe të një pjese të madhe të kulturës juridike, si Shtetet e Bashkuara të Amerikës, që e kanë bërë pjesë të kushtetutes ndërprerjen e garancisë së *habeas corpus*-it dhe të të drejtave të tjera të lirisë gjatë gjendjeve të jashtëzakonshme, dhe praktikisht e përdorin si një instrument lufte kundër monorancave dhe të huajve¹⁷⁷.

Amerika Latine, në gati dy shekuj pavarësi, nuk ka pasur stabilitet institucional dhe politik, që do t'i kishte lejuar materializimin e shtetit të së drejtës dhe, megjithatë, me shumë sforco, gjatë kohëve të fundit, ka tentuar dhe vazhdon të tentojë të ndërtojë. Në fushën e mbrojtjes dhe garantimit të të drejtave kushtetuese, efektet e mungesës së

¹⁷⁶ Shiko nenin 214.

¹⁷⁷ Mjafton të citojmë politikat e F.B.I-së., policisë sekrete të investigimeve, në veçanti në emrin e drejtorit të famshëm Huver; makartizmi, që përfaqësoi kulmin e Luftës së Ftohtë në politikën e brendshme të USA dhe normativat aktuale dhe politikat shtypëse të brendshme dhe të jashtme të kontrollit antiterrorist të adoptuara pas 11/9/2001.

stabilitetit janë përkthyer në anormalitet, janë të vazhdueshme, gati permanente, gjendje emergjence ose të jashtëzakonshme.

Për fat të mirë, në dy dhjetëvjeçarët e fundit është kuptuar që demokracia dhe stabiliteti institucional janë të mundur vetëm nëse respektohen të drejtat e njeriut dhe të drejtat e lirisë. Shpeshherë, për këtë arsye është konstatuar një punë e konsiderueshme kushtetuese që ka sjellë, pranë procesit gjyqësor, që përdoret në përgjithësi për të siguruar supremacinë e Kushtetutës dhe, në veçanti, për mbrojtjen e pjesës së saj dogmatike, një zhvillim të konsiderueshëm të procedimeve të posaçme, të shkurtra dhe të përmbledhura, informale, preferenciale dhe, si rrjedhojë, të një efikasiteti të lartë. Për shembull, këto procedime janë ato që aplikohen në aksionet, rekursin dhe gjykimet e *habeas corpus*-it, *amparo*-s dhe *habeas data*-s, të cilat janë komplementare deri në formimin e një sistemi integral në mbrojtje të të drejtave themelore dhe kushtetuese, që mund t'i quajmë me të gjithë kuptimin e fjalës latino-amerikane.

3.8 Habeas Data kushtetuese: Garancia e re juridiksionale

Nga panoramika që i parashtrohen konceptit të *habeas data*-s në Amerikën Latine, mund të bëhen disa konsiderata të përgjithshme dhe të arrihet në disa përfundime. Mbi të gjitha, eksperiencia latino-amerikane në fushën e *habeas data*-s konfirmon gradën e konsiderueshme të integritetit juridik të arritur, mbi të gjitha në të Drejtën Publike, me një sforcim që lind të paktën nga fundi i diktaturave të viteve '70-'80. Evidenca e integritetit jupublicistik latino-amerikan vërehet nga studimi i krahasuar i sistemeve të kontinentit, veçanërisht në fushën e formës së shtetit dhe qeverisjes; katalogu i të drejtave dhe garancive kushtetuese; drejtësia kushtetuese dhe administrative; institutet dhe organet e kontrollit; institutet e demokracisë dhe pjesëmarrjes; mekanizmat e qeverisjes së ekonomisë; integrimi politik dhe ekonomik rajonal dhe marrëdhëniet e hierarkisë dhe supremacisë së të drejtës ndërkombëtare mbi atë të brendshme, dhe në fushën e procedimeve të rishikimit, amendamentit dhe reformës kushtetuese.

Instituti i *habeas data*-s, së bashku me rekurse dhe garanci kushtetuese të tjera, si për shembull *habeas corpus*, *amparo* dhe aksioni publik i kushtetueshmërisë, bëhet një emërues i përbashkët, përfaqësues i evolvimit juridik më të ri latino-amerikan. E njëjta

gjë mund të pohohet për institutet kushtetuese si Contralor General, Defensor del Pueblo dhe Poder Electoral, si organe të së drejtës publike latino-amerikane, të një rëndësie të madhe për strukturimin dhe funksionimin e shtetit modern të së drejtës.

Nga ana e juristëve dhe studiuesve të së drejtës publike të krahasuar, ka shumë kritika që mund të bëhen për Ameriken Latine, mbi të gjitha lidhur me mungesën e lidhjes mes kushtetutës formale dhe asaj materiale. Mes formës dhe përmbajtjes reale të shtetit të së drejtës. Shumë nga kritikët janë të bazuara, nëse konsiderojmë që përballë impenjimit të klasës politike për të modernizuar strukturat juridike dhe politike të shteteve, mungon kompromisi i shpeshtë për vënien në punë të reformave. Mungesë që zbeh shpeshherë sforcimin e bërë për ndërtimin e shtetit kushtetues modern. Kritikët, në çdo rast, nuk mund të mohojnë ose zvogëlojnë sforcimin që shtetet latino-amerikane bëjnë me objektivin e zhvillimit, modernizimit dhe azhurnimit të sistemeve të tyre kushtetuese. Një provë mbi të gjitha, të drejtat, rekursët dhe garancitë kushtetuese, si në këtë rast i *habeas data*-s.

Siç patëm mundësi të konstatojmë nga eksperiencat e ndryshme që analizuam, natyra juridike e *habeas data*-s në Amerikën Latine i korrespondon në thelb asaj të së drejtës kushtetuese, e krijuar për mbrojtjen e të drejtave të tjera. Ushtrohet, si rrjedhojë, nëpërmjet një aksioni kushtetues, ose të një rekursi gjyqësor për të ndaluar shkeljen ose për të rivënë një të drejtë të shkelur. Në këtë rast, e drejta kushtetuese e mbrojtjes së të dhënave personale, që përfshin të drejtën e intimitetit, ruajtjes, lirinë e vetëvendosjes informatike, të garantuara me aksionin ose rekursin e drejtuar nga titullari i të drejtës drejt gjyqtarit kompetent, që në disa eksperiencë është po vetë gjyqtari kushtetues.

Eksperiencia latino-amerikane në këtë fushë lejon kuptimin e disa tipologjive të *habeas data*-s¹⁷⁸. Doktrina dhe jurisprudenca akordojnë në faktin se kemi dy tipologji të mëdha: *habeas data proprio* dhe *improprio*. I pari për mbrojtjen e të dhënave personale, i dyti për t'u njohur me informacionet publike me interes të përgjithshëm, kolektiv. E drejta e aksesit në bankat e të dhënave, arkivave dhe regjistrave publike ose private të mbledhjes së informacioneve personale, me qëllim verifikimin e vërtetësisë, qëllimin e mbledhjes dhe, si rrjedhojë, aksesin në korigjimin e tij, azhurnimit, anulimit apo fshirjes ose

¹⁷⁸ O. Puccinelli, *El habeas*, 220 - 225.

ndalimit të qarkullimit ose përhapjes, bazohet mbi disa nëntipologji *habeas data proprio*.

Në këtë kuptim, kushtetueshmërisht parashikohen këto nëntipologji: 1. Informative, për aksesin informatik dhe atë finalistik, për të njohur qëllimin e mbledhjes informatike dhe të autorësisë, për të njohur përgjegjësin e mbledhjes së informacionit. 2. Azhornues ose përfshirës të informacionit në mënyrë që të kompletojë mbledhjen. 3. Rishikimi ose korrigjimi për të pasur një informacion sa më të vërtetë. 4. Përfshirës ose fshirës, për të anuluar faktin që në bankat e të dhënave, arkivave ose regjistrave të jenë informacione të mbledhura pa të drejtë ose pa një finalitet të ligjshëm. 5. Ruajtës, për të ndaluar që të dhënat e mbledhura në mënyrë legjitime, por me një akses të kufizuar, të shpërndahen pa të drejtë të tretëve, pa autorizimin e titullarit.

Të lartpërmendurit janë nëntipologjitë kryesore të *habeas data*-s të parashikuara kushtetueshmërisht në pjesën më të madhe të vendeve të Amerikës Latine. Këtyre u shtohen të tjerë, që kanë prejardhjen ose janë konfirmuar nga ligji ose nga jurisprudenca.

Habeas data latino-amerikane, si aksion apo rekurs kushtetues, shkon paralelisht me *amparo*-n. Në këtë kuptim, aplikimi i tij bëhet shumë i thjeshtë, i shpejtë dhe i drejtpërdrejtë. Shtetasit nuk i kërkohet tipologjia e *habeas data*-s që dëshiron të aplikojë në mbrojtje të të drejtave të tij informatike. Duhet vetëm të kërkojë mbrojtjen e të drejtës së tij, të cënuar apo të shkelur, për të pasur një ndërhyrje urgjente nga ana e gjyqtarit.

Për sa u përket të mirave juridike të mbrojtura, edhe këtu doktrina dhe jurisprudenca konfirmojnë interpretimin gjenetik të normave. Pra, *habeas corpus proprio* nis nga mbrojtja e të drejtës së vetëvendosjes informatike dhe informuese, për t'u zgjeruar më tej në mbrojtjen e të dhënave personale, në mbrojtje të intimitetit personal dhe familjar dhe së bashku me parimet dhe vlerat që identifikohen me lirinë, barazinë, dinjitetin, nderin, reputacionin dhe imazhin. *Habeas data improprio* mbron të drejtën e aksesit në informacionin publik ose shtetëror, për të garantuar të drejtën e pjesëmarrjes qytetare demokratike dhe transparencën në procedimet politike dhe administrative si dhe një mekanizëm i aftë për të gjetur përgjegjësit e vendimeve.

Subjektet aktive dhe pasive janë qartësisht të vendosura nga normat, nga interpretimi dhe përpunimi jurisprudencial. Në këtë kuptim, të parët janë persona fizikë dhe juridikë, pa asnjë dallim, avokati ose ombudsman i të drejtave, shoqatat që mbrojnë të drejtat kolektive. Të dytët, bankat e të dhënave, arkivat dhe regjistrat elektronike ose manuale, publike apo private, të përgjegjshme për mbledhjen dhe përpunimin e informacioneve dhe të dhënave personale. Natyrisht, ka edhe disa diferenca të holla nga sistemi në sistem, siç mundëm të konstatojmë, por tendenca e piketimit të subjekteve aktive dhe pasive të *habeas data*-s shkon drejt uniformimit të mënyrës së sipërtreguar.

Aspektet procesuale të aksionit apo rekursit të *habeas data*-s në përfundim mund të pohojmë se, në përgjithësi, aplikohen normat e mbrojtjes ose të amparo-s kushtetuese¹⁷⁹. Në këtë kuptim:

1. Çdo person, pa dallime ose diskriminime, mund të veprojë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo indirekte, me apo pa avokat ose prokuror.
2. Kërkesa, në rast minorenësh, analfabetësh ose persona në kushte nevojë ose pa mjete mbrojtëse, mund të paraqitet pranë Avokatit të Popullit ose shoqatave në mbrojtje të të drejtave.
3. Rekursi mund të paraqitet edhe gjatë gjendjeve të jashtëzakonshme kushtetuese.
4. Të gjithë gjyqtarët - në disa raste si për shembull në Kosta Rika, gjyqtarët kushtetues - të vendit ku manifestohet shkelja ose cënimi i të drejtave, janë kompetente të marrin dhe të japin vendim mbi rekursin. Vetëm në Brazil ekziston dallimi mes gjyqtarit kompetent sipas kualifikimit të personit, ose të autoritetit kundër të cilit ushtrohet rekursi.
5. Kërkesat formale dhe esenciale të aksionit janë: piketimi i të drejtës që konsiderohet e shkelur ose e cënuar; relatimi i aktit dhe i rrethanave që provokojnë kërkesën; emri i personit fizik apo juridik ose i autoritetit, autori i mundshëm i shkeljes apo cënimit; gjeneralitetet, identiteti dhe vendbanimi i kërkuarit.
6. Procedimi i aksionit parashikon kryerjen në formë publike, me supremaci të së drejtës substanciale, ekonomisë procesuale, shpejtësisë dhe efikasitetit. Me fjalë të tjera, duhet të respektojë të drejtën e mbrojtjes, parimet e kontradiktoritetit dhe të publicitetit të

¹⁷⁹ ROZO ACUNA E, *La Tutela*, fq 223 - 228.

vendimeve. Gjyqtarët duhet t'i japin përparësi mbrojtjes së të drejtës dhe jo aspekteve formale të termave apo kërkesës. Procesi duhet të arrijë në një vendim të formës së prerë në një kohë të shkurtër. Gjykimi duhet të jetë i shkurtuar dhe përmbledhës, me data dhe afate të pandryshueshme dhe urdhëruese.

7. Gjyqtari, me vendimin e tij, mund të vendosë pranimin ose rrëzimin e kërkesës. Në rastin e parë, gjyqtari merr një vendim me që ka vlerë vetëm për palët. Nëse autoriteti ose privati konsiderohen të fajshëm, duhet të përmbushin vendimin në mënyrë imediate.

8. Vendimet mund të apelojnë brenda disa ditëve - zakonisht 3 - nga njoftimi, që duhet të bëhet brenda 24 orëve nga marrja e vendimit. Vendimi duhet të merret zakonisht brenda 20 ditëve nga marrja e praktikës.

9. Vendimi i rishikimit, që revokon apo modifikon vendimet e shkallës së parë, duhet të motivohet, kurse të tjerat mund të justifikohen shkurtimisht. Gjithashtu, duhet të njoftohen në mënyrë të shpejtë jo më vonë se e nesërmja e marrjes së vendimit.

10. Me vendimin e marrë dhe të njoftuar, autoriteti ose privati i përgjegjshëm, duhet ta përmbushë atë pa kundërshtime. Nëse nuk ndodh kështu, gjyqtari, në mënyrë direkte, i dërgon kërkesë përgjegjësit;

11. Përveç pezullimit të aplikimit të aktit konkret, gjyqtari, kryesisht ose me kërkesën e palëve, mund edhe të disponojë çdo masë mbrojtjeje ose sigurie që i adresohet mbrojtjes së të drejtës, për të evituar në këtë mënyrë prodhimin e dëmeve të tjera si pasojë e fakteve të kryera, gjithnjë konform rrethanave të rastit.

12. Likuidimi i dëmit të shkaktuar dhe i paragjyqimeve të tjera do të kryhet në një gjykim administrativ, domethënë përpara gjyqtarit kompetent, sipas një procedure të posaçme brenda gjashtë muajve pasardhës.

13. Nëse gjyqtari vlerëson që fakti është kryer me dashje ose me faj të rëndë, fajtori do të dënohet, bashkë me institucionin përkatës, të shlyejë dëmin e shkaktuar, si dhe shpenzimet gjyqësore.

14. Lejohet heqja dorë e kërkuarit, dhe në këtë mënyrë procesi arkivohet, duke u hapur më tej për të treguar mungesën e respektimit të kërkesës.

Në përfundim të këtij shënimi, duhet theksuar fakti se me këtë garanci kushtetuese të *habeas data-s*, e drejta publike latino-amerikane jo vetëm pasurohet, por ofron një

kontribut të vlefshëm në të drejtën publike në përgjithësi. Shteti i së drejtës, gjithashtu, fiton një institut efikas për mbrojtjen e të drejtave themelore dhe, si rrjedhojë, perfeksionohet gjithnjë e më shumë.

Mund të ngrihen disa kritika, si për shembull mungesa e uniformimit që provokon disa ngatërresa terminologjike dhe konceptuale me rrjedhojë kufizimin funksional të institutit. Realiteti dominues paraqet një tendencë për homogjenizim institucional falë përfshirjes në rang kushtetues të garancisë, gjë që nënkupton precizimin normativ dhe përmbajtjen. Gjithashtu, adoptimi i gjeneralizuar i procedimit që shoqëron gjykimin e *amparo-s* ose mbrojtjes, si parim procesual thelbësor të aksionit të *habeas data-s*, forcon institutin dhe e bën më efikas.

Kritikët mund të theksojnë se *habeas data* në Amerikën Latine përfaqëson një shembull tjetër të reformave dhe ndryshimeve të bëra në letër, të shpeshta në këtë kontinent. Kritika mund të ketë të drejtë, ashtu siç zakonisht kanë të drejtë ata që bëjnë dallimin mes normës në kuptimin formal dhe material. Realiteti kushtetues i këtyre vendeve, megjithatë, paraqet, ashtu siç ndodh në përgjithësi me gjithë katalogun e të drejtave themelore, një praktikë më e theksuar, një tendencë për një arsimit shoqëror të shtetasve nëpërmjet ushtrimit dhe respektimit të vetë personit. Jurisprudenca e konsiderueshme dhe doktrina në fushën e *amparo-s* ose mbrojtjes, ashtu si në fushën e *habeas data-s*, ndihmojnë në konfirmimin e zhvillimit politik që po arrihet në Amerikën Latine falë rinovimit dhe progresit të së drejtës publike.

Kapitulli IV: SHQIPËRIA MES TË DREJTAVE DHE GARANCIVE

Për sa u përket të drejtave dhe lirive, Shqipëria ndjek skemën e pjesës më të madhe të kushtetutave lindore, që paraqesin një sërë thëniesh me tipologji të përgjithshme, të cilat shpeshherë janë trajtimi dhe plotësimi i Parimeve Themelore. Bëhet fjalë për parimin e barazisë, afirmimit të lirisë, si të mira themelore dhe limitet që disa herë duhet të përballojnë, të shtetësisë, të situatës së të huajit, minorancave, marrëdhënieve mes të drejtës së brendshme me atë ndërkombetare apo komunitare. Sa më sipër, me përjashtim të marrëdhënieve të së drejtës së brendshme me atë ndërkombetare apo komunitare, trajtohen në Titullin I, Pjesa II të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

4.1 Disa kufizime të lirive dhe të drejtave individuale në Kushtetutën e RSH

Në fakt, për nenin 117, kufizimet e të drejtave dhe lirive lejohen nëpërmjet një klauzole elastike, që konsiston në referimin tek një ligj i justifikuar nga interesi publik, bilancohen nga respektimi nga një anë i kriterit të proporcionalitetit dhe, nga ana tjetër, nga përmbajtja esenciale e të drejtës dhe lirive dhe nga moslejimi i çdo pakësimi të tyre që tejkalon sa parashikon Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut. Duhet thënë se shumë të drejta themelore mbrohen edhe në rastet kur vetë kushtetuta vendos kufizime, si për shembull gjatë gjendjeve të jashtëzakonshme, fatkeqësive natyrore apo gjendjes së luftës. Të huajt duhet të kenë të njëjtin trajtim si shtetasit shqiptarë, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe. Katalogu i të drejtave është i gjerë, i detajuar dhe i azhornuar, në linjë me standardet ndërkombëtare, në mënyrë që të konfigurohet një shtet jo vetëm i "së drejtës", por edhe "kushtetues". Parashikohen, ashtu se në kushtetutat lindore në përgjithësi, të drejta të reja të quajtura të "gjeneratës së tretë", që lidhen me mjedisin, mbrojtjen e të dhënave personale, informacioneve mbi aktivitetin e organeve shtetërore, respektimin e afatit të vendosur nga ligji për përgjigjet e organeve publike ndaj kërkesave të qytetarëve, të drejtës së autorit etj.

Pjesa e V-të e Kushtetutes i dedikohet Këshillit të Ministrave. Sipas nenit 101, "Këshilli i Ministrave, në rast urgjence, mund të lëshojë nën përgjegjësinë e tij akte normative me

fuqinë e ligjit për të adoptuar masa të përkohshme. Këto akte normative i nënshtrohen drejtpërdrejt dhe menjëherë Parlamentit, i cili mbidhet në seancë plenare brenda 5 ditësh. Këto akte e humbin forcën e tyre nëse nuk miratohen brenda 45 ditësh nga Parlamenti". Në aplikimin tranzitor të Kartës Kushtetuese të vitit 1991, duke iu referuar nenit 2 të Kartës Shqiptare të të Drejtave të Njeriut mbi lirinë e shprehjes, detyrimin e vendosur nga Këshilli i Europës për t'iu përshtatur standardeve të parashikuara nga Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ) solli risinë e një dispozite që pasqyronte nenin e Konventës, por me garanci më të limituara, duke e krahasuar me projektin origjinal dhe të papërputhshëm me nenin 41 të Kushtetutës Shqiptare, i cili trajtonte ndalimin e kufizimit të një liste të drejtash themelore gjatë gjendjeve të jashtezakonshme. Antinomia normative u zgjidh në mënyrë dramatike nga Gjykata Kushtetuese Shqiptare, e cila vendosi mbi legjitimitetin kushtetues të ligjit me anë të të cilit u shpall gjendja e emergjencës në vitin 1997. Gjykata e deklaroi të ligjshëm parashikimin mbi bazën e nevojës së koordinimit të dy dispozitave të neneve 2 dhe 41, të cilat hynë në fuqi në mënyrë simultane për këtë arsye, nga e njëjta ratio¹⁸⁰.

Marrëdhënia mes organizatave ndërkombëtare dhe e drejta e brendshme duhet të mbeten të bazuara në një skemë konsulence, mbi marrëdhënien teknike, pa arritur kurrë në eliminimin e diskrecionalitetit të organeve politike të brendshme¹⁸¹.

4.2 Rekursi individual në Gjykatën Kushtetuese Shqiptare

Në vendin tonë, Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje në tri mënyra të ndryshme: me anë të kërkesës së autoriteteve publike; me anë të kërkesës së gjyqtarëve të zakonshëm dhe me anë të kërkesës së individëve.

Në rastin e parë, kjo e drejtë ushtrohet nga organet më të larta qeverisëse të pushtetit qendror dhe atij vendor, si për shembull Presidenti i Republikës, Kryeministri, parlamentarët (jo më pak se 1/5 e tyre), Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe

¹⁸⁰ K. Imholz, "States of emergency as pretext for gagging the press; ward play at Albania's Constitutional Court, in East European Constitutional review, 4/1997".

¹⁸¹ S. Bartole, Final Remarks: The role of Venice Commission, in review of Central and East European Law, 3/2000, 351 e vijues.

organet e qeverisjes vendore. Këtë mjet ligjor mund ta ushtrojnë edhe disa subjekte të tjera të rëndësishme, si për shembull Avokati i Popullit, partitë politike, organet përfaqësuese të bashkësive fetare etj. Kjo kërkesë e organeve të lartpërmendura ka një tipar dallues, sepse këto organe vënë në lëvizje një kontroll abstrakt dhe objektiv të ligjit, ku objekt gjykimi janë normat juridike. Në këtë rast, interesi ligjor që kërkohet të mbrohet nuk është individual, por lidhet drejtpërdrejt me funksionimin e shtetit.

Në rastin e dytë, pra vënia në lëvizje e Gjykatës Kushtetuese nga gjykatat e zakonshme, bëhet me vendim të gjyqtarit në kuadrin e një procesi gjyqësor, qoftë ai civil apo penal. Kur gjatë gjykimit të zakonshëm, gjyqtari çmon se ligji i zbatueshëm për çështjen konkrete vjen në kundërshtim me kushtetutën, nuk e zbaton atë. Ai pezullon gjykimin dhe e çon çështjen për shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese. Në këtë pikepamje shtrohet pyetja nëse nisma për procesin kushtetues përbën një detyrim për gjyqtarin, apo lihet thjesht në vështirimin e tij subjektiv. Nga interpretimi i dispozitës kushtetuese rezulton se vetë dispozita përbën një detyrim për gjyqtarin e zakonshëm, pasi ky i fundit nuk mund të zbatojë një ligj që ai çmon se vjen në kundërshtim me kushtetutën dhe as të vendosë vetë për papajtueshmërinë e tij me Kushtetutën. Ky është një sistem që zbatohet në të gjithë Europën dhe quhet modeli europian. Në këtë pikë, sistemi ynë i drejtësisë kushtetuese ndryshon rrënjësisht me atë amerikano-latin të shpjeguar në kapitullin që lamë pas. Në pothuajse të gjitha vendet e Amerikës Latine, çdo gjyqtar i thjeshtë, jo vetëm që mund t'i drejtojë kërkesë për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese (kontroll i përqendruar), por ai mund të shprehet edhe vetë në rast papajtueshmërie me normën kushtetuese (kontroll i përhapur).

Në vendin tonë, gjyqtari i zakonshëm respekton rregullat proceduriale të parashikuara nga ligji organik i Gjykatës Kushtetuese për ushtrimin e tij, si dhe jurisprudencës kushtetuese. Në këtë rast, gjyqtari i zakonshëm duhet të veprojë duke pezulluar gjykimin vetëm nëse konstaton se kontrolli i kushtetueshmërisë së ligjit përkatës është i domosdoshëm për zgjidhjen e çështjes konkrete. Ky lloj gjykimi kushtetues kërkon domosdoshmërisht ekzistencën e një lidhjeje të drejtpërdrejtë midis ligjit, antikushtetushmëria e të cilit çmohet si e tillë nga gjykatat, dhe zgjidhjes së çështjes konkrete. Kjo është një lidhje e ngushtë, e cila ka një karakter të drejtpërdrejtë dhe të

domosdoshëm. Për çka u specifikua më sipër, Gjykata Kushtetuese Shqiptare e ka mbajtur mirë parasysh ekzistencën e lidhjes së domosdoshme që kërkohet për gjykime të kësaj natyre. Gjykata Kushtetuese ka rrëzuar shpeshherë kërkesën e gjyqtarit të zakonshëm në rastet kur çështja e kërkuar ka paraqitur mangësi të dukshme të rëndësisë për zgjidhjen e rastit konkret.

Rasti i tretë i vënies në lëvizje të Gjykatës Kushtetuese është ai me kërkesë të individit. Neni 131/f i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë trajton institutin e rekursit individual kundër shkeljes së të drejtave themelore, duke imituar në këtë mënyrë modelin gjermano-spanjoll. Në përpilimin e Kushtetutës kanë marrë pjesë organizma ndërkombëtare, si OSCE dhe Komisioni i Venecias. Është e nevojshme të kujtohen karakteristikat e procesit kushtetues shqiptar¹⁸², i cili pati mbështetjen teknike të institucioneve të huaja në ushtrimin autonom të pushtetit kushtetues të lirisë së plotë të shprehjes së sovranitetit shtetëror. Në këtë mënyrë ka ruajtur diskrecionalitetin politik të organeve kombëtare në vendimet përfundimtare mbi tekstin kushtetues.

Legjitimimi për të vepruar i takon cilitdo personi fizik apo juridik, por jo në formën e një *actio popularis*, por si personi i cili ka pasur shkelje nga ana e pushtetit publik të një të drejte themelore. Konkretisht, individ mund të bëjë një kërkesë vetëm pasi çështja e tij të jetë shqyrtuar në të tri shkallët e gjykimit të zakonshëm. Presupozohet se për të gjitha të drejtat kushtetuese të individit, ky i fundit mund të kërkojë mbrojtje nga gjykatat e zakonshme, të cilat duhet të sigurojnë një proces të rregullt gjyqësor. Në këtë kuadër, mund të themi se e drejta për një proces të rregullt ligjor nuk paraqet ndonjë ndryshim nga e drejta për një proces të rregullt gjyqësor, pasi në përgjithësi të gjithë shtetasit kanë mundësi t'i drejtohen gjykatës në rast se u është shkelur një e drejtë e parashikuar në Kushtetute apo në ligj. Deri tani, Gjykata Kushtetuese e ka reduktuar kontrollin kushtetues mbi bazën e kërkesave të individëve vetëm në kontrollin për një proces të rregullt ligjor. Kjo përbën një dallim nga përvoja e krijuar gjatë zbatimit të ligjit për dispozitat kryesore kushtetuese, mbi bazën e të cilit Gjykata Kushtetuese zgjidhte përfundimisht ankesat e personave në lidhje me thelbin e të drejtave dhe lirive

¹⁸² Disa materiale të përdorura në procesin kushtetues shqiptar gjenden në faqen <http://www.geocities.com/Eureka/Enterorises/5434>, si dhe në A. Loiodice, N. Shehu, faqe 95 e vijuese.

themelore. Pjesa e VIII-të e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë e vitit 1998 trajton një sistem të përqendruar të drejtësisë kushtetuese të mbingarkuar me kompetenca¹⁸³. Rekursi individual në Gjykatën Kushtetuese shqiptare nuk ka një rreze veprimi ekuivalente me të njëjtin recurs të sistemeve të tjera, dhe përmbush vetëm pjesërisht të njëjtin funksion, sepse vetë e drejta e mbrojtur është ajo e "procesit të rregullt ligjor" ose ajo që në gjuhën ndërkombëtare mban emrin e "due process of law". Një pasojë tjetër e faktit që objekti i mbrojtjes është një e drejtë me përmbajtje procesuale, përjashtohet për ankuesin mundësia e recursit në Gjykatën Kushtetuese për shkeljet e të drejtave themelore të shkaktuara nga ligji, me përjashtim të rastit kur norma shkel të drejtat kushtetues për një proces të rregullt ligjor.

Ky parashikim i kushtetutës aktuale është i ndryshëm nga kushtetutat e vendeve të garantojnë drejtësinë kushtetuese, si dhe nga Ligji 6561, dt. 29.04.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin për Dispozitat Kryesore Kushtetuese" me të cilin u krijuar Gjykata Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë. Ligji 6561 i jepte kompetencën Gjykatës Kushtetuese të zgjidhte përfundimisht ankesat e personave të paraqitura në rrugën e kontrollit kushtetuese për shkeljen e të drejtave të tyre themelore nga aktet e paligjshme. Pra, Kushtetuta e vitit 1998 bëri një ngushtim të kompetencave të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me mundësinë e vënies në lëvizje të Gjykatës Kushtetuese nga ana e individit. Gjatë diskutimeve për hartimin e Kushtetutës së viti 1998 u analizua çështja nëse kjo do të thoshte kufizim të individit dhe u arsyetua që rregullimi i propozuar ishte një 'sitë' që i bëhej çështjeve që mund të paraqiteshin nga individit në Gjykatën Kushtetuese dhe një çështje ndarjeje. Në fakt, duke u bazuar në një krahasim me Kushtetutes sone aktuale dhe atyre të Amerikës Latine, vërejmë që në vendin tonë është e reduktuar mundësia e recursit të individit në Gjykatën Kushtetuese, duke e kufizuar këtë të drejtë vetëm në rastin e shkeljes së rregullave për një proces të rregullt ligjor.

¹⁸³ Mbingarkesë funksionesh përtej kontrollit të kushtetueshmërisë së ligjeve, e cila është një karakteristikë tipike e Gjykatave Kushtetuese Europiane Lindore, shiko L. Pegoraro. (2004), *"La Justicia Constitucional. Una perspectiva comparada"*, Madrid, Dykinson, fq150.

Ne thelb, Gjykata Kushtetuese nuk i hyn fare gjykimit të një çështjeje, por shqyrton nëse procesi i gjykimit i është përmbajtur një procesi të rregullt gjyqësor.

Kërkesa individuale ka kështu karakter subsidiar. Ajo paraqitet në Gjykatën Kushtetuese pasi shterohen të gjitha rrugët e tjera të ankimit gjyqësor dhe administrativ.

Shkelja e së drejtës për një proces të rregullt duhet të jetë konkrete dhe jo e supozuar dhe kërkesa të plotësojë edhe elementët e tjerë të kërkuara për paraqitje të kërkesave në Gjykatën Kushtetuese si p.sh. ajo të paraqitet jo më vonë se dy vjet nga konstatimi i shkeljes apo data e njoftimit të vendimit të organit përkatës, të jetë në gjuhën shqipe, e qartë dhe e kuptueshme. Statistikat flasin për një shtim të numrit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese si rrjedhojë e kërkesave individuale.

Procesi i rregullt ligjor është një ndër parimet themelore të së drejtës dhe një ndër të drejtat dhe liritë themelore të njeriut sipas Kushtetutës. Për herë të parë në vendin tonë kjo e drejtë parashikohet me Ligjin nr. 7692, dt 31.3.1993 “Për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut”. Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë e drejta për një proces të rregullt ligjor parashikohet shprehimisht në nenin 42 si një e drejtë dhe liri themelore e individëve, i cili parashikon: 1. Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor. 2. Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Kushtetuta, siç u përmend edhe më lart, i referohet kësaj të drejte edhe në nenin 131, germa “f”, duke i mundësuar individëve edhe një mekanizëm ligjor të rëndësishëm për mbrojtjen e kësaj të drejte themelore, siç është ai i paraqitjes së kërkesës pranë Gjykatës Kushtetuese.

E drejta për proces të rregullt është një ndër të drejtat më të gjëra që parashikohet në instrumentet ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut. Kjo e drejtë garantohet nga neni 6 dhe Protokolli Nr.7 i KEDNJ, neni 14 i PNDKP, neni 8 i Konventës Ndër-Amerikane për të Drejtat e Njeriut dhe neni 7 i KADNJP. Gjykata Evropiane por edhe Gjykata Ndër-Amerikane janë shprehur që e drejta për proces të drejtë zbatohet në çdo rast kur një subjekti të së drejtës i garantohet një e drejtë, qoftë materiale, qoftë procedurale, nga

normat juridike në fuqi dhe nënkupton zhvillimin e gjykimit të mosmarrëveshjes lidhur me këtë të drejtë, sipas një procedure të drejtë.

Kështu, në jurisprudencën e saj Gjykata Kushtetuese ka lidhur ngushtë garantimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor dhe elementët përbërës të saj me konceptin e shtetit të së drejtës duke e konsideruar të parën element thelbësor të shtetit të së drejtës.

Kuptimi i këtij punimi kërkimor është pikërisht ai i rishikimit kushtetues për zgjerimin e titullit mbi garancitë kushtetuese në mbrojtje të të drejtave themelore. Krahasimi me vendet e Amerikës Latine do të jetë frytdhënës për ligjvënësin tonë kushtetues, si nga pikëpamja e historisë ashtu dhe nga ajo e zhvillimeve kushtetuese.

Kapitulli V: KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME

- Konkluzione

Të drejtat pa garancitë nuk janë gjë tjetër veçse një letër e vdekur, siç tregon edhe jeta e përditshme e njeriut në shoqëri.

Për të tejkaluar këtë realitet, sistemet juridike latino-amerikane kërkojnë të perfeksionojnë mekanizmat e mbrojtjes juridiksionale të brendshme dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut si përgjigje ndaj shkeljes së vazhdueshme dhe në rritje të tyre. Por respektimi i të drejtave varet nga diçka më shumë se garancitë kushtetuese formale. Siç u theksua më sipër, ai varet nga kultura e së drejtës, si sinonim i drejtësisë, që varet edhe ky nga zhvillimi i civilizimit dhe progresit tekniko-shkencor.

Civilizimi dhe zhvillimi ekonomik dhe social, megjithatë, nuk e sigurojnë kulturën e respektimit të të drejtave dhe drejtësisë. Mund të hartosh deklarata të pafundme, kushtetuta dhe katalogje të drejtash, siç ndodh në pjesën më të madhe të vendeve në zhvillim, por përkthimi i tyre në një mbrojtje më të gjerë të të drejtave të njeriut, të grupeve dhe të shoqërisë, jo vetëm që është i vonshëm, por shpeshherë duket se kthehet prapa, deri në pikën që lind pyetja nëse vendet perëndimore, *in primis* Shtetet e Bashkuara të Amerikës, që i paraqiten botës si pishtarët e së drejtës kundër padrejtësisë, janë apo jo shembull i së drejtës dhe i lirisë¹⁸⁴.

Në këtë kontekst, të brendshëm dhe botëror, konstatimi nëse ka vende që shqetësohen për përpunimin e mekanizmave juridiksionale për një respektim më të gjerë të të drejtave, mund të ketë një kuptim vetëm simbolik të problemit. Duke qenë se klasa politike nuk mund të sigurojë materialisht dhe realisht respektimin e të drejtave të njeriut, krijojnë garanci, përfshirë edhe ato të një rangu kushtetues, që janë vetëm formale dhe që shërbejnë për të fshehur dhe justifikuar mungesën e suksesit në "luftën" e tyre për të drejtën.

Megjithatë, ky vizion negativ duket se është në kontrast me realitetin e përditshëm të pjesës më të madhe të vendeve latino-amerikane, çka tregon një luftë permanente dhe çdoherë më personale, ndërsa grupet që, duke njohur këto garanci dhe duke poseduar

¹⁸⁴ M. AINIS, *Le libertà negative*, Rizzoli, Milano, 2004.

instrumentet që e drejta formale ofron për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tyre formale, i përdorin për benefitet e tyre, të shoqërisë dhe zhvillimit të kulturës së të drejtës.

Në të vërtetë, sot shtetasit kanë një mbrojtje më të madhe të të drejtave të tyre përballë adminsitrimin përballë aparatit të madh shtetëror, që gjithçka mund dhe gjithçka dominon. Lajmërimi historik: "Ka gjyqtarë në Berlin", do të thotë gjithnjë e më shumë që autoritetet publike dhe private kanë norma për të respektuar, që pushteti i tyre nuk është i pakufizuar, por i rregulluar nga ligji, që të drejtat e personave janë para atyre të Shtetit dhe që, për këtë arsye, duhet të respektohen. Kjo thënie merr sot, më shumë se kurrë, më shumë kuptim, falë pikërisht funksionit juridiksional të mbrojtjes dhe garancisë së të drejtave.

Aktualisht, aplikimi i të drejtave dhe i lirive nuk mund të thuhet se është i plotë, por është më i gjerë se në të shkuarën, falë bekimit të mbrojtjes së tyre juridiksionale, që ka sjellë përhapjen e një pushteti gjyqësor autonom, profesional, të paanshem, mbrojtës jo vetëm të ligjit, por mbi të gjitha të Kushtetutës dhe të drejtave dhe që ekziston jo vetëm në "Berlin", por mbi të gjitha në të gjithë territorin e Shtetit, ashtu si dhe në komunitetin ndërkombëtar. Ky ka qene revolucion i paqësor i dhjetëvjeçarëve të fundit të shekullit XX, që është në rrugë progresi dhe perfeksionimi, siç e tregon autonomia shkencore, ku po fiton e drejta procesuale kushtetuese, drejtësia kushtetuese dhe juridiksioni kushtetues. Në këtë kuptim, kanë të drejtë ata që mendojnë se pas Luftës së Dytë Botërore ka nisur shekulli i pushtetit gjyqësor dhe i supremacisë së Kushtetutës dhe të drejtave.

Evoluimi dhe afirmimi i garancive kushtetuese të të drejtave themelore, i të drejtave dhe interesave kolektive, të përhapur në të drejtën publike, edhe duke pranuar shpeshherë pjesën më të madhe të kritikave për karakterin e tyre më formal se material, nuk mund të mohohen, sepse janë pjesë e pandashme e historisë politike dhe juridike.

Sistemi "amerikan" - USA - i të drejtave të njeriut, në mënyrë kurioze në nivel ndërkombëtar, nuk ka fituar akoma një kulturë respekti ndaj traditës ligjore ndërkombëtare dhe, në mbrojtje të interesave kombëtare, sakrifikon komunitetin ndërkombëtar, Kombet e Bashkuara, por edhe Gjykata Penale Ndërkombëtare, traktatet,

konventat ndërkombetare dhe kontinentale, Konventat e Gjenevës mbi të Drejtën Ndërkombëtare Humanitare, Konventën Amerikane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut - Pakti i San Hozesë -, Traktati i Rios dhe Protokolli i Kiotos, në mbrojtje të zhvillimit të qëndrueshëm në respekt të të drejtës themelore, subjektive, kolektive të mjedisit.

Ashtu si në rang kombëtar dhe nderkombetar, SHBA sakrifikon respektimin e të drejtave të njeriut, veçanërisht *habeas corpus*-in dhe garancitë e zbatimit të ligjit, me justifikimin e teorisë së interesit dhe sigurisë kombëtare, me të gjitha pasojat në të gjithë kontinentin latino-amerikan gjatë viteve 1960-1990, me pasojat tragjike të shkeljes së të drejtave të njeriut. Edhe pse duhet të përgëzojme punën e Gjykatës Supreme të Shteteve të Bashkuara për rivendosjen e vlefshmërisë dhe efikasitetit të së drejtës përpos efikasitetit relativ¹⁸⁵. Këto reflektime të përgjithshme i çojnë studiuesit e fushës së mbrojtjes së brendshme dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut të konstatojnë se, në momentin aktual të zhvillimit të sistemit të të drejtave të njeriut të të gjithë komunitetit ndërkombëtar, ndihet nevoja e veçantë e rekuperimit të kompetencave si për mbrojtjen e organizatave ndërkombëtare në radhe të parë, ashtu dhe për aparatet e ndryshme institucionale shtetërore, të futura seriozisht në krize dhe të sakrifikuara nga "sistemi amerikan" i të drejtave të njeriut në funksion të sigurisë kombëtare.

Për sistemin "amerikan" të SHBA-ve të të drejtave të njeriut duhet të kujtojmë karakterin e tij në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare, edhe në fushën e të drejtave të njeriut, që lind nga një koncept i posaçëm dhe unilateral i vlerave të themeluesve të Shtetit të ri.

Disa studiues e cilësojnë me të drejtë këtë karakter si "antikonvencionist", domethënë në kundërshtim me paktet, traktatet, konventat ndërkombëtare dhe e konsiderojnë me siguri të prejardhur nga konceptimi i tyre i posaçëm i supremacisë së kushtetutës së tyre¹⁸⁶, që krijon një mungesë besimi të përgjithshëm të këtij Shteti - SHBA - në lidhje

¹⁸⁵ Në këtë kuptim, vendimi i fundit i rëndësishëm i Gjykatës Supreme, edhe pse erdhi pas një pritjeje të gjatë, lidhet me antikushtetueshmërinë e normave të aplikuara ndaj të dënuarve në burgun e Guantanamos.

¹⁸⁶ A. Di Stasi, (2004). *Il sistema americano dei diritti umani*, Giappichelli, Torino, fq 245 e vijues.

me të gjitha traktatet, paktet, konventat në fushën e të drejtave të njeriut jashtë rendit juridik federal. Mungese besimi që i bën SHBA-të të konsiderohen interpretuesit e vetëm të kuptimit dhe praktikës së respektimit të të drejtave, deri në transformimin e tyre si "eksportues" të vlerave në fushën e lirisë personale dhe demokracisë. Nuk ka dyshim që këto konceptime dhe përmbajtja e sistemit "amerikan" të të drejtave të njeriut, në veçanti për sa i përket mbrojtjes së tyre ndërkombëtare, është pasojë e drejtpërdrejte e doktrinës "Monroe" e gjysmës së parë të '800-s që, edhe duke e krahasuar sot, pas rënies së mureve dhe pas kalimit të Luftës së Ftohtë, do të thotë që jo vetëm Amerika duhet të jetë për "amerikanët", por edhe Shtetet e Bashkuara janë të legjitimuara të ndërhyjnë në çdo pjesë të botës në mbrojtje të interesave të tyre me justifikimin e mbrojtjes së lirisë dhe të drejtave të njeriut, në mbrojtje të idesë së tyre të demokracisë, ndërhyrje që përfshin edhe rekursin në teorinë e diskutueshme të politikës së jashtme të luftës parandaluese, të nënkuptuar në mënyrë rrënjësore si një instrument i vetëm dhe i privilegjuar për zgjidhjen e konflikteve ndërkombëtare dhe që, si rrjedhojë, zëvendëson të gjithë sistemin juridik aktual dhe politik botëror. Zëvendësim që SHBA-të çojnë përpara, jashtë kulturës së të drejtës së brendshme dhe ndërkombëtare të *international legal tradition* dhe, veçanërisht, pa marrë në konsideratë ato vlera humane të personit, të Shtetit dhe të komunitetit ndërkombëtar që po krijohen dhe afirmohen me sforco të mëdha, veçanërisht pas barbarizmave të Luftës së Dytë Botërore.

Nuk ka dyshim që "sistemi amerikan" tenton një hegjemoni kontinentale dhe universale dhe, si rrjedhojë, afirmimin imperial në fushën politike dhe në atë ideologjiko-juridike, me mbështetjen e opinionit të tij publik kombëtar, që nuk dëshiron për asnjë arsye preken e *american way of life* dhe që mbron si rrjedhojë një *American exceptionalism*¹⁸⁷, të pafre veçanërisht pas Luftës së Ftohtë, që la një kontekst ndërkombëtar dominimi absolut në një fuqi të vetme, SHBA, që e ushtojnë atë të shoqëruar nga interpretimi i tyre i veçantë dhe tradicional ndërkombëtar e kontinental mbi të drejtat e lirisë, demokracisë, mbrojtjes së tyre.

¹⁸⁷ D. P. Forsythe, *Eccezzionalismo americano e diritti umani globali*, citim nga D. DI STASI, Il sistema....., 252.

Për konsideratat e mësipërme, sistemi latino-amerikan i mbrojtjes së të drejtave, edhe pse me karakter më tepër formal se material, duket jo vetëm në përputhje me nevojën e forcimit botëror të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, por edhe më i duhuri dhe më funksionali në nivel kombëtar, kontinental dhe universal.

E njëjta konsideratë vlen të përmendet edhe për vendin tonë, i cili pas shumë peripecive historike, e ndien të nevojshëm rishikimin kushtetues për përshtatjen e kësaj të fundit me standardet kontinentale dhe universale. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë duhet të përqafojë modelet më të zhvilluara kontinentale dhe latino-amerikane të të drejtave dhe garantimit të tyre. Nevoja e modernizimit dhe përshtatjes së titullit mbi garancitë kushtetuese, është e një rëndësie thelbësore për shtetasit e Republikës së Shqipërisë. Krahasimi i kushtetutës së vendit tonë me ato të realitetit latino-amerikan merr shkas nga ngjashmëritë historike dhe politike të këtyre realiteteve. Qasja dhe përshtatja e vendit tonë, në kuadër të integritetit euroatlantik të shumëdëshiruar, nis pikërisht nga këto reforma kushtetuese.

Analiza e bërë në këtë punim për evoluimin e mjeteve mbrojtëse kushtetuese përfaqëson, pa asnjë dyshim, një element tjetër esencial mbrojtjeje procesuale dhe kushtetuese të të drejtave, fryt konstant dhe shekullor që popujt e krahasuar kanë realizuar në të gjitha nivelet: kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare.

Interesi im për historinë dhe politikën më shtyn të pohoj me keqardhje se shumë lëvizje bëhen gjithnjë për interesa dhe lojëra pushteti të klasës politike. Atëherë t'ia lëmë gjykimin të ardhmes, me shpresën se vite më të mira do t'i shtohen historisë së kushtetutave dhe realitetit të shumë shteteve.

- Rekomandime

Rekomandimet që vlerësoj të jap nga ky studim lidhen me nenin 17 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i cili citon si vijon: “Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik, ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë.” Duke qenë se vendi ynë ka përjetuar periudha të ndryshme luftërash civile dhe, si rrjedhojë, shtetasit shqiptarë janë përballur me

ndërprerjen e garancive kushtetuese si shkak i shpalljes së gjendjeve të jashtëzakonshme, rekomandoj një rishikim të këtij neni të Kushtetutës, duke e ndryshuar totalisht atë. Shembulli i Amerikës Latine mund të na ndihmojë të modifikojmë këtë nen, i cili të shprehë ndalimin absolut të ndërprerjes së garancive kushtetuese në çdo rast.

Gjithashtu, rekomandoj rishikimin e nenit 175, pika 2 dhe 3. Rishikimi i këtij neni duhet të imponojë, siç e theksova më sipër, ndalimin absolut të ndërprerjes së garancive kushtetuese për liritë dhe të drejtat individuale.

Ne lidhje me ligjin 99/2016 “Per Funksonimin e Gjykares Kushtetuese ne Republiken e Shqiperise”, neni 71 “E drejta për të ushtruar ankimin kushtetues individual .

Çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, kur është palë në një proces ligjor ose kur është bartës i të drejtave dhe i lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta ka të drejtë të kundërshtojë para Gjykatës Kushtetuese çdo akt që cenon të drejtat dhe liritë e parashikuara në Kushtetutë, sipas kriterëve të parashikuara në nenin 71/a të këtij ligji. Sipas këtij neni Kriteret për të ushtruar ankim kushtetues individual jane: 1. Ankimi kushtetues individual shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese kur: a) kërkuar ka shteruar të gjitha mjetet juridike efektive para se t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese ose kur legjislacioni i brendshëm nuk parashikon mjete juridike efektive në dispozicion; b) kërkesa paraqitet brenda afatit 4-mujor nga konstatimi i cenimit; c) pasojat negative të pretenduara janë të drejtpërdrejta dhe reale për kërkuar; ç) shqyrtimi i çështjes nga Gjykata Kushtetuese do të mund të rivendoste në vend të drejtën e shkelur të individit.

Verehet qarte se kjo e drejte per t’ju drejtuar Gjykares Kushtetuese eshte e kufizuar vetem ne rastin e cenimit te parimeve te procesit te rregullt ligjor. Rekomandimi ne kete rast I referohet rishikimit te këtij neni te ligjit 99/2016 per te zgjeruar aksesin e rekursit te individeve ne Gjykares Kushtetuese, duke mos e limituar ate vetem per shkeljet e rregullave te procesit te rregullt ligjor.

BIBLIOGRAFIA

Burime parësore:

1. *Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë*
2. *Kushtetuta e Venezuelës*
3. *Kushtetuta e Kolumbisë*
4. *Kushtetuta e Ekuadorit*
5. *Kushtetuta e Perusë*
6. *Kushtetuta e Bolivisë*
7. *Kushtetuta e Shteteve të Bashkuara të Amerikës*
8. *American Patriot Act*
9. *Ligji nr.99/2016 “Per Funksionim e Gjykates Kushtetuese te RSH”*

Burime dytësore:

-Lietratura

1. AA. VV. (2003). *“It's a Free Country”*. New York.
2. AA. VV. (2005). *“At war with civil rights and civil liberties”*. Baltimora.
3. Adam, James A. (2003). *“Electronic Surveillance: Commentaries and Statutes”*.
Notre Dame, IN: National Institute for Trial Advocacy.
4. Adele, Robert P. (2005). *“Auser’s guide to the USA PATRIOT ACT and beyond”*.
Lanham, MD: University Press Of America.
5. Akbar, M. J. (2002). *“The shade of swords: Jihad and the Conflict between Islam and Christianity”*. London and New York: Routledge.
6. Ball, H. (2004). *“The USA PATRIOT ACT of 2001: Balancing Civil Liberties and National Security: A Reference Handbook”*. Santa Barbara, CA: ABC-CLIO.
7. Benjamin, D and Simon, S. (2002) *“The age of sacred terror”*. New York:

Random House.

8. Biddle. (1951). *"The fear of freedom"*, New York.
9. Bodansky, Y. (2001). *"BinLadin: The man who declared war on America"*. New York: Random House.
10. Botero, F. (1964). *"Las Constituciones comparadas"*, Medellin, Bogotá.
11. Bovard, J. (2003). *"Terrorism and Tyranny: Trampling Freedom, Justice, and Peace to Rid the World of Evil"*. New York: Palgrave Macmillan.
12. Brewer-Carias A. (1999). *"Asamblea Constituyente y Ordenamiento Constitucional"*, Caracas.
13. Camargo, G. (1983). *"International Handbook of the Ombudsman"*, Westport, Connecticut.
14. Carlos Sàchica, L.(1984). *"Constitucionalismo Colombiano"*, Bogotá.
15. Carlos Sàchica, L. (1970). *"La reforma constitucional de 1968"*, Bogotá.
16. Cate. (1978). *"The great fear: the anti - communist purge under Truman and Eisenhower"*. New York.
17. Chafee. (1969). *"Free speech in the United States"*, New York.
18. Clarke, Richard A. (2004). *"Against All Enemies: Inside America's War on Terror"*. New York: Free Press.
19. Cole D. (2002). *"Terrorising immigrants in the name of fighting terrorism"*.
20. Collins, A. (2002) *"My Jihad: The true story of an American Mujahid's amazing journey from Osama Bin Laden's training camps to counterterrorism with the FBI and CIA"*. Guilford, CT: Lyons.
21. Combellas, R. (1995). *"La justicia constitucional"*, in Anuario de

derechoconstitucional Latinoamericano, Dikè, Medellín.

22. Correa Henao, N. (2001). *“Derecho procesal de la acción de tutela”*, Unijaveriano, Bogotá.
23. De Vergottini G. (1997). *“Costituzione ed emergenza in America Latina”*, Giappichelli, Torino.
24. Dias Arenas P. A. (1993). *“La constitución política de Colombia”*, Tennis, Bogotá.
25. Duenas Ruiz, O. J. (2001). *“Acción y procedimiento en la tutela”*, El Professional, Bogotá.
26. Ehrenfeld, R. (2003). *“Funding Evil: How Terrorism Is Financed-and How to Stop It”*. Chicago, IL: Bonus Books.
27. El-Ayouty, Y. (2004). *“Perspectives on 9/11”*. Westport, CT: Praeger.
28. Emerson, S. (2002). *“American Jihad: The Terrorists Living among Us”*. New York: Free Press.
29. Enrique Tascón, T. (1953). *“Historia del Derecho Constitucional Colombiano”*, Bogotá.
30. Esguerra Portocarrero J. C. (2004). *“La protection constitucional cindodano”*, Legis, Bogotá.
31. Etzioni, A. (2004). *“How Patriot is the Patriot Act?: Freedom versus security in the Age of Terrorism”*. New York: Routledge.
32. Ewing, Alphonse B. (2002). *“The USA PATRIOT ACT”*. New York: Novinka Books.
33. Farnam, J. U. S. (2005). *“Immigration Laws under the Threat of Terrorism”*. New

York: Algora Pub.

34. Ferriera, P. (1988). *“Teoria e pratica do habeas corpus”*, Ed. Sararia, Rio de Janeiro.
35. Fescol.(1991). *“Una Constituyente para la Colombia del futuro”*, Bogotá.
36. Gaona, M. (1988). *“Estudios constitucionales”*, Bogotá.
37. Garcia Belaunde, D. (2003). *“De la jurisdicción al derecho procesal constitucional”*, Ed. Grijley, Lima.
38. Gertz, B. (2002). *“Breakdoen: How America’s Intelligence Failures Led to September 11”*. Washington, DC: Regnery Publishing.
39. Gimeno Sendra V. e Garberi Llobregat J. (1994). *“Los proceso de amparo (ordinario, constitutional e international)”*, Colex, Madrid.
40. Gomez Sierra F. (1998). *“Constitucion politica de Colombia”*, Bogotá, Ed. Leyer.
41. Greenäld, R. (2006). *“Unconstitutional: The War on Our Civil Liberties”*. New York: Disinformation Co.
42. Henao Hidron, J. (2003). *“Derecho processal constitucional-protección de los derechos constitucionales”*, Tenis, Bogotá.
43. Henderson, H. (2003). *“Terrorist Challenge to America”*. New York: Facts on File.
44. Hentoff N. (2005). *“The FBI among the bookshelves”*.
45. Herrera ,V. H. (1991). *“Designatura - Vicepresidencia. Informe, Ponencia, Gaceta Constitucional”*, Bogotá.

46. Hineštroša, F. (1996). *“La proprietà nella nuova costituzione colombiana”*, Studi Urbinati, Urbino.
47. I. Burgoa, *El Juicio de Amparo*, Porrua, Mèxico, 1943; H. Fix – Zamudio. (1993).” *Ensayos sobre el derecho de amparo*”, UNAM, Mèxico.
48. Jimènez Campo, J. (1999). *“Derechosfundamentals. Concepto y Garantias”*. Tratta, Madrid.
49. Krittie, È. (1986). *“The tree of liberty: a documentary history of rebellion and political crime in America”*. Baltimore.
50. La Roche J. M. (1990). *“Cortes y Salas constitucionales en America Latina in Ricardo Cambellas, El nuevo derecho constitucional latinoamericano”*. Caracas.
51. Laqueur, È. (2003). *“Noend to war: Terrorism in the Twenty-First Century”*. New York: Continuum.
52. Linares Benzo G. (1999). *“El proceso de amparo”*, Juridica Venezolana, Caracas.
53. Linfield. (1990). *“Freedom under fire”*, Boston.
54. Lleras de la Fuente, C. (1992). *“Interpretaciòn y gènesis de la Constituciòn de Colombia”*, Bogotá.
55. Lombardi, G. (1990). *“Il costituzionalismo latino: a proposito di una originalità desconosciuta”*. Prefazione al libro di Guido Guidi e Rozo Acuña. “I Paesi Andini”. Giuffrè Editore, Milano.
56. Machado Pelloni, F. (2003). *“Derecho Procesal Constitucional”*, Ad Hoc, Buenos Aires.
57. Maria Samper, J.(1974). *“Derecho Publico Interno”*, Bogotá.

58. Maria V. De Guzmàn. (1991). *“La alegría de ser”*, Bogotá.
59. Martin, G. (2004). *“The New Era of Terrorism: Selected Readings”*. Thousand Oaks, CA: Sage.
60. Moore, M. (2006). *“The Official Fahrenheit 9/11 Reader”*. New York: Simon & Schuster Paperbacks.
61. Moreno Cora, S. (1902). *“Tratado del Juicio de Amparo”*, Ed.
62. Moreno, D. (1993). *“Derecho Constitucional Mexicano”*, Mexico.
63. Murphy, (1969). *“World War I and the origin of civil liberties in the United States”*, New York.
64. Ocampo Londono J, (1982). *“Proceso Politico, military social de la independencia”*, in Manual de Historia de Colombia, Bogotá
65. Osasuna Patino, N. I. (1998). *“Tutela y amparo, estudio comparato”*, Uniexternado, Bogotá.
66. Rozo Acuna , E.(1982). *El Sistema Constitucional Colombiano*, Bogotá.
67. Rozo Acuna, E. (1987). *“La Corte Suprema de Justicia de Colombia”*, Bogotá.
68. Rozo Acuna, E. (2006). *“Le garanzie costituzionali nel diritto pubblico dell’America Latina”*, Giappichelli Editore, Torino.
69. Rozo Acuna, E. (1994). *“La tutela o amparo ne diritto pubblico colombiano”*, Studi Urbinati, Urbino.
70. Rozo Acuna, E. (1986). *El Control de Constitucionalidad de las Reformas Constitucionales en Colombia*, Bogotá.
71. Rozo Acuna, E. (1988). *“Bolivar y la organizaciòn de los poderes públicos”*, Temis, Bogotá.

72. Rozo Acuna, E. (2000). *“La Tutela o Amparo dei Diritti Fondamentali in America Latina”*, Rimini, Maggioli.
73. Rozo Acuna, E.(1974). *Desarrollo Politico de Colombia*, Bogotá.
74. Rozo Acuna, E.(1982). *Bolivar: Pensamiento constitucional*, Bogotá.
75. Sola J. V. (2001). *“Control judicial de la constituciones”*, Perrot, Buenos Aires.
76. Suescun, A.(1991). *“Las Constituciones de Boyacà, Academia Boyacense de Historia”*, Tunja.
77. Summers. (1942). *Èartime censorship of press and radio*, New York.
78. Tamayo Jaramillo, J. (2001). *“Las acciones populares y de grupo en la responsabilidad civil”*, Medellin, Dike.
79. Tirado Mejia, A.(1982). *“El Estado y la politica en el siglo XIX”*, in Manual de Historia de Colombia, Bogotá.
80. Toricelli, M. (1998). *“La competencia en el amparo”*, Zeus, Rosario.
81. Uribe Vargas, D. (1977). *“Las Constituciones de Colombia”*, Madrid.
82. Uribe Vargas, D. (1991). *“Carta de Derechos, derebes, garantias y libertades. Informe, ponencia, Gaceta Constitucional”*, Bogotá.
83. Vanossj, R. A. I. (2000). *“El Estado de derecho en el constitucionalismo social, Eudeba”*, Buenos Aires.
84. Vàsquez A. (1974). *“Il Concordato del Colombia con la Santa Sede”*, Bogotá.
85. Verdugo, M. (1990). *“Derecho constitucional”*, Ed Juridica, Santiago.
86. Vescovi, E. (1988). *“Los recursos judiciales y demas medios impugnativos en Iberoamerica”*, Depalma, Buenos Aires.
87. Villamil Postilla, E. (1998). *“Teoria constitucional del proceso”*, Ed. Doctrina y

ley, Bogotá.

88. William R. Rhenquist.(1998). "*All the laws but one: civil liberties in wartime*" 222. Random House.
89. Zaldivar Lelo De Larrea A. (2002). "*Hacia una nueva ley de amparo*", Unam, Mexico.
90. Zobatto D. (1990). "*Los estados de excepcion y los derechos humanos*", Ed. Juridica Venezuelana, Caracas.
91. Zubiate Reyna, F. (1990), "*La accion de amparo*", Lima.
92. Xhezair Zaganjori, Aurela Anastasi, Eralda Methasani (2011). "*Shteti i se Drejtes ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise*", Tirane.

- **Praktikë Gjyqësore**

1. Çështja, *Toyosaburo Korematsu vs. United States*, No. 22. Argued Oct. 11, 12, 1944. Decided Dec. 18, 1944.
2. Çështja, *Dennis vs. United States*, 341 U. S. 494 (1951).
3. Çështja, *Brandenburg vs. Ohio*, 395 U. S. 444 (1969).
4. Çështja, *Garner VS Public Works*, 341 U. S. 716 (1951).
5. Çështja, *Barenblatt VS United States*, 360 U. S. 109 (1959).
6. Çështja, *Yates VS United States*, 354 U. S. 298 (1957).
7. Çështja, *Gibson VS Florida Legislative Investigatin Committee*, 372 U. S. 539 (1963).
8. Çështja, *Elfbrand VS Russell*, 384 U. S. 11 (1966).

- **Burime nga website-zyrtare dhe revista**

1. Balkin, K. (2005). *"The war on terrorism: Opposing Viewpoints"*. Detroid, MI: Greenhaeven Press.
2. Cole D, *Speech on Constoitution Day at Maryland Institute Art*, Baltimore, MD, September 16, 2005.
3. Congressional record-senate, January 31, 2006.
4. D. P. Forsythe, *Eccezionaliismo americano e diritti umani globali*, citim nga D. DI STASI, Il sistema.
5. Der, S. (2001). *"Inside 9-11: what really happened"*. Translated by Paul de Angelis and Elisabeth Kaestner, New York: St. Martin's.
6. Di Stasi, (2004). *Il sistema americano dei diritti umani*, Giappichelli, Torino.
7. Disa materiale te persorura ne procesin kushtetues shqiptar gjenden ne faqen <http://www.geocities.com/Eureka/Enterorises/5434>, si dhe ne A. Loiodice, N. Shehu.
8. Goldstein, Joshua S. (2004). *"The realprice of war: how you pay for the War on Terror"*. New York: New York University Press.
9. Gunaratna, R. (2002). *"Inside al Quaeda: Global Network of Terror"*. New York: Columbia University Press.
10. Hearing before the Committee on the Judiciary, House of Representatives, 109th Congress, 1st session, June 8, 2005.
11. K. Imholz, *"States of emergencyas pretext for gagging the press; ward play at Albania's Constitutional Court*, in East European Constitutional review, 4/1997.

12. L. Pegoraro. (2004), "*La Justicia Constitucional. Una perspectiva comparada*", Madrid, Dykinson.
13. La costitucìon de 1999. "*Derecho constitucional venezolano*". Caracas, 2004, I e II.
14. La costituzione della Colombia del 1991, in Temi di Diritto Pubblico Comparato, L'Asterisco, Urbino, 2003.
15. M. Ainis, (2004). *Le libertà negative*, Rizzoli, Milano.
16. Report to Congress on implementation of Section 1001 of the USA Patriot Act, January 22, 2003.
17. Representative Pete Stark, press release, September 24, 2003.
18. Rozo Acuna E, *Il principio democratico nella Costituzione della Repubblica Bolivariana del Venezuela*, Studi Urbinati, LXX 2002/03.
19. Rozo Acuna E. (1986). *Problemi attuali dell'ordinamento costituzionale colombiano*, in Diritto e Società.
20. Rozo Acuna E. (1995). *Stato, Chiesa e libertà religiosa in Colombia*, ne Quaderni di Diritto e Politica Ecclesiastica, 2.
21. S. Bartole, Final Remarks: *The role of Venice Commission, in review of Central and East European Law*, 3/2000.
22. Stone G. *Libertà Civili in tempo di guerra: la prospettiva americana*. Relazione all'Associazione Italiana Costituzionalisti. [www.associazione italiana dei costituzionalisti.it](http://www.associazione_italiana_dei_costituzionalisti.it).
23. Van Hollen Ch, *Letters to the editor*, Ëashington Post, December 21, 2005.

- Filma dhe Dokumentare

1. *Distorted Morality: A War on Terrorism?* 172 min. Oakland, CA: AK Press, 2003.
2. *Fahrenheit 9/11*. Dir. Michael Moore. 122 min. Lions Gate Films, 2004.
3. *Liberty and Security in an Age of Terrorism*. Video. Thompson, Molly. Princeton, NJ: Films for the Humanities & Sciences, 2004.
4. *In Memoriam*: New York, 9/11/01. 60 min. home Box Office, 2002.
5. *One Day in September*. Dir. Kevin Macdonald. 94 min. Arthur Cohn Prod., 2000.
6. *WTC: The First 24 Hours*, 9. 11. 2001. Dir. Etienne Sauret. 40 min. new York: Docurama, 2001.